

PROJEKT ZBATIMI

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE
GOLEM DHE SYNEJ - BASHKIA KAVAJË”
“SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME Durrës” SH.A.

- RELACION TEKNIK
- STUDIM GJEOLGJIK
- RELACION TOPOGRAFIK
- LLOGARITJE HIDRAULIKE
- SPECIFIKIME TEKNIKE
- GRAFIK PUNIMESH
- RAPORT V.N.M.
- LIÇENCË, DEKLARATË, SIGURACION

RELACIONI TEKNIK

PROJEKT ZBATIMI

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE UJESJELLESIT TE NJESIVE ADMINISTRATIVE GOLEM
DHE SYNEJ - BASHKIA KAVAJE”

“SHQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS” SH.A.

1. TE PERGJITHSHME

Fshatrat Agonas, Kolje, Rakell dhe Qerret Zona objekt projektimi shtrihen ne ultesiren perendimore te Shqiperise, qe fillon ne kanalin kullues ne afersi te kodres se Robit dhe perfundon ne afersi te fshatit Bukaq, Bashkia Kavaje.

Kryesisht ky projekt shtrihen ne zone fushore fshatrat Rakell, Qerret dhe kodrinore Agonas, Kolje, te cilat kane si aktivitet kryesor bujqesine blektorine dhe turizmin.

Zona bregdetare e fshatit Qerret eshte zone me potencial te larte turistik, me fshatra turistik, pallate, hotele, resorte, restorante, bare dhe sherbime te tjera ndihmese ne funksion vetem te turizmit sezonal qe fillon rreth muajit Prill dhe perfundon ne Tetor.



Harta topografike e zones

2. GJENDJA EKZISTUESE E UJESJELLSAVE TE ZONAVE NE STUDIM

Është e njohur problematika e garantimit të sasisë së ujit që të mbulojë zonat e banuara ekzistuese dhe ato te ndertuara pas viteve '90. Janë pak zona që e kanë zgjidhur këtë problematike per furnizimin me ujë të pijshëm 24-ore ne dite. Kjo suate vjen jo për shkak të mungesës së ujit në burimet tona natyrore, por si pasoje e disa faktorëve si më poshtë:

- a. Rritja e normes ditore për ujë pas viteve '90 me paisjet e reja elektroshtëpiake.
- b. Amortizimi i rrjeteve ekzistues të ndërtuar para viteve '90.
- c. Levizja demografike.
- d. Vendosja e banoreve ne zona te pa planifikuara per intesitet te larte te popullsise.
- e. Humbjet teknike ne rrjet.
- f. Ndotja e ujit si rrjedhoje e amortizimit te tubacioneve dhe depove.
- g. Nje pjese e faktoreve te mesiperm sjellin ndotjen mikrobiologjike te ujit.
- h. Lidhjet e paligjshme ose faturimi aforfe rrit artificialisht humbjet e ujit .
- i. Zhvillimi i planifikuar kerkon edhe mbulimin me infrastrukture Ujesjelles Kanalizime



Ortofoto e zones 1986

Zonat e projektit kryesisht janë zona ekzistuese me ndertime të reja përreth fshatrave autokton duke rritur sipërfaqen e mbulimit me rrjet ujësjellesi dhe numrin e konsumatoreve. Rrjeti i ekzistues i shpërndarjes nuk arrin të plotësojë nevojën për furnizim me ujë për këta banorë me sasinë dhe cilësinë e duhur pasi aty me parë janë bërë vetëm investime të pjesëshme për të përmirësuar gjendjen e emergjencës.

Janë ndërtuar rrjete tubacionesh në vazhdim të rrjeteve ekzistuese, pa rritur kapacitetin e tubacioneve dhe furnizimit me depo, prandaj lind nevoja për ndërtimin e një rrjeti teresisht të ri që të trajtojë të gjithë zonën të plotë me normat e reja që të bëjë të mundur furnizimin me ujë 24 orë, me prurjen dhe presionin e kërkuar për të gjithë vitin dhe të përballojë fluksin e pushuesve sezonale, me sasinë e ujit që është llogaritur sipas normativës me kërkesë mesatare ditore 150 l/dite për banor sipas VKM 83 Dt.10/02/2021.

Fshati Agonas furnizohet nga depo Agonas 200 m³ e vjetër që lidhet me tub PE 110mm, me tubin e Gizes 500mm që vjen nga puse shpimet e Çermes. Fshati nuk ka rrjet shpërndarës, kolektore dhe matesa. Pranë depos është ndërtuar një stacion pompimi i vjetër për zonat që nuk mbulohen nga kuota e depos.



Foto nga depo Agonas 200 m³



Foto nga vendi i depos së Re Agonas 6000 m³ (mbi rezervuarin Agonas)

Fshati Kolje nuk ka rrjet të furnizimit me ujë. Banorët furnizohen me ujë me puse individuale ose linja individuale nga ujësjellesi i qytetit Kavajë.



Foto nga zona Kolje

Fshati Qerret (fshati) furnizohet pjeserisht nga depo Agonas 200m³ dhe nuk mbulon nevojat e zones me uje. Fshati ka rrjet te vjeter te amortizuar pa kolektor dhe matesa.



Foto nga fshtati Qeret

Pjeserisht banoret jane lidhur te linja e dergimit qe vjen nga pus shpimet e Çermes.

Fshati Qeret (turistike) furnizohet pjeserisht sipas resorteve dhe pallateve investime private nga tubi PE 400mm qe vjen nga depo Golem 4000m³.



Foto nga zona turistike Qerret

Ne periudhen e veres sasia e ujit konsumohet nga zona turistike Golem dhe nuk arin te furnizohet zona turistike Qerret. Komplekset turistike Qerret jane lidhur pjeserisht te linja PE 400mm e shperndarjes Golem, me tub PE 110-90mm jo cilesor dhe nuk ka depo rregulluese.

Fshatrat Rakell (Njesine Administrative Synej, Bashkia Kavaje).

Fshatrat Rakell nuk kane rrjet te furnizimit me uje. Banoret furnizohen me uje me puse individuale ose linja individuale nga ujesjellesi i qytetit Kavaje.



Foto nga fshati Rakell




Foto nga fshati Rakell


3. BURIMI I FURNIZIMIT ME UJE

Si burim i furnizimit me uje te skemes jane puse-shpimet e Çermes te cilat nepermjet tubacionit 500mm perkatese dergon uje ne depot e qytetit Kavaje dhe Durres.

Furnizimi me uje i fshatrave te njesive administrative Synej dhe Golem pjese e ketij projekti do te furnizohen ne nje pike te vetme ne tubin e Gizes 500mm qe vjen nga STP Çërme ne afersi te ures ne hyrjen veriore te qytetit Kavaje ne drejtim te Durresit. Pika e lidhjes eshte ne segmentin nga Pusi i Shuarjes ne Kavaje ne kuoten 100.2 m – Depo e re 2000 m³ ne kodren e arapaj ne kuoten 60.0 m, me konkretisht prane ures Hekurudhore .

Ne piken ku lidhet tubi i dergimit te depos se re 6000m³ mbi rezervuarin Agonas ne kuoten 75.0 m, me tubacionin ekz. Gize 500mm qe vjen nga STP Çërme do te ndertohet puseta e re e dergimit

P.D. që do të pajiset me rakorderit e nevojshme Fllanxha, pjesë çmontuese, TEE, Brryl, Saracineska, mates uji.



4. BILANCI I UJIT

Te dhënat e analizuar janë marrë nga përgjegjësat e zonave që furnizohen në linjen e dërgimit Gize 500mm nga pushtimi Çërme në drejtim të Depos Maskuri, dhe është llogaritur bilanci i ujit duke u bazuar në konsumin e tij nga depot ekzistuese.

a) GJENDJA EKZ. E BURIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË ZONËS, STP ÇËRME – DEPO MASKURI

Nga pushtimet e Çërmes sipas vlerësimit të bërë nga SHRUKD në pusin e shuarjes Kavaje vjen sasia e ujit 830 m³/h ose $q=230 \text{ l/s}$.

Impianti i pastrimit të ujit nga rezervuari Maskuri me kapacitet $q=67 \text{ l/s}$ në kohën e hartimit të këtij projekti është në rikonstruksion.

Nga keto dy vendburime furnizohet me ujë qyteti Kavaje, fshatrat Synej, Agonas, Golem dhe Qerret.

b) PRESPEKTIVA E BURIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË ZONËS, STP ÇËRME – DEPO MASKURI

Pushtimet e Çërmes

Sipas targetit, kapaciteti i pompave në Çërme është $2 \times 490 \text{ m}^3/\text{h} = 980 \text{ m}^3/\text{h}$ ose $q=272 \text{ l/s}$

Pushtimet e Kavajës

Në qytetin Kavaje janë 2 pushtime ekz. 1 me prurje rreth 50 l/s dhe 1 me prurje rreth 5 l/s

Bazuar në projektin e hartuar nga SHRUKD për hapjen e 5 puseve në zonën Harizaj-Synej-Kavaje, përfaqësohen 2 pushtime Kavaje dhe në përfundim të investimit të parashikuar për 2025 do të prodhohet sasia e ujit rreth $q=75 \text{ l/s}$

Pushtimet Harizaj

Në fshatin Harizaj janë 5 pushtime ekzistuese, me prurje të vlerësuar rreth 15 l/s.

Bazuar ne projektin e hartuar nga SHRUKD per hapjen e 5 puseve ne zonen Harizaj-Synej-Kavaje, perfshihen 2 puset Harizaj dhe ne perfundim te investimit te parashikuar per 2025 do te prodhohet sasia e ujit rreth $q = 25 \text{ l/s}$

Ky pusshpim nuk do te perfshihet ne bilanc pasi do te perdoret per nevojat e rrjetit ekzistues dhe per furnizimin e fshetit Lekaj 9 l/s per te cilin eshte dhene miratim nga SHRUKD

Puseshpimet Synej


Ne fshatin Synej eshte 1 pusshpim ekz. jashte funksionit, me prurje te vleresuar rreth 5 l/s .

Bazuar ne projektin e hartuar nga SHRUKD per hapjen e 5 puseve ne zone Harizaj-Synej-Kavaje, perfshihet 1 pus ne Synej dhe ne perfundim te investimit te parashikuar per 2025 do te prodhohet sasia e ujit $q = 7 \text{ l/s}$

Ky pusshpim nuk do te perfshihet ne bilanc pasi do te perdoret per nevojat e rrjetit ekzistues

Impinti pastrimit Maskuri

Bazuar ne projektin e zbatimit, te impiantit te pastrimit te ujit nga Rezervuari Maskuri aktualisht sasia maksimale e ujit qe futet ne rrjet eshte 67 l/s .



Sasia max. e ujit te pastruar nga impinati Maskuri ne perfundim te investimit eshte 120 l/s .

Sasia totale e prodhuar nga puseshpimet Çërme-Kavaje dhe Impianti pastrimit Maskuri vleresohet $q = 272 + 75 + 120 = 467 \text{ l/s}$.

Duke vleresuar humbjet ne linjen e dergimit 15% te sasise se prodhuar, sasia e ujit qe shkon ne depot eshte $q = 369.95 \text{ l/s}$

c) KONSUMI I UJIT NGA RRJETI AKTUAL

Kavaja sipas vleresimit te bere nga konsumi ujit $V = 230\,000 \text{ m}^3/\text{muaj}$ ose $q = 86 \text{ l/s}$

Synej sipas vleresimit te bere nga konsumi ujit $V = 12\,000 \text{ m}^3/\text{muaj}$ ose $q = 4.5 \text{ l/s}$

Agonas sipas vleresimit te bere nga konsumi ujit $V = 6\,000 \text{ m}^3/\text{muaj}$ ose $q = 2.25 \text{ l/s}$

Golemi sipas vleresimit te bere nga konsumi ujit $V = 55\,000\text{ m}^3/\text{muaj}$ ose $q = 20.5\text{ l/s}$

Depo Maskuri sipas vleresimit te bere mbushet $1.5 - 2$ here ne dite $2 \times 4000\text{ m}^3 = 8000\text{ m}^3$ nga konsumi ujit $V = 248\,000\text{ m}^3/\text{muaj}$ ose $q=92.6\text{ l/s}$.

NE TOTAL SASIA E UJIT TE KONSUMUAR TE VLERESUAR NGA PRODHIMI ESHTË $q=205.85\text{ l/s}$

d) KONSUMI I UJIT NGA RRJETI PAS INVESTIMEVE NE Puset E REJA

Qyteti i Kavajes me investimin e parashikuar per 2025 nga SHRUKD per hapjen e 5 puseve ne zonen Harizaj-Synej-Kavaje ku perfshihen 2 puse te reja ne qytet Kavaje me kapacitet $q=75\text{ l/s}$, ploteson nje pjese te nevojave te per uje dhe ka nevojë per $q=11\text{ l/s}$ nga linja e puseshpimit te Çermes.

Fshati Synej me investimin e parashikuar per 2025 nga SHRUKD per hapjen e 5 puseve ne zonen Harizaj-Synej-Kavaje, plotesohen nevojat per uje te fshatit Synej.

Agonas sipas vleresimit te bere ka nevojë per uje $q=2.25\text{ l/s}$ nga linja e puseshpimit te Çermes.

Golemi sipas vleresimit te bere ka nevojë per uje $q=20.5\text{ l/s}$ nga linja e puseshpimit te Çermes.

Depo Maskuri sipas vleresimit te bere ka nevojë per uje $q=92.6\text{ l/s}$ nga Impanti Maskuri.

NE TOTAL SASIA E UJIT TE KONSUMUAR PAS INVESTIMEVE NE Puset E RINJ ESHTË 126.35 l/s

e) BILANCI I UJIT NE PERFUNDIM TE INVESTIMEVE NE PROÇES TE SHRUKD DHE AKUK

- Aktualisht prodhohet nga pusshpimet Çërme $q=230\text{ l/s}$.
- Nga Bilanci dhe te dhenat nga UKD kemi qe, nga Maskuria konsumohen 92.6 l/s dhe po nga linja e Çermes zona e Golemit merr 20.5 l/s , qe do te thote qe konsumi aktual nga linja qe del nga Pusi i shuarjes eshte 113.1 l/s .
- Per zonen e projektit prurja e ujit ne dispozicion eshte 116.9 l/s .
- Ne prespektive me invesimet ne hapjen e puseve ne zonen Harizaj-Synej-Kavaje dhe venien ne pune me kapacitet te plote te impiantit maskuri do te prodhohet ne zone rreth $q=370\text{ l/s}$ ose rreth $32\,000\text{ m}^3$ ne dite.

5. STUDIMI GJEOLOGJIK

II-1 Baza topografike

Per projektin eshte perdorur studimi i detajuar i kryer ne teren nga ana e grupit topografik si dhe baza topografike nga Harta ne shkalle $1:25000$, Plansheta e Kavaja (K-34-100-A-c) prodhim I vitit 1983, botuar ne vitin 1985.

II-2. Ndertimi gjeologjik

II-2.1. Stratigrafia.

Depozitimet qe takojme ne zonen nen studim jane:

Ne ndertimin gjeologjik te zones te studimit tone takohen depozitime me moshe relativisht te re, te cilat jane:

1. Depozitimet e Mioceni i siperm (N_1^3)
2. Depozitimet e Plioceni i poshtem ($N_2^1 h$)
3. Depozitimet e Plioceni i mesem ($N_2^2 r$)
4. Depozitimet e Kuaternarit (Q_{4al})
5. Depozitimet e Kuaternarit (Q_4)
- 1- Depozitimet Mioceni i siperm.

Tortoniani ($N_1^3 t$)

Keto depozitime kane perhapje te gjere si ne sipërfaqe dhe thellesi. Depozitimet e Tortonianit si ne sipërfaqe dhe ne thellesi perfaqesohen nga dy litofacie. Litofacia ranoro – argjilore, si dhe litofacia argjilo-ranore. Litofacia ranoro - argjilore karakterizohet nga ranore e argjila te nderthurur dhe me gelqerore lithotamnike.

Ranoret paraqiten me ngjyre gri te çelur deri te zverdhur, ndersa ne thyerje te fresket kane ngjyre bezhe te erret. Jane kompakte, kokerrmedhenj, deri kokerrmesem. Trashesite e shtresave luhaten nga 0.5-1.5m. deri 5-6m.

Argjilat paraqiten me ngjyre gri ne te kaltert me ndertim guackor dhe me trashesi 2-3m. deri 15-20m. Shpesh brenda tyre takohen horizonte te ndjekshem me makrofaune 1-2m. te trashes si dhe shumengjyresha. Ne disa rajone tek horizontet e makrofaunes dallohen kristale te vegjel gipsi.

Messiniani ($N_1^3 m$)

Nga ana litologjike ekzistojne dy litofacie, duke pasqyruar pak a shume te njejten histori zhvillimi si ne Tortonian. Litofacia ranoro-argjilore, dhe litofacia argjilo-ranore.

Litofacia ranoro-argjilore perfaqesohet nga nderthurje paketash ranorike me paketa argjila-alevrolitore. Ranoret predominojne ne prerje dhe paraqiten ne trajten e paketave me trashesi 6-7m. deri 15-20. Ne pergjithesi jane kokerndryshem, me shtresezim te pjerret dhe rralle here verehen dhe zaje te vegjel midis ranoreve.

Argjilat kane pamje me teper alevrolitore dhe paraqiten me ngjyre gri hiri. Midis tyre takohen disa horizonte makrofaune te tipit kryesisht ostrea, te ndjekeshme ne distanca te medha. Argjilat paraqiten ne trajten e paketave te trasha, dhjetra metroshe te cilat ne drejtim te lindjes kalojne dora-dores ne argjila jo te pasterta deri me alevrolite. Gipset kane perhapje ne trajte linzash brenda hapsires se kesaj litofacie dhe trashesi deri disa metra.

-2- Depozitimet e Plioceni i poshtem (N_2^1 h) Suita Helmesi:

Depozitimet e formacionit Helmasi fillojnë me shfaqjen në prerje të shtresave ranore dhe konglomerateve të pangopur, që percaktojnë dyshemene e tij dhe njëkohësisht shenojnë praninë e transgresionit pliocenik. Vihet re që në shtrirjen jug-veri trashësia e konglomerateve të bazës rritet. Mbi shtresat ranore dhe konglomeratike prerja vijon me shtresa argjilore dhe paketa argjilo-ranore shtrese holle e mesem.

Ranoret kanë formë shtresore me trashësi nga 4-8 cm deri në 20-30 cm, ngjyrë hiri të verdhë, të shkrifet nga çimentimi i dobët. Ata janë kokërrvegjel dhe mesem, polimineral, të tipit kuarcoro-feldshpatik.

Argjilat dominojnë në prerje, janë gri hiri deri në të kaltertë, të buta deri në kompakte, here-here shumë mikore.

Konglomeratet përbehen nga zaje të përberjes dhe formave të ndryshme. Takohen zaje të rrumbullakuara e gjysem të rrumbullakuara me madhësi mesatare 4-10cm. Janë kryesisht zaje kuarcitesh, serpentinite, gabro-dunitesh si dhe gelqerore e ranore të moshave të vjetra deri në të reja, duke filluar nga ato të Jurasikut.

-3- Depozitimet e Pliocen i mesem (N_2^2 r)

Depozitimet e formacionit "Rogozhina" vendosen mbi pakon argjilore të formacionit "Helmasi" dhe kanë marrëdhënie normale me të. Në sipërfaqe takohen, me të gjitha karakteristikat litologjike të tyre. Keto depozitime kanë karakter trashaman, ranore, gravelite, konglomerate me zaje me ndershtresa të holla argjilash. Në prerjen e suitës fillon me shtresa ranore e alevrolite shtrese holle, mbi të vijnë paketa konglomeratike e zaje që nderthuren me paketa ranori, shtrese mesem, trashë dhe masive me trashësi shtrese deri në 4-6m. Ranoret janë kokërrvegjel deri trashë, shpesh gravelitike, poliminerales, të tipit kuarcoro-feldshpatik me përmbajtje serpentinashe. Në përgjithësi ranoret si dhe alevrolitet përmbajnë koncentracione të larta të metaloreve, të epidotit, granateve, amfiboleve.

Në konglomeratet takohen zaje të rrumbullakosur dhe gjysem të rrumbullakosur të shkëmbinjve magmatike dhe sedimentare. Masa çimentuese e konglomerateve e zajeve është argjilo-alevritor-ranore, gravelitike dhe e tipit bazal. Në ranoret dhe konglomeratet e këtij formacioni gjenden shtresezime të pjerrta e të kryqezuara, karakteristike të trashësisë të formacionit mollasik.

- 4 - Depozitimet Aluviale të Kuaternarit (Q_4 al)

Depozitimet aluviale vendosen direkt mbi tavanin e nderthurieve të pakove ranoro-argjilore. Keto depozitime përfaqësojnë materialin aluvial të tarracave të lumenjeve. Nga përberja litologjike depozitimet aluviale janë të depozitimeve të ndryshme dhe përfaqësohen nga zhavore e zhur (poplat në perindje të paket) kryesisht gelqerore e ranore. Depozitimet aluviale janë të perpunuara deri gjysem të perpunuara. Shkalla e njeshmerisë së tyre është e lartë ndërsa gjendja e lageshtisë së këtyre depozitimeve është e lartë ndërsa gjendja e lageshtisë së këtyre depozitimeve është e ngopur me ujë. Materiali mbushës përfaqësohet nga rere e surere në masën 10-30%.

- 5 - Depozitimet e Kuaternarit (Q4d)

Depozitimet e Kuaternarit perfaqesohen nga depozitimet me origjine detare. Keto depozitime perfaqesojne pjesen e sipërme të prerjes të cilat deri në thellesinë 4.5-5.0m perfaqesohen nga rrera kokermesme me permbajtje zhurri dhe zhavori të imet gelqeror e silicor në masen 10% me ngjyre hiri-bezhe, deri mesatarisht të ngjeshur ndërsa nën të takohen rere e imet detare me ngjyre gri të kaltert pak deri mesatarisht të ngjeshura dhe me veti të dobta gjeoteknike sesa rerrat me ngjyre hiri bezhe (rerat e plazhit). Në pjesen e sipërme të prerjes takohen dhe linza suagjilash e argjilash lymore me pak rere e rrenje pemesh. Me në thellesi keto depozitime kalojnë në surera, suagjila e argjila.



HARTA GJEOLOGJIKE E RAJONIT

II-2.2. Tektonika.

Rajoni që po meret në studim ndodhet në zonën strukturalo-faciale të Ultesirës Adriatike.

ULTESIRA ADRIATIKE

Ultesira Adriatike ndodhet në pjesën qendrore e veriperendimore të Albanideve të jashteme, në buzën e orogjenit në kontakt me platformën Adriatike. Ajo perfaqeson një ultesirë paramalore që shtrihet mbi zonat e Sazanit, Jonike, Kruja dhe basenin e Adriatikut jugor. Në pjesët anësore, sidomos aty ku

vendosen mbi orogjenin depozitimet molasike te ultesires vendosen transgresivisht mbi vazhdimin e strukturave te zones Jonike (Cakran, Kreshpan, Patos-Verbas, etj.) dhe te zones Kruja (sinklinali i mbivendosur i Tiranes). Ne pjesen qendrore ku ajo vendoset mbi zonen e Adriatikut Jugor, pergjithesisht pranohet shuarja e mosperputhjeve dhe mardhenie suksesive te depozitimeve. Ne rajonet jugperendimore, depozitimet molasike te Ultesires, duke filluar nga ato te Burdigalianit e me te reja, vendosen transgresivisht mbi depozitimet karbonatike te zones platformike te Sazanit.

Molasat e mbuleses fillojne nga Seravaliani, duke u ndjekur me lart nga Tortoniani, Mesiniani dhe Pliocenit dhe se fundi edhe nga Kuaternari. Nje rrudhosje e lehte ndodh ne fund te Miocenit. Ne fillimin e Pliocenit, fillon terheqja dhe zhytja e ultesires, shoqeruar me grumbullime te fuqishme (disa km., te sedimenteve te karakterit kryesisht konglomeratik ne buzen lindore (Formacioni Rogozhina) dhe te karakterit me argjilor ne buzen perendimore (Formacioni Helmasi"). Nga fundi i Pliocenit nga kompresioni i fuqishem ndodhi rrudhosja perfundimtare e ultesires ne te cilen u formuan strukturat rrudhosese e shkeputese te saj.

Ne fund te Pliocenit, pasi u formuan strukturat e mesiperme vazhdoi ngritja e strukturave pozitive edhe ne Kuaternar dhe zhytja e sinklinaleve ndarese qe u mbushen me depozitime te moshes ne fjale. Me qe ne lindje te ultesires perhapen moshat e Miocenit rezulton se levizjet pozitive neotektonike, por te diferencuara, me intensitet me te madh ne strukturat pozitive dhe me te vogel ne ato negative, filluan qe ne Pliocen dhe vazhduan edhe ne Kuaternar duke formuar ansamblin gjeomorfologjik te relievit te sotem. Eshte kjo arsyeja qe ne lumin Erzen i cili i pret terthor keto struktura jane formuar edhe 3-4 taraca erozivo-akumuluse deshmi kjo e ngritjeve tektonike ne Kuaternar. Po te merret per baze Tortoniani (ose Serravaliani) me te cilen fillon ultesira ne pjesen me lindore ai vendoset ne trajte pullash ne lartesine 1000 m. mbi strukturen karbonatike te Dajtit kurse ne perendim baza e tij peson nje fleksurim te pernjehereshem nen ballin e mbihypjes dhe shplarje deri ne kuotat 150-250m. pas te cilave ai zhytet ne sinklinalin e Tiranes deri ne disa km. (2-3km.).

Ky fleksurim i madh flet per nje ngritje te fuqishme neotektonike sipas mbihypjes te strukture se Dajtit duke lene reliketet ishullore te relievit te vjeter te asaj kohe mbi lartesine 1000 m.

Per kete ngritje flasin kanionet e prera nga perrenjte qe çajne mespermes kete strukture. Edhe Shpella e Pellumbasit, me ariun e vjeter qe jetonte aty, ne faqen e lumit Erzen ne lartesi te madhe, eshte deshmi e nje ngritje intensive ne kohet e voneshme.

Ne teresi Ultesira Adriatike, duke gjykuar nga ndertimi tektonik dhe sidomos nga mardheniet me katin e poshtem strukturor, mund te ndahet ne tre sektore :

Sektori lindor:- Shtrihet prane buzes lindore te Ultesires, duke filluar nga Kanina-Treblova, Selenice-Kreshpan, Ardenica, Marinze-Bubullime-Kemishtaj. Ky sektor vazhdon me mulden e Kuçoves, Pekisht e me ne veri me mulden e Galushit dhe akoma me ne veri me sinklinalin e Tiranes.

6. PUNIMET TOPOGRAFIKE

Para fillimit të punimeve të bëhet verifikimi i terrenit dhe i kuotave të dhëna në projektin e sipërpërmendur, si dhe përputhshmëria e kuotave në terren, me kuotat e dhëna në projektin e sipërpërmendur, nga një inxhinier gjeodet i licencuar, në prani të supervizorit. Në fund të verifikimit të hartohet proces verbal i përkatës.

Për çdo ndryshim, në kuotë, trasim etj. të projektit, të kontaktohet paraprakisht me projektuesin dhe pasi të jepet zgjidhja nga ky i fundit të mbahet një proces verbal, në prani të supervizorit, projektuesit, zbatuesit, dhe të një përfaqësuesi të porositësit.

Në rast, se vërehen ndryshime të kuotave dhe mospërputhje me projektin, të kontaktohet me supervizorin dhe projektuesin dhe të merren masat përkatëse, për zbatimin me korrektësi dhe në përputhje me kushtet teknike përkatëse (K.T.Z. 26 -81 “Kushte Teknike të Zbatimit dhe Marrjes në dorëzim të Punimeve për Ndërtimin e Rrjetit të Jashtëm të Ujësjellësave dhe Kanalizimeve”) apo standardet në fuqi.

Gjithashtu, të merren masat si dhe të zbatohen rreptësisht kushtet e sigurimit teknik të punimeve, sipas standarteve dhe Kushteve Teknike të Sigurimit Teknik në fuqi, qoftë për punimet e çdo lloji në sipërfaqe, ashtu edhe për punimet e çdo lloji të kryera në thellësi të kanalit apo gropave përkatëse gjatë zbatimit. Punimet duhet të zbatohen rreptësisht me inxhinier gjeodet ose topograf të licencuar për aftësitë e tij në punime zbatimi, sipas planimetrisë dhe profileve gjatësorë, në prezencë të investitorit dhe supervizorit.

7. SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJE

7.1 Trasimi i tubacioneve dhe elementët e sistemit

Rrjeti shpërndares i furnizimit me uje të zonave (DMA) do të jetë me vetërrjedhje, nga depo e re $V=6\,000\text{m}^3$ e cila furnizohen nga stacionet e pompimit Çermes duke ndërtuar linje dergimi te re nga tubacionet ekz. qe dergojne uje ne depot Golem dhe Arrapaj.

Sistemi i rrjetit shpërndares eshte parashikuar të ndërtohen me tubacione prej polietileni me dendësi të lartë PE 100 RC PN 10, me bashkim me manikota me elektrofuzion.

Tubacioni do të trasohet nëntokë në thellësinë $h = 1\text{ [m]} + Dj\text{ [m]}$. Ne nyjet e bashkimit me pusete komandimi thellesia e kanalit 5-10m para pusetes duhet te rakordohet thellesia e kanalit gradualisht me thellesine e pusetes.

Para fillimit të punimeve, kontraktori duhet të kontrollojë mirë kushtet gjeologjike të terrenit si dhe të verifikojë kuotat e dhëna në projekt, me kuotat faktike të terrenit. Duhet të përforcihet mirë, bazamenti i të gjitha pusetave.

7.2 Llogaritjet nevojave per uje.

Per percaktimin e prurjeve karakteristike perdorim formulat e meposhtme:

- Prurja maksimale ditore ne meter kub- $Q_{\max. \text{ dit.}} = \frac{N \times K_d \times n}{1000} \text{ m}^3/\text{d}$
- Prurja maksimale ditore ne sekond - $q_{\max. \text{ dit. sek.}} = \frac{N \times K_d \times n}{3.6 \times 24} \text{ l/s}$

N – Numri i popullsesise ne fund te kohes se projektimit

P – Numri aktual i popullsesise 18132 banore.

i – Shtesa natyrore e popullsesise 1.5 %

t – Periudha e projektimit 50 vjet

n – Norma e furnizimit mesatarisht ditore 150 l/d/banore

K_d – Koeficienti ditor i jouniformitetit $K_d = 1.5$ sipas VKM 83 Dt.10/02/2021 .

K_o – Koeficienti orar i jouniformitetit $K_o = 2.0$ sipas VKM 83 Dt.10/02/2021 .

- Prurja maksimale orare ne meter kub- $Q_{\max. \text{ orare}} = \frac{\left[\frac{N \times K_o \times n}{1000} \right]}{24} \text{ m}^3/\text{d}$
 $N \times K_o \times n$
- Prurja maksimale orare ne sekond - $q_{\max. \text{ orare sek.}} = \left[\frac{1000}{24} \right] / 3.6 \text{ l/s}$

Llogaritjet numerike i paraqesim ne tabelen e meposhtme.


PERCAKTI I PRURJEVE PER FSHATRRAT QERRET - RAKELL - KOLJE												
Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Sasia pas 50 vjetesh	Norma mesatare lidite	Norma l/sek	K. pikut Ditor (VKM 83 Dt.10/02/2021)	$Q_{\max. \text{ dit.}}$ m ³ /dite	$q_{\max. \text{ ditore sek.}}$ l/sek	K. pikut Orar (VKM 83 Dt.10/02/2021)	$Q_{\max. \text{ orar}}$ m ³ /dite	$q_{\max. \text{ orare sek.}}$ l/sek
1	Popullsia Urbane	banor	7872	16572	150	-	1.5	3,728.70	43.16	2.00	207.15	57.54
1	Popullsia Rurale	banor	10260	13166	150	-	1.5	2,962.35	34.29	2.00	164.58	45.72
1	Vizitore	banor	3000	4934	60	-	1.5	444.06	5.14	2.00	24.67	6.85
2	Qender shendetsore	-	3	3	-	0.2	1	51.84	0.60	1.00	0.72	0.20
3	Shkolla	nxenes	210	320	40	-	1	12.80	0.15	1.00	0.53	0.15
Shuma								7,199.75	83.33		397.65	110.46

Duke pranuar qe humbjet e ujit jane rreth 20 % ku nga keto 5 % ne linjen e dergimit dhe 15 % ne linjat e shperndarjes prurja maksimale ditore llogaritese e linjes se dergimit do te jete 100 l/s ndersa prurja maksimale orare do te jete 127.03 l/s sipas VKM 83 Dt.10/02/2021 .

Ndryshimi i kerkeses per uje gjate pikut eshte marre nga studimi i kryer nga kompania “LOTI”Ltd per zonen e Durrësit dhe eshte si me poshte .

Tabela e kerkeses ditore per uje

Ora	0:00	0:42	1:31	2:25	3:30	4:17	4:55	5:28	6:07	6:47	8:02	9:03	9:38	10:30	11:15
Koef.	0.38	0.3	0.24	0.22	0.26	0.39	0.57	0.85	1.21	1.53	1.72	1.69	1.55	1.42	1.35
Ora	12:34	13:23	14:17	15:25	16:26	17:39	18:23	19:01	19:45	20:30	21:12	22:01	22:46	0:00	
Koef.	1.32	1.33	1.27	1.21	1.14	1.13	1.21	1.29	1.31	1.18	1.02	0.83	0.66	0.38	



Ne tabele jepen koeficientet e kerkeses per uje kundrejt asaj te prurjes hyrese ne depo qe i perket prurjes maksimale ditore. Koeficientet ditor dhe orar sipas VKM 83 Dt.10/02/2021, kane raport $Ko/Kd = 2.0/1.5 = 1.33$ ndersa ne grafikun e mesiperm raporti maksimal eshte 1.72 duke qene se ky grafik eshte me perfaqesues ndersa te dhenat nga VKM jane me pergjithesuese per llogaritjet e rrjetit te shperndarjes do te marrim koeficientet sipas tabelës se mesipërme dhe si përfundim prurja llogaritesë maksimale për rrjetin e shpërndarjes do të jetë 164.83 l/s .

8. LLOGARITJET HIDRAULIKE TE VEPRES .

Llogaritjet hidraulike te linjes se shperndarjes jane bere me ante te formules Darsy – Weisbach qe ka formen e meposhtme :

$$Q = S \sqrt{8 \cdot g \frac{R \cdot i}{f}}$$

Q – Prurja qe kalon ne tub

S – Siperfaqja e prerjes terthore te tubit

g – Nxiti i renis se lire

R – Rezja hidraulike e tubacionit

i – Pjerresia hidraulike

f – Koeficienti i humbjeve hidraulike qe gjendet me formulën :

$$\frac{1}{f} = -2 \cdot \log \left(\frac{k}{12 \cdot R} + \frac{2.51}{Re \sqrt{f}} \right)$$

Re – numri i Reynoldsit

e – Koeficienti i ashpersise qe per tubacionet plastike eshte $k = 0.0012m$.

Me ane te perafimeve te njepasnjeshme gjejmë vlerën f për tubacionin për prurjen e dhënë.

Llogaritjet e rrjetit jane bere me programin Epanet te cilat jane pasqyrurar ne tabelat bashkëlidhur

9. LLOGARITJET HIDRAULIKE TE RRJETIT .

Dallojmë:

- *Humbjet e plota të ngarkesës*

$$\Delta h_w = \Delta h_{w.gj} + \Delta h_{w.v}$$

- *Humbjet gjatësore ΔH_{gj}*

Janë humbjet më të rëndësishme. Ato ndodhin si shkak i fërkimit në pjesët e drejta të tubacionit .

Ato janë lineare në lidhje me gjatësinë e tubacionit .

$$\Delta h_{w.gj} = i \times L$$

$\Delta h_{w.gj}$: Humbjet hidraulike gjatësore në metër kollonë uji .

i : Humbjet hidraulike në njësinë e gjatësisë m/m (pjerrësia hidraulike) .

L : Gjatësia e tubacionit në m

Për llogaritjet hidraulike të rrjetit të furnizimit me ujë, standarti European For the hydraulic calculation of drinking water supply systems, the European standard S SH EN 805 (paragrafi 8.3) rekomandon përdorimin e formulës Darcy e plotësuar nga formula e Colebrook-ut .

$$i = \lambda \cdot \frac{1}{D} \cdot \frac{V^2}{2 \cdot g}$$

$$\frac{1}{\sqrt{\lambda}} = 2 \log \left(\frac{3.7 \cdot D}{k} + \frac{\lambda \cdot R}{e \cdot \sqrt{\lambda}} \right)$$

i : pjerrësia hidraulike m/m
 λ : Koeficienti i rezistencës hidraulike
 V : Shpejtësia e ujit në m/s
 g : nxitimi i rënies së lirë në m/s²
 k : Koeficienti i ashpërsisë absolute në mm
 D : Diametri i brëndshëm në mm
 Re : Numri i Reinodsit $Re = \frac{v \cdot D}{\nu}$ ku ν është koeficienti kinematik i viskozitetit

Është specifikuar që koeficienti i ashpërsisë “e” që merret parasysh në llogaritje duhet të jetë : ose , koeficienti k_1 që bashkon tubacionet dhe bashkimet e tyre: në këtë rast ne shtojmë humbjet hidraulike të vëndit .

ose, koeficientin k_2 i cili bashkon veprimin e tubacioneve, bashkimin e tubacioneve, rakorderive, pjesëve speciale dhe valvulave .

Për të përcaktuar ashpërsinë e tubave, duhet të merret parasysh dhe rritja e tij gjatë kohës së punës .

Standarti Europina jep këtë të dhënë për vlerën e e_2 :

Tubacionet e shpërndarjes dhe ato kryesorë

$$0.1 \text{ mm} < k_2 < 0.4 \text{ mm}$$

Degëzimet e tubacioneve

$$0.4 \text{ mm} < k_2 < 1 \text{ mm}$$

Tabelat e Colebrook-ut

Këto tabela japin vlerat e humbjeve njësi (formula e Colebrook-ut) duke përdorur prurjen, diametrin dhe ashpërsinë e tubacionit. Hapi i parë për një tub në kushte të mira, koeficienti standart do të pranohet $k=0.1$ mm.

Shpejtësia (m/s)	Diametrit brendshëm: 100 mm				Diametrit brendshëm : 107 mm			
	Prurja (l/s)	Humbjet(m/km)			Prurja (l/s)	Humbjet(m/km)		
		k=0.05 (mm)	k=0.1 (mm)	k=0.5 (mm)		k=0.05 (mm)	k=0.1 (mm)	k=0.5 (mm)
0.10	0.79	0.17	0.18	0.20	0.90	0.16	0.16	0.18
0.15	1.18	0.35	0.36	0.42	1.35	0.32	0.33	0.39
0.20	1.57	0.58	0.60	0.72	1.80	0.54	0.55	0.66
0.25	1.96	0.87	0.90	1.10	2.25	0.80	0.82	1.01
0.30	2.36	1.20	1.25	1.56	2.70	1.10	1.15	1.43
0.35	2.75	1.58	1.65	2.10	3.15	1.46	1.52	1.92
0.40	3.14	2.01	2.11	2.71	3.60	1.85	1.94	2.48
0.45	3.53	2.49	2.62	3.40	4.05	2.29	2.41	3.11
0.50	3.93	3.02	3.18	4.16	4.50	2.77	2.92	3.81
0.55	4.32	3.59	3.80	5.01	4.95	3.30	3.49	4.59
0.60	4.71	4.20	4.46	5.93	5.40	3.87	4.10	5.43
0.65	5.11	4.86	5.18	6.93	5.84	4.47	4.76	6.35
0.70	5.50	5.57	5.95	8.01	6.29	5.13	5.46	7.33
0.75	5.89	6.32	6.76	9.16	6.74	5.82	6.22	8.39
0.80	6.28	7.12	7.63	10.40	7.19	6.55	7.01	9.52
0.85	6.68	7.97	8.55	11.71	7.64	7.33	7.86	10.72
0.90	7.07	8.85	9.52	13.09	8.09	8.14	8.75	11.99
0.95	7.46	9.78	10.55	14.55	8.54	9.00	9.69	13.33
1.00	7.85	10.75	11.62	16.10	8.99	9.89	10.68	14.74
1.05	8.25	11.77	12.74	17.72	9.44	10.83	11.71	16.22
1.10	8.64	12.84	13.92	19.41	9.89	11.81	12.79	17.78
1.15	9.03	13.95	15.14	21.19	10.34	12.83	13.92	19.40
1.20	9.42	15.10	16.42	23.04	10.79	13.89	15.09	21.10
1.25	9.82	16.29	17.74	24.97	11.24	14.99	16.31	22.86
1.30	10.21	17.53	19.11	26.98	11.69	16.12	17.57	24.70
1.35	10.60	18.81	20.54	29.06	12.14	17.31	18.88	26.61
1.40	11.00	20.13	22.02	31.22	12.59	18.52	20.24	28.59
1.45	11.39	21.51	23.54	33.46	13.04	19.79	21.64	30.64
1.50	11.78	22.91	25.11	35.77	13.49	21.08	23.09	32.75
1.55	12.17	24.37	26.74	38.17	13.94	22.42	24.58	34.95
1.60	12.57	25.87	28.42	40.63	14.39	23.80	26.13	37.22
1.65	12.96	27.41	30.15	43.18	14.84	25.22	27.71	39.54

1.70	13.35	28.99	31.93	45.81	15.29	26.68	29.35	41.95
1.75	13.74	30.62	33.76	48.51	15.74	28.18	31.03	44.42
1.80	14.14	32.30	35.64	51.29	16.19	29.72	32.77	46.96
1.85	14.53	34.02	37.56	54.15	16.64	31.30	34.53	49.59
1.90	14.92	35.77	39.54	57.09	17.08	32.91	36.35	52.28
1.95	15.32	37.56	41.57	60.10	17.53	34.58	38.22	55.03
2.00	15.71	39.41	43.65	63.18	17.98	36.28	40.13	57.87
2.05	16.10	41.30	45.77	66.36	18.43	38.01	42.08	60.76
2.10	16.49	43.22	47.97	69.61	18.88	39.79	44.09	63.73
2.15	16.89	45.21	50.18	72.92	19.33	41.59	46.13	66.78
2.20	17.28	47.22	52.47	76.32	19.78	43.46	48.23	69.88
2.25	17.67	49.28	54.81	79.81	20.23	45.36	50.38	73.07
2.30	18.06	51.39	57.19	83.34	20.68	47.30	52.56	76.33
2.35	18.46	53.54	59.62	86.98	21.13	49.27	54.80	79.65
2.40	18.85	55.72	62.09	90.69	21.58	51.28	57.07	83.05
2.45	19.24	57.94	64.61	94.47	22.03	53.32	59.41	86.52
2.50	19.63	60.21	67.21	98.34	22.48	55.43	61.78	90.06

Vlera që përdoren direkt për ujin në 10°C.

Pjesë nga tabela e Colebrook-ut

- Humbjet e vëndit $\Delta h_{w,v}$.

Ato janë humbje si rezultat i ndryshimit të menjëhershëm në prurje si :

- pjesët lidhëse (ngushtim ose zgjerim, bërryla etj).
- pajisjet matëse (diafragma, ujëmatës etj)
- saraçineska të ndryshme (flutur, pallotë, sferike, etj.)
- pajisje mbrojtëse (filtra, kundra valvula, valvula kontrolli, etj.)

Ato përcaktohen si më poshtë :

$$\Delta h_{w,v} = K \cdot \frac{v^2}{2 \cdot g}$$

$\Delta h_{w,v}$ – Humbjet në m

v – shpejtësia mesatare në m/s

g: 9.81 m/s²

K : koeficienti i humbjeve të vëndit, në funksion të tiptit të pjesëve .

Koeficienti K i humbjeve të vëndit, zakonisht jepet në të dhënat teknike të prodhuesit .

Në praktikë, ne mund të përdorim gjatësinë ekuevalele ose, vlerën teorike që jepet në disa raste ose vlerën nga të dhënat e prodhuesit

Ne mund të përdorim apriori vlerat teorike të koeficientit K .

Dalja e rezervuarit K = 0.5

Hyrja e rezervuarit K = 1.0

Në praktikë mund të përdorim tabelën e gjatësive ekuevalente ose të dhënat nga prodhuesi.

Për të përcaktuar humbjet e vëndit të disa pajisjeve të sistemit, është e preferueshme që të përdoren tabelat përkatëse të prodhuesit. Kjo është e vlefshme për rastin e saraçineskave, matësit e ujit, saraçineskat flutur etj.

Vërejtje :

Eksperienca tregon që shpesh është e vështirë të përcaktohen me imtësi numri i pajisjeve dhe rakorderive në një rrjet të furnizimit me ujë (bërryla, TEE, valvula, reduktues, etj.)

Prandaj, ne zakonisht përcaktojmë humbjet e ujit si totale. Eksperienca tregon që humbjet e vëndit janë rreth 5 deri 15 % të humbjeve hidraulike gjatësore .

Humbjet ne fërkim (gjatësore dhe te vendit)

Humbja nga fërkimi është humbja e presionit të shkaktuar nga rrjedhja e ujit përmes tubacionit në një sistem. Rrjedhja në tuba është zakonisht turbulente dhe ashpërsia e mureve të brëndshme të tubacionit ka ndikim të drejtpërdrejtë në sasinë e humbjeve në fërkim. Humbjet në fërkim përcaktohen nga tipi, madhësia dhe gjatësia e tubacionit dhe sasia e ujit që rrjedh nëpër të.

10. SISTEMI I TRANSMETIMIT DHE SHPERNDARJES

Në këtë pjese do te trajtohet metodologjia për dimensionimin e tubacioneve dhe përzgjedhjen e materialit të tubacionit.

Sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes ndryshojnë, por ata të gjithë kanë të njëjtin qëllim themelor, i cili është shpërndarja e ujit nga burimi/burimet deri tek konsumatorët.

Projektimi i sistemit të ujësjellësave duhet gjithashtu të marrë në konsideratë mënyrën e operimit dhe mirëmbajtja e tyre te bëhet nga një staf me kohë të pjesshme.

Është e rëndësishme që sistemi që ne do te projektojmë të jetë relativisht i thjeshtë ne operim dhe mirëmbajtje.

Metodat e transmetimit dhe shperndarjes se ujit

Uji që do te transportohet nga burimi deri tek konsumatori nëpërmjet njëres prej metodave të mëposhtme:

- Nëpërmjet rrjedhës me gravitet.
- Nëpërmjet pompimit nga rezervuari:

Uji ose;

(a) pompohet ne rrjetin shperndares, pastaj tek konsumatorët, ose

(b) pompohet fillimisht në një rezervuar (depo), pastaj shperndahet me veterrrjedhje nga rezervuari tek konsumatorët.

Kosto për mirëmbajtjen dhe operimin e këtij sistemi është më e lartë se sa e një sistemi me gravitet.

Llogaritjet hidraulike në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes

Do të referohemi përshkrimit të hollësishëm në standartet S SH EN 806.

Terma dhe përkufizime

- Gjatësia e tubacionit l (m)
- Diametri i brendshëm i tubacionit d_i (mm)
- Diametri i jashtëm i tubacionit d_a (mm)
- Trashësia e mureve të tubacionit S (mm)
- Prurja njësi: Faktor që merret parasysht prurjen e kërkuar të aparaturave, kohën e përdorimit dhe shpeshtësinë e përdorimit. Prurja një (1 LU) është ekuivalente me prurjen QA me 0.1 l/s .

Parimet e llogaritjeve për dimensionim

a. Të përgjithshme

Lloji i pajisjeve, kushtet e presionit dhe shpejtësia e lëvizjes së ujit merren parasysht në dimensionim. Kjo pjesë përfshin dhe tubacionet nëntokësor që ndodhen brenda ndërtesave.

b. Lloji i pajisjeve

Një ndërtesë ka pajisje standarte dhe pajisje speciale.

Një pajisje mund të përkufizohet si standarte kur :

- Normat e përdorimit nuk janë më të larta se sa ato të specifikuara në Tabelën 6 .
- Vlera e kërkuar nuk kalon prurjen llogaritëse që jepet në tabelë .
- Nuk është e projektuar për përdorim të vazhdueshëm . Do të quhet me përdorim të vazhdueshëm në qoftë se përdorimi zgjat më shumë se 15 min .

Të gjitha pajisjet e tjera quhen speciale .

c. Kushtet e presionit

Presioni statik në pikën e lidhje është maksimumi 500 kPa (Përfashtim: kopshtet dhe saraçineskat e garazhdeve ku presioni maksimal është 1,000 kPa)

Presioni i ujit në pikën e lidhjes duhet të jetë minimumi 100 kPa

Diferenca mes presionit hidrostatik në pikën më të ulët të lidhjes dhe presionit në pikën me kushte hidraulikisht më të disfavorshme, e zvogëluar me humbjet hidraulike jep lartësinë e dërgimit dhe duhet të jetë me të njëjtin presion .

d. Shpejtësia maksimale e ujit

Në tubacionet kryesore, kollonat e tubave dhe tubat e shpërndarjes duhet të kenë shpejtësinë maksimale 2.0 m/s

Tubat e shpërndarjes në aparaturat e ndryshme (tubat fleksibel) duhet të kenë shpejtësinë maksimale 4.0 m/s .

Metoda e thjeshtë e dimensionimit

a. Të përgjithshme

Kjo metodë e thjeshtë për dimensionimin e tubacioneve i përket pajisjeve standarte. Ajo mund të përdoret vetëm për ndërtesa, në të cilat përmasat nuk janë më të mëdha se mesatarja .

b. Llogaritjet e detajuara

Për dimensionimin e tubacioneve, projektuesi është i lirë të përdor metodën e miratuar nga autoritetet lokale .

d. Prurja njësi

Prurja njësi LU është ekueivalente për prurjen në pikën e lidhjes Q_A me 0.1 l/s.

Norma e prurjes Q_A , Prurja minimale në pikën e lidhjes Q_{min} dhe njësia ekueivalente për pikën e lidhjes.

Pika e lidhjes	Q_A l/s	Q_{min} l/s	Njësia ekueivalente
Lavaman, bide, Kaseta e shkarkimit	0.1	0.1	1
Lavapjatë, makinë larëse a) Lavapjatë, lavaman, dushe	0.2	0.15	2
Saraçineskë për pisuar	0.3	0.15	3
Vaskë për përdorim familjar	0.4	0.3	4
Saraçineske (për kopshte / garazhde)	0.5	0.4	5
Lavaman guzhine për përdorim jo familjar me ND20, vaska për përdorim jo familjar	0.8	0.8	8
Saraçineske DN 20	d	1	15
a) Për pajisje jo familiare, kontrollo me prodhuesin			

Normat e prurjeve të aparaturave Q_A , Q_{min}

e. Zbatimi i metodës së thjeshtë

Njësia ekueivalente duhet të përcaktohet për çdo pjesë të pajisjeve, duke u nisur nga pika e lidhjes . Njësitë ekueivalente shtohen njëra pas tjetrës . Probabiliteti i përdorimit të njëkohëshëm duhet të marrë parasysh. Dimensionimi mund të bëhet në funksion të materialit të zgjedhur nga projektuesi.

Llojet e sistemit të shpërndarjes

Sistemi i shpërndarjes projektohet në dy lloje të cilat janë:

- Sistem i shpërndarjes i degezuar (sistem i hapur)
- Sistem i shpërndarjes i mbyllur (sistem unazor)

Sistemi i hapur

Projektimi i sistemit të hapur është përgjithësisht linear, ku drejtimi i rrjedhjes së ujit në të gjithë tubacionet mund të përcaktohet lehtësisht.

Një nga avantazhet e sistemit me degëzime (hapur) është në përgjithësi kosto më e ulët.

Disavantazhet janë;

- Një problem në një pjesë të linjës kryesore të transmetimit do të sillte mungesën e furnizimit me ujë për konsumatorët që shtrihen poshtë këtij problemi.
- Rezulton se në pjesët me kërkesë të vogël kemi mbetje të klorit të varfëruar dhe ndotje të ujit.
- Gjatë kërkesave të mëdha për furnizim me ujë (pikut), shpejtësitë janë më të mëdha, duke sjellë që edhe humbjet të jenë më të mëdha.

Sistemi unazor

Rrjeti shpërndarës konsiderohet unazor kur ka shumë pak ose asnjë degezim të pa mbullur me rrjetin, si pasojë uji mund të lëvizë në mënyrë të lirshme në të gjithë rrjetin shpërndarës.

Avantazhet sistemi unazor janë:

- Shpejtesi më të ulëta në rrjet reduktojnë ndjeshëm humbjet, gjë që sjell rritjen e kapacitetit për furnizim.
- Avarite në rrjet mund të izoloohen, duke minimizuar ndërprerjen e furnizimit me ujë për konsumatorët.
- Arrihet të bëhet një shpërndarje më e mirë e përmajtjes së klorit në rrjet.

Disavantazhi kryesor i këtij sistemi është përgjithësisht kostoja më e lartë e ndërtimit pasi kërkon gjatësi më të mëdha të tubacioneve për të krijuar sistemin unazor.

Për projektimin e linjës kryesore të transmetimit duhet të marrim në konsideratë, që kjo linjë në rast avarie në rrjetin shpërndarës ose në rast të riparimeve, ky seksion i cili ka probleme mund të izohet, pa sjellë ndërprerjen e furnizimit me ujë të të gjithë konsumatorëve.

Analiza e rrjetit të tubacioneve

Analiza e rrjetit të tubacioneve përfshin vëzhgim të kujdesshem dhe të detajuar të rrjedhës nëpër rrjetin hidraulik të tubacioneve të cilat përmbajnë pjesë të palidhura në sistemet e degëzuara dhe unazor.

Principet bazë që kontrollojnë rrjetin hidraulik janë:

- Ruajtja e sasisë: Sasia e prurjes që futet në një tubacion të sistemit do të jetë e njëjtë me atë që del. Në analizën e rrjetit që ne do të bëjmë, prurja do të përqendrohet në nyje. Një princip tjetër është që shuma algjebrike e sasisë uji që futet me atë që del nga nyja, është zero (0).
- Ruajtja e presionit: Në një pjesë të mbyllur të seksionit ose të qarkut në një sistem hidraulik, shuma algjebrike e energjisë (humbjeve) në seksionin e tubit është zero.

Analizimi I rrjetit nga programet kompjuterike

Për analizimin e rrjeteve gjenden një numër i madh i programe kompjuterike të cilat zgjidhin matematikisht ekuacionet hidraulike për gjitha nyjet e tubacioneve të rrjeteve të hapura dhe unazor. Programi kompjuterik kërkon nga konsulenti që të krijojë (vizatojë) një rrjet model të furnizimit me ujë duke futur në programin kompjuterik informacione që përfshijnë gjatësitë e tubacioneve, nyjet dhe kuotat, lidhja e tubacionit dhe e nyjeve, kërkesën për ujë dhe presion në çdo nyjë, të dhëna rreth pompes, kuota e rezervuarit, kuota dhe sasia e prurjes nga burimi.

Epanet Software (programe)

Ndërmjet Software-it EPANET, ne si projektues do të modelojmë rrjetin e furnizimit me ujë me të gjithë elementet si STP, Depo, linjat e dergimit dhe shpërndarjes.

Karakteristikat kryesore të EPANET-it në projektimin e rrjetit është:

- Përballuar sisteme shpërndarëse të çdo lloji madhësie;
- Kryer llogaritje të humbjeve në fërkim duke përdorur formulat Hazen-Williams, Darcy Weisback, apo Chezy-Mannings;
- Përfshire humbjet hidraulike minore të brrylave, paisjeve, etj.

Procesi i projektimit me anë të EPANET-it, zakonisht përfshin planimetrin e rrjetit të tubacioneve, futjen e të dhënave të rrjetit, simulimin e modelit hidraulik, kontrollin e rezultateve, modifikime në model duke korrigjuar të dhënat nga rezultatet dhe modifikimin derisa të arrijmë në kriteret e kërkuara ose në rezultate të pranueshme.

Planifikimi Baze

Nga hartat topografike dhe ortofotot do të mblidhen të dhëna për aksin e shtrirjes së tubacionit, gjatësitë e tubacioneve dhe kuotat e nyjeve që lidhin tubacionet. Me pas këto materiale i vihen në dispozicion topografeve për matjet në terren dhe nxirjen e kuotave të sakta sipas gjurmës së percaktuar me parë. Pasi të ketë përfunduar matjet topografike, të jenë mbledhur të dhënat e popullatës dhe konsumatorit në zonë dhe të jenë percaktuar saktë të dhënat hidrogeologjike të burimit do të fillojë puna projektuese e të gjithë sistemit.

Projektimi i kërkesës për ujë

Kërkesa maksimale ditore për furnizim me ujë në fund të periudhës së projektimit do të jetë baza për llogaritjet hidraulike të rrjetit.

Trasimi I Tubacioneve

Duke përdorur hartën topografike, ortofotot dhe matjet topografike në terren, është bërë shtrimi i tubacioneve të rrjetit. Gjithashtu do të paraqitet edhe vëndodhja e burimit dhe të rezervuarit.

Tubacionet do të shtrihen përgjatë rrugëve ekzistuese duke mbuluar të gjithë popullatën e marrë në studim. Nyjet do të vendosen në pozicionet ku kryqëzohen tubacionet, kryqëzime rrugësh, etj.,

Shpërndarja e kërkesë për ujë

Pasi të jete bërë pozicionimi i tubacioneve në hartë, në zonën e operimit do të ndajmë në n/zona. Kërkesa mesatare ditore për vitin e projektuar do të shpërndahet të gjitha nyjeve në zonë e shërbimit. Në shpërndarjen e kërkesës ne do të marrim parasysh edhe numrin e ndryshueshëm të banesave që lidhen në secilën nyje.

Formatimi i të dhënave hyrëse

Shumica e programeve kompjuterike të analizës hidraulike kanë të njëjtat kërkesa për të dhënat. Po kështu edhe programet që ne do të përdorim në llogaritjen e rrjetit. Këto të dhëna janë të grupuara në të dhënat e tubacionit dhe të dhënat e nyjeve. Të dhënat e tubacionit janë caktuar si numri i tubit, diametri (mm), C-value, nyjet e tubit gjatësia (m). Të dhënat e nyjeve janë numri i nyjes, lartësia (m), dhe kërkesa (lps). Zakonisht, vlerat e kriterëve të projektimit kerkohen nga programi kompjuterik (të cilat do të vendosen nga ne si projektues).

Simulimi i Rrjetit Hidraulik

Ky hap bëhet nepermjet Softwar-it EPANET që ne si projektues do të përdorim. Në qoftë se të gjithë të dhënat e kërkuara janë vendosur nga ne si projektues, programi mund vazhdojë me llogaritjet e modelit hidraulik. Programi llogarit humbjet hidraulike (m), normën e humbjeve (m/km) në çdo tub, shpejtësinë e prurjes (m/s), dhe presioni në çdo nyje (m). Modelit i jepet komanda për kryerjen e llogaritjeve për:

- Kërkesën e pikut orar, për të kontrolluar vlerat e mundshme të presionit minimal në rrjet.
- Kërkesën minimal, për të kontrolluar vlerat e mundshme të presionit maksimal në rrjet.

Kontrolli i Rezultateve të Rrjetit

Zakonisht nga simulimi kompjuterik mund të shfaqen të gjitha parametrat e mundshme hidraulike. Nga këto parametra, do të shqyrtojmë rezultate T si;

(a) pikat në të cilat presioni në sistem është poshtë 7m, dhe

(b) tubacionet të cilat kanë normë humbje më të madhe se kriteri i projektimit 10 m/km. Gjithashtu të shqyrtojmë balancimin e prurjes në rezervuar dhe të analizojë n.q.s mbushja dhe zbrazja e rezervuarit janë të pranueshme për volumnin e tij.

Rregullime në modelin hidraulik

Bazuar në rezultatet e simulimit kompjuterik, do të përmiresojmë modelin duke rregulluar të dhënat e tubacioneve dhe të nyjeve për ato parametra që nuk janë brenda parametrave të projektimit.


Modeli i rregulluar do të simulohet përsëri në program. Pas simulimit, rezultatet shqyrtohen dhe modeli ribëhet. Ky proces do të përsëritet deri sa të arrihen kriteret e projektimit.

Finalizimi i konfigurimit të modelit hidraulik

Ky model do t'i nënshtrohet përsëritjeve të vazhdueshme të simulimit dhe të rregullimeve derisa nga ne si projektues të arrijmë në një konfigurim të rrjetit shpërndarës sipas kriterëve të projektimit.

Kriteret e Projektimit të Tubacioneve;

- Rjeti i tubacioneve shpërndarës do të jetë i projektuar që të përballojë kërkesën e pikut-orar të rrjetit:
- Presion minimal në pikën fundore të sistemit = 25 m kolonë uji.
- Shpejtësitë maksimale e prurjes në tubacione:
 - a) linja e transmetimit = 3 m/s
 - b) linja e shpërndarjes = 1.5 m/s
- Shpejtësia minimale e prurjes në tubacione = 0.4 m/s
- Humbjet hidraulike të lejuara: nga 0.5 m/km deri në 10 m/km
- Presionet e lejuara: minimum = 15 m kollonë uje, maksimumi = 70 m kollonë uje.



Planimeria e linjave kryesore të shpërndarjes



Planimeria e 25 zonave te shperndarjes

Per zonen e projektit eshte bere modelimi i tij ne programin Epanet dhe sipas procedures se pershkruar me lart jane marre rezultatet e llogaritjes.

Ne modelin e bere jane ndare zonat e furnizimit me uje dhe ne pikat e lidhjes jane vendosur valvulat e reduktimit te presionit per te pasur nje rrjet me presione me te vogla per te ulur ne maksimum humbjet e ujit ne rrjet si dhe per te patur presionin ne zonat e konsumatoreve brenda parametrave te lejuar .

Zona e projektit eshte ndare ne 25 zona sherbimi (D.M.A) ku per secilen zone eshte vendosur pika e lidhjes ne rrjetin kryesor shperndares.

Rezultatet per llogaritjen e linjes se dergimit jepen me poshte:

LLOGARITJA E HUMBJEVE NE TUBACIN SIPAS Darcy - Velshbah

	Linja P.Shuarje - Qerret	Qerret - Depo 6000 m ³	Qerret - Depo 4000 Dures
Q l/s =	230	100	130
Emertim	Tubi 1	Tubi 2	Tubi 3
Q =	0.23	0.1	0.13
Presioni =	Gize	Pn 10	Gize
Dj =	502.00	400.00	502.00
t =	1.00	23.70	1.00
Db =	500	352.6	500
L =	5330	2900	12300
e =	0.00025908	0.00000292	0.00025908
nju =	1.14E-06	1.14E-06	1.14E-06
v =	1.17	1.02	0.66
Re =	5.13E+05	3.16E+05	2.90E+05
f =	0.0177	0.0144	0.0183
Hw =	13.23	6.33	10.08
Hw.l (10%) =	2.65	1.27	2.02
Htot =	15.87	7.60	12.10
ihidraul =	0.002977	0.002621	0.000984

K.P.Shuarje =	100.20	K. Pres. Pika Qerret =	84.33
K.Depo Qerret =	75	K. Pres. Depo Qerret =	76.73
K.depo Arapaj =	60.00	K. Pres. Depo Arapaj =	72.23


Rezultatet per pikat e hyrjes ne zonat e sherbimit jepen me poshte:

Tabela e pergjithshme e rezultateve per zonat e sherbimit									
Nr.	Emertimi I zones	Puseta	Kuotat e terrenit		Prurjet			Presionet ne pikat e hyrjes	
			K min (m)	Kmax (m)	Qmes (l/s)	Qmin (l/s)	Qmax (l/s)	Pmin (bar)	Pmax (bar)
1	Fshati Qerret								
1.01	Zona 1	Puseta P-02	3.50	0.50	0.86	0.19	1.48	6.04	7.11
1.02	Zona 2	Puseta P-02	3.50	0.50	1.53	0.33	2.64	6.04	7.11
1.03	Zona 3	Puseta P-03	3.49	0.50	3.61	0.79	6.21	6.08	7.12
1.04	Zona 4 & 5	Puseta P-03	3.49	0.50	5.19	1.14	8.93	6.08	7.12
1.05	Zona 6	Puseta P-05	0.62	0.00	17.22	3.79	29.61	6.01	7.3
1.06	Zona 7	Puseta P-06	1.00	0.00	13.35	2.94	22.97	6.08	7.39
1.07	Zona 8	Puseta P-07	0.95	0.00	1.16	0.25	1.99	6.04	7.35
1.08	Zona 9	Puseta P-08	0.87	0.00	1.10	0.24	1.9	6.04	7.36
1.09	Zona 10	Puseta P-09	1.01	0.00	2.82	0.62	4.85	6.04	7.36
1.10	Zona 11	Puseta P-10	1.00	0.00	2.74	0.61	4.72	6.02	7.35
1.11	Zona 12	Puseta P-11	1.00	0.00	1.44	0.31	2.48	6.02	7.35
1.12	Zona 13	Puseta P-12	1.00	0.00	1.10	0.24	1.9	6.01	7.35
1.13	Zona 14	Puseta P-15	1.00	0.00	2.91	0.64	5.01	5.97	7.36
1.14	Zona 15	Puseta P-17	0.91	0.00	3.35	0.74	5.76	5.85	7.39
1.15	Zona 16	Puseta P-17	1.10	0.00	1.37	0.3	2.35	5.85	7.39
1.16	Zona 17	Puseta P-16	0.50	0.00	0.63	0.14	1.08	5.84	7.33
1.17	Zona 18	Puseta P-18	1.02	0.00	0.41	0.09	0.7	6.02	7.35
1.18	Zona 19	Puseta P-19	3.00	1.00	0.96	0.21	1.65	5.83	7.15
1.19	Zona 20	Puseta P-19	3.00	1.00	2.45	0.54	4.21	5.83	7.15
1.20	Zona 21	Puseta P-01	7.00	5.00	0.89	0.2	1.53	5.58	6.77
1.21	Zona 22	Puseta P-01	7.00	5.00	1.03	0.23	1.78	5.58	6.77
2	Fshati Agonas								
2.01	Agonas 1	Puseta P-K1	31.82	28.00	0.97	0.21	1.66	4	4.37
2.02	Agonas 2	Puseta P-K3	12.77	8.00	5.77	1.28	9.92	5.63	6.22
3	Fshati Kolje								
3.01	Kolje	Puseta P-K2	13.50	6.00	11.29	2.49	19.42	5.62	6.15
4	Fshati Rrakell								
4.01	Rrakell	Puseta P-K4	6.56	4.00	11.67	2.57	20.08	6.03	6.82

Per rezultatet e llogaritjeve te tubacioneve dhe nyjeve shiko materialin bashkangjitur

Llogaritjet e volumit te depos.

Llogaritjet e vellimit te depove per zonen e projektit eshte bere nga modelimi i hidraulik i zones se projektit. Per te percaktuar sakte vellimin perpunues te depos koha e modelit eshte marre 168 oreshe ose 7 diteshe .



Nga kjo rrezulton qe vëllimi perpunues i nevojshem per depon eshte 4500 m³.

Duke patur parasysh vendin dhe zonen e sherbimit si dhe rrezerven e zjarrit depoja eshte pranuar te jete me vëllim $V=6\,000\text{m}^3$.

11. OBJEKTI I VEPRËS

Objekti i kësaj vepre teknike është hartimi i rrjetit te furnizimit me ujë per fshatrat Agonas, Kolje, Rakell, Qerretit. Ndërhyrja në këtë zonë bëhet për të:

- Furnizuar me ujë zonën e banuar.
- Përmirësuar orarin e furnizimit me ujë ne 24 orë,
- Përmirësimin e sasisë së ujit për frymë,
- Përmirësimin e cilesisë së ujit,
- Ulur humbjet ne rrjet
- Zevendesuar linjat ekzistuese te amortizuara

Projektuesi ka marrë në konsideratë gjendjen ekzistuese qe i sherbejne projektit te ri. Projektuesi ka kryer azhurnimet dhe matjet topografike te nevojshme. Jane identifikuar te gjitha ndertesat, tipologjia e tyre, numri i kateve dhe numri i konsumatoreve ne ndertese.

Projekti i hartuar me qellim plotesimin e kerkesave qe ajo ka per furnizmin me uje te konsumatoreve 24-ore, menaxhim sa me efikas dhe me kosto te ulet te gjithe rrjetit shperndares.

Ne vazhdim te punes u trasuan te gjitha linjat e rrjetit sipas nevojës per uje nisur nga eksperienca e grupit te projektimit dhe u kryen llogaritjete hidraulike per te gjithë skemen. Skema e rretit te shperndarjes eshte unazor per te rrualtur presione konstante per fshatin Qerret dhe i hapur per fshatrat Agonas, Kolje dhe Rakell.

Nga llogaritjet paraprake hidraulike u konstatuan zonat problematike qe nuk furnizohen me uje, nuk kane presionin e duhur ose kane humbje te medha hidraulike. Me pas u ndryshuan te gjitha

dimensionimet e tubacioneve dhe u rillogarit skema hidraulike disa here deri sa u rregulluan te gjithë parametret teknik te domosdoshem per nje rrjet shperndares.

Pas dimensionimit te rrjetit per te cilat ishin vendosur paraprakisht parametrat teknik te depovs u kryen llogaritjet e skenareve te ndryshem 24-orare dhe 7-ditore per te cilat u moren te dhenat qe kapaciteti i depoa ekzistuese Agonas 200m³ nuk perballon nevojat e konsumatoreve. Nga rillogaritja hidraulike dhe percaktimi i volumit te ujit rezerve sipas kushtit teknik, u percaktua volumi e nevojshme i depovs per funksionimin normal te rrjetit. Per kete arsye e u vendos ndertimi i depovs re $V=6\ 000\text{m}^3$ e cila ploteson nevojat. Depo eshte pozicionuar ne koder mbi rezervuarin e bujqesis Agonas, pasi te depo ekz. nuk ka vend te lire.

Në këtë projekt përfshihet ndertimi i pusetes ne linjen e dergimit ne tubacionin ekzistues Gize 500mm qe vjen nga puse-çpimet e Çermes, linja e dergimit nga puseta ne depo, ndertim depo $V = 6000\text{m}^3$, ndertimi i linjes kryesore te shperndarjes nga depo deri te tubacioni tip unaze e Qerretit ku furnizohen 3 fshatrat Agonas, Kolje, Rakell me 3 puseta manovrimi, rrjeti unazor i Qerretit i paisur me 22 puseta ku furnizohen 22 zona (22 DMA) dhe linja kryesore e shperndarjes nga tubacioni PE 400mm i rrjetit shperndares nga Golemi qe vjen nga Maskuria deri ne linjen e shperndarjes Qerret tip Unaze..

Rrjeri shperndares i zonave fillon ne puseten e komandimit, ka te parashikuar hidrant ne pikat kryesore te zones dhe shkon deri te ndertesa e abonentit me tub PE 100 RC, DN 25-40-63mm dhe ne varesi te llojit te nderteses vile ne fshat, vile ne bregdet, pallat per te cilat jane parashikuar vendosja e kasetave te matesit DN 20-40mm.

Kalimi i linjave behet ne rruge ekzistuese te shtruar me asfalt, pllaka betoni, shtrese betoni, çakull dhe toke per te cilat sipas rastit jane parashikuar riparimi dhe kthimi ne gjendjen e meparshme. Ne segmentet ku tubacioni dergimit dhe kryesori shperndarjes intersekon rrugen kryesore Tirane – Kavaje, sekondare Kavaje – Golem do te kalohet me mikrotunel me qellim shmangjen e bllokimit te rruges.

Zona qe trajtohet nga projekti eshte rreth 470 ha, dhe lartësia e terrenit varjon nga rreth 0.00 m m.n.d. deri ne 70.00 m m.n.d.

Duke qene e zhvilluar me shumellojshme tipologji ndertesash, dendesi te madhe te popullsie rezidente rreth 18 000 banore, turiste sezonale 3000 dhe permiresimi i furnizimit ne oren e pikut eshte e domosdoshme ndertimi i depo uji me volum 6 000m³ ne kodren mbi rezervuarin e bujqesise Agonas.

Zona e projektit perfshin zonen e fshatit Qerret, me ndertesa 1-2 kate ne zonat rurale Agonas, Kolje, Rakell dhe Qerret fshat, vila 1-3 kate prane fshatrave turistike, hotele dhe pallatet 4-9 kate anes detit te cilat ofrojne aktivitete sherbimi te ndryshme qe funksionojne kryesisht ne sezonin e veres. Kjo zone eshte e zhvilluar pas viteve 90 me me godina informale te cilat jane ndertuar pa plan te detajuar ne zonat rurale dhe zona turistike e cila eshte ndertuar me leje dhe me plane zhvillimi ka ndryshuar numrin e konsumatoreve, rritjen e kerkeses per uje sipas kushteve te reja higjeno-sanitare, per rjedhoje rritjen e nevojës uje dhe ulur presionin ne rrjetit ekzistues te fshatit Qerret.

12. PERSHKRIM I PUNIMEVE PER NDERTIMIN E DEPOS SE RE

Pas llogaritjeve hidraulike dhe kerkeses per uje te popullates rezultoi se kapaciteti perpunues i depos eshte 6 000 m³ dhe nuk perballohet nga depo ekzistuese Agonas e cila eshte 200 m³. Nga vzhgimi i territorit nuk ka hapesire per te ndertuar depon ne nje pozicion tjetër dhe komunikimi me zyren teknik ete UKD u vendos qe depo e re te vendoset prane rezervuarit te Agonasit.

13. PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Ky projekt parashikon të ndërhyjë me investime per furnizimin me uje te fshatrave Agonas, Kolje, Rakell dhe Qerret. Do te ndertohen linja të reja ujesjellesi në drejtim të konsumatorit të cilët do të lidhen ne rrjet pasi të kenë lidhur kontratat bazuar në legjislacionin ne fuqi per furnizimin me uje te pijshem. Projekti eshte konceptuar te jete i perbere nga disa tubacione me material PE 100 RC te cilat do te ndara per secilin fshat me pusete komandimi.



Planimetri e pergjithshme e linjave kryesore te shperndarjes dhe 25 DMA

Linja e Dergimit, Tubi Gizes 500mm nga S.T.P Çërme

Pika e furnizimit me uje e objektit tone eshte tubi ekzistues Gize DN 500 mm qe vjen nga puseshpimet e Çërmes ne drejtim te Durrësit. Ne zonen e Kavajes, ne rrugen dytesore afer ures automobilistike dhe nenkalimit te trenit dhe do te ndertohet puseta e linjes se dergimit P.D. me permasa 7.6 x 3.1m ku do te behet lidhja e tubit ekzistues me tubin e ri PE 100 RC PN 10 bar DN/OD 400mm. Linja e re intersekton rrugen nacionale dhe kalon ne rruge automjetesh e asfaltuar ku ne perfundim te punimeve do te kthehet ne gjendjen e mepareshme. Vendosja e tubacionit te ri ne infrastrukturen publike nuk lejon nderhyrjet e paligjshme nga banoret pasi eshte ne dukshm dhe manovrimi i rrjetit behet me mire nga ana e punetoreve te ndermarjes.



Planimetria e linjes se dergimit

Puseta P.D eshte e pajisur me aksesoret e nevojshem me material Gize per manovrimin dhe mirembajtjen e rrjetit, me saraçineska tip Flutur, mates uji dhe pjeset çmontuese, ne rastet e zevendesimit te rakorderive. Puseta eshte vendosuar ne toke dhe eshte parashikuar qe te jene me kapak gize te cilat jane te papershkueshme nga ujrata sipërfaqësor me qellim qe pusetat te jene te thata dhe te aksesueshme ne cdo dite te vitit. Pusetat jane me beton te armuar te cilat jane te hidroizoluara nga jashte dhe te paisura me waterstop ne bashkimet e fugave te mureve me pllaken e pusetes. Pusetat jane te paisura me shkalle inoksi te fiksuara me bulona ne murin e betonit sipas vizatimit tip perkates.

Gjurma e tubacionit kalon ne rruge te asfaltuar dhe pjeserisht rruge me stabilizant. Ne perfundim te punimeve rruga, bankina dhe trotuari do te kthehen ne gjendjen e mepareshme per te cilat jane parashikuar ne projekt ne seksionit tip shtresat dhe ne preventivin e punimeve zerat perkates.


Depo e Re $V=6000 \text{ m}^3$

Ndertimi i depos se re ne pozicionin e depos ekzistuese Agonas nuk eshte e mundur pasi permasat e territorit te saj nuk mundesojne ndertimin e depo me $V= 6000\text{m}^3$. Vendorsja e depos se re ne kodren mbi rezervuarin e bujqesise Agonas ka ardhë si mungeses e sheshit te lire te ndertimit ne teritorin ekz. dhe qe furnizohet nga presioni e linjes Gize 500mm.




Ortofoto e vendodhjes se depos

Ne projekt dhe preventiv jane parashikuar germimi i seksionit te lire per bazamentin e depos se re. Depo eshte e perbere nga dy dhoma uji dhe dhoma e manovrimit. Depo eshte e rrethuar, sistemuar, ndricuar. Depo eshte konstrukcion B/A C 30/37 me termicitet te ulet me cemento tip IV. Themelet e depos jane tip pllake, muret e jashtme jane me trashesi 40cm me kollona 50x70cm ndersa muret e brendshme jane me trashesi 50cm. Soleta eshte monolite me trashesi h=20cm dhe trare.



Planimetria e depos




Prerje gjatesore e depos

Depo eshte mbi toke dhe eshte parashikuar hidroizolimi dhe termoizolim nga jashte per te eliminuar filtrimet ujrave sipërfaqesore dhe ndikimi i temperatures. Gjithashtu eshte parashikuar hidroizolimi i depos nga brenda me qellim eliminimin e rrjedhjeve ne bashkimet e betonit, ngjeshja jouniforme ose vrimat e puntelave te cilat sherbejne per montimin e armatures se hekurit. Dhoma e manovrimit eshte me tre kate me konstruksion metalik me dysHEME betoni.

Linja Kryesore e shperndarjes te fshatrave Agonas, Kolje Rakell dhe Qerret

Projekti i furnizimit me uje i linjave te shperndarjes eshte parashikuar te furnizohet ne dy drejtime nga depo e re $V=6\,000\text{m}^3$ dhe linja kryesore e shperndarjes nga depo Maskuri duke u lidhur ne tubin PE 400 mm te zones Golem.

Ky rrjet shperndares eshte konceptuar nepermjet nje linje kryesore ne tubin PE100RC DN 450-400 mm nga depo e re rez.Agonas me ane te pusetave te manovrimit do te furnizoje me uje fshatrat Agonas, Kolje, Rakell dhe Qerret ne nje pike per cdo DMA.



Planimetria e linjes kryesore te shperndarjes


Linjat e reja PE100RC DN/OD 450-400 mm kalojne pjeserisht ne rruge automjetesh e asfaltuar dhe pjeserisht ne rruge betoni e cakulli, ku ne perfundim te punimeve rruga do te kthehet ne gjendjen e mepareshme. Vendosja e tubacionit te ri ne infrastrukturen publike nuk lejon nderhyrjet e paligjshme nga banoret, pasi eshte ne vend te dukshem dhe manovrimi i rrjetit behet me mire nga ana e punetoreve te ndermarjes. Seksioni i kanalit do te mbushet me gure kave dhe shtresat rrugore jane me

asfalobeton 4cm, binder 6cm, stabilizant 10cm, shtrese çakull mali 20cm dhe stabilizant 20cm, shtrese çakull mali 20cm ne rruget e pashtuara. Pusetat e zonave P.K. 1-5 jane pajisur me aksesoret e nevojshem me material gize per manovrimin dhe mirembajtjen e rrjetit me saraçineska tip Flutur, saraçineske me Volant, pjeset çmontuese, Combi Tee, Tee, Filter, Reduktues Presioni, Mates uji Induktiv, Bryla etj.

Te gjitha pusetat jane te vendosuara ne toke dhe eshte parashikuar qe te jene me kapak gize te cilat jane te papershkueshme nga ujrat siperfaqesor me qellim qe pusetat te jene te thata dhe te aksesueshme ne cdo dite te vitit. Pusetat jane me beton te armuar te cilat jane te hidroizoluara nga jashte dhe te paisura me waterstop ne bashkimet e fugave te mureve me pllaken e pusetes. Pusetat jane te paisura me shkalle inoksi te fiksuara me bulona ne murin e betonit sipas vizatimit tip perkates. Linja kryesore e shperndarjes eshte e pajisur me ajruesi I vendosur ne pustet betoni me kapak gize.

Rrjeti shperndares i fshatit Agonas

Ky rrjet shperndares kane si pike furnizimi linjen kryesore PE100RC 450-400mm cila furnizohet nga Depo e Re 6000m³. Zona lidhet me linjen kryesore, me tub PE 100RC, DN/OD 125-90 mm ne puseten P.K.1 dhe P.K.2 e cila eshte e pajisur me te gjitha rakorderite e nevojshme sipas radhes ne vizatim dhe tabelas se materialeve per kete pusete.




Planimetria e rrjetit shperndares fshati Agonas

Karakteristikat teknike te tubave jane PE 100 RC DN/OD 125÷25mm, PN 10 bar. Ne rastet e renies se zjarrit ne projekt jane parashikuar ndertimi i hidranteve DN 80 mm nentokesor te vendosuar ne trotuar ose rruge sipas rastit.

Në zonë kemi me shume ndertesa individuale 1÷3 katëshe te cilat lidhen me rrjetin me pusete me permasa 55x30cm me mates 25mm me fushe te njome dhe me pak ndërtime mbi 3-kate, biznense te cilat lidhen me pusete me permasa 65x30cm me mates 32mm me fushe te njome. Lidhja e konsumatoreve me rrjetin e furnizimit me uje behet me ane te pusetave individuale sipas tipologjise se ndertesave dhe ne pusete shperndarje 5-7 dalje ku jane perfshire te gjitha punimet dhe rakorderite qe nevojiten deri te lidhja ne banesa.

Rrjeti shperndares i fshatit Kolje

Ky rrjet shperndares kane si pike furnizimi linjen kryesore PE100RC 450-400mm cila furnizohet nga Depo e Re 6000m³. Zona lidhet me linjen kryesore, me tub PE 100RC, DN/OD 160 mm ne puseten P.K.3 e cila eshte e pajisur me te gjithë rakorderite e nevojshme sipas radhes ne vizatim dhe tabelës se materialeve per kete pusete.



Planimetria e rrjetit shperndares fshati Kolje


Karakteristikat teknike te tubave jane PE 100 RC DN/OD 160÷25mm, PN 10 bar. Ne rastet e renies se zjarrit ne projekt jane parashikuar ndertimi i hidranteve DN 80 mm nentokesor te vendosuar ne trotuar ose rruge sipas rastit.

Në zonë kemi me shume ndertesa individuale 1÷3 katëshe te cilat lidhen me rrjetin me pusete me permasa 55x30cm me mates 25mm me fushe te njome dhe me pak ndërtime mbi 3-kate, biznensete cilat lidhen me pusete me permasa 65x30cm me mates 32mm me fushe te njome. Lidhja e

konsumatoreve me rrejtin e furnizimit me uje behet me ane te pusetave individuale sipas tipologjise se ndertesave dhe ne pusete shperndarje 5-7 dalje ku jane perfshire te gjitha punimet dhe rakorderite qe nevojiten deri te lidhja ne banesa.

Rrjeti shperndares i fshatit Rakell

Ky rrjet shperndares kane si pike furnizimi linjen kryesore PE100RC 450-400mm cila furnizohet nga Depo e Re 6000m³. Zona lidhet me linjen kryesore, me tub PE 100RC, DN/OD 160 mm ne puseten P.K.4 e cila eshte e pajisur me te gjitha rakorderite e nevojshme sipas radhes ne vizatim dhe tabelës se materialeve per kete pusete.




Planimetria e rrjetit shperndares fshati Rakell

Karakteristikat teknike te tubave jane PE 100 RC DN/OD 160÷25mm, PN 10 bar. Ne rastet e renies se zjarrit ne projekt jane parashikuar ndertimi i hidranteve DN 80 mm nentokesor te vendosuar ne trotuar ose rruge sipas rastit.

Në zonë kemi me shume ndertesa individuale 1÷3 katëshe te cilat lidhen me rrjetin me pusete me permasa 55x30cm me mates 25mm me fushe te njome dhe me pak ndërtime mbi 3-kate, biznensete cilat lidhen me pusete me permasa 65x30cm me mates 32mm me fushe te njome. Lidhja e konsumatoreve me rrejtin e furnizimit me uje behet me ane te pusetave individuale sipas tipologjise se ndertesave dhe ne pusete shperndarje 5-7 dalje ku jane perfshire te gjitha punimet dhe rakorderite qe nevojiten deri te lidhja ne banesa.

Linja kryesore e shperndarjes nga Maskuria per fshatin Qerret

Pika e furnizimit me uje e objektit tone eshte tubi ekzistues i PE 400 mm qe vjen nga Depo Maskuri. Ne zonen e Golemit, ne rrugen dytesore do te behet lidhja e tubit ekzistues me tubin e ri PE 100 RC PN 10 bar DN/OD 400mm. Linja e re intersekton rrugen dytesore dhe kalon pjeserisht ne rruge automjesh e asfaltuar ku ne perfundim te punimeve do te kthehet ne gjendjen e mepareshme. Vendosja e tubacionit te ri ne infrastrukturen publike nuk lejon nderhyrjet e paligjshme nga banoret pasi eshte ne dukshm dhe manovrimi i rrjetit behet me mire nga ana e punetoreve te ndermarjes.




Planimetria e linjes kryesore te shperndarjes nga Maskuaria

Gjurma e tubacionit kalon ne rruge te asfaltuar, trotuar dhe pjeserisht rruge me stabilizant. Ne perfundim te punimeve rruga dhe trotuari do te kthehen ne gjendjen e mepareshme per te cilat jane parashikuar ne projekt ne seksionit tip shtresat dhe ne preventivin e punimeve zerat perkates.

Linja e shperndarjes tip unaze e fshatit Qerret


Projekti i furnizimit me uje i linjave te shperndarjes te fshatit Qerret dhe zones turistike eshte parashikuar te furnizohet ne dy drejtime nga linja kryesore qe vjen nga depo e re $V=6000m^3$ dhe linja kryesore qe vjen ga depo Maskuri duke u lidhur ne tubin PE 400 mm te zones Golem. Ky rrjet shperndares eshte konceptuar nepermjet nje linje kryesore unaze, te cilat marin uje ne tubin PE100RC DN 400-315-160 mm nga depo e re dhe depo Maskuri. Kjo linje eshte e pajisura me 22 puseta kryesore manovrimi P. 1÷22 ku japin uje seciles zone vetem ne nje pike.



Linjat e reja PE100RC DN 400-160 mm kalojnë pjesërisht në rrugë automjetesh të asfaltuar dhe pjesërisht në rrugë betoni të çakulli, ku në përfundim të punimeve rruga do të kthehet në gjendje të mëparshme. Vendosja e tubacionit të ri në infrastrukturën publike nuk lejon ndërhyrjet e paligjshme nga banorët, pasi është në vend të dukshëm dhe manovrimi i rrjetit bëhet më mirë nga ana e punëtorëve të ndërmarrjes. Seksioni i kanalit do të mbushet me gurë kave dhe shtresat rrugore janë me asfalobeton 4cm, binder 6cm, stabilizant 10cm, shtresë çakull mali 20cm dhe stabilizant 20cm, shtresë çakull mali 20cm në rrugët e pashtruara. Pusetat e zonave P.1-22 janë pajisur me aksesoret e nevojshme me material gize për manovrimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit me saraçineska tip Flutur, saraçineske me Volant, pjesët çmontuese, Combi Tee, Combi Kryq, Filter, Reduktues Presioni, Mates uji Induktiv, Bryla etj. Të gjitha pusetat janë të vendosura në tokë dhe është parashikuar që të jenë me kapak gize të cilat janë të papërshtueshme nga ujrat sipërfaqësor me qëllim që pusetat të jenë të thata dhe të aksesueshme në çdo ditë të vitit. Pusetat janë me beton të armuar të cilat janë të hidroizoluara nga jashtë dhe të pajisura me waterstop në bashkimet e fugave të mureve me pllaken e puseteve. Pusetat janë të pajisura me shkallë inoksi të fiksuara me bulonë në murin e betonit sipas vizatimit të perkates.

Zona 1-5 dhe 16-22 furnizohen nga linja unazore dhe janë zona rurale e Qerretit

DMA 1-5 dhe 16-22 kanë si pikë furnizimi linjen kryesore e cila furnizohet nga Depo e Re 6000m³ dhe linja PE 400mm e depos së Maskurisë. Zonat lidhet me linjen kryesore, me tub PE 100RC, DN/OD 125-90 mm në puseten e cila është e pajisur me të gjithë rakorderitë e nevojshme sipas radhës në vizatim dhe tabelat e materialeve për këto pusete.




Planimetria e DMA 1

Karakteristikat teknike te tubave jane PE 100 RC DN/OD 90÷25mm, PN 10 bar. Ne rastet e renes se zjarit ne projekt jane parashikuar ndertimi i hidranteve DN 80 mm nentokesor te vendosuar ne trotuar ose rruge sipas rastit.

Në zonë kemi me shume ndertesa individuale 1÷4 katëshe te cilat lidhen me rrjetin me pusete me permasa 55x30cm me mates 25mm me fushe te njome, dhe me pak ndërtime mbi 3-kate, biznese, hotele te cilat lidhen me pusete me permasa 85x40 cm me mates 50mm me fushe te njome. Lidhja e konsumatoreve me rrejtin e furnizimit me uje behet me ane te pusetave individuale sipas tipologjise se ndertesave dhe ne pusete jane perfshire te gjitha punimet dhe rakorderite qe nevoiiten.

Zona 6-15 furnizohen nga linja unazore dhe jane zona turistike e Qerretit

DMA 6-15 kane si pike furnizimi linjen kryesore e cila furnizohet nga Depo e Re 6000m³ dhe linja PE 400mm e depos se Maskurise. Zonat lidhet me linjen kryesore, me tub PE 100 RC, DN/OD 160-110 mm ne pusete, e cila eshte e pajisur me te gjitha rakorderite e nevojshme sipas radhes ne vizatim dhe tabelas se materialeve per kete pusete.



Planimetria e DMA 6

Karakteristikat teknike te tubave jane PE 100 RC DN/OD 125÷25mm, PN 10 bar. Ne rastet e renies se zjarit ne projekt jane parashikuar ndertimi i hidranteve DN 80 mm nentokesor te vendosuar ne trotuar ose rruge sipas rastit.


Në zonë kemi me shume ndertesa individuale 1÷3 katëshe te cilat lidhen me rrjetin me pusete me permasa 70x35cm me mates 20mm me fushe te njome, dhe ndërtime 4÷9 kate, biznese, hotele dhe pallate te cilat lidhen me puseta me permasa 85x40cm me mates 50mm me fushe te njome. Lidhja e konsumatoreve me rrejtin e furnizimit me uje behet me ane te pusetave individuale sipas tipologjise se ndertesave dhe ne pusete jane perfshire te gjitha punimet dhe rakorderite qe nevojiten.

14. SKEMA HIDRAULIKE

Per fshatrat ne studim te njesise Administrative Synej dhe Golem eshte parashikuar qe te ndryshohet skema aktuale e furnizimit me uje. Fshati Agonas ka nje depo ekz. te amortizuar e cila nuk ka hapesire perreth saj per te ndertuar nje depo me kapacitet me te madh ne perputhje me kerkesat aktuale. Zona nuk ka mundesi furnizimi me uje nga burim tjetër alternative afer, me ngritje mekanike apo veterrjedhje pervec tubacionit Gize DN/ID 500mm qe vjen nga puseshpimet e Çermes.

Per fshatrat Agonas, Kolje, Rakell dhe Qerret ne projekt eshte parashikuar te ndertohet linja e dergimit PE 100 RC PN 10 bar DN/OD 400 mm qe furnizohet ne tubin e Gizes DN/ID 500mm qe vjen nga puseshpimet e Çermes, ndertim depo e re $V=6000m^3$ mbi rezervuarin Agonas ne koder dhe nga depo e re do te zbresi nje tub kryesor shperndarje PE100RC, PN 10 bar, DN/OD 450-400 mm nga depo e re ne drejtim te linjes unazore Qerret me tub PE 100 RC, PN 10 bar, DN/OD 400-160mm. Kjo linje kryesore eshte e paisur me ajrues, puseta manovrimi ku do ti japi uje secilit fshat dhe zone.

Per fshatin Qerret ne projekt eshte parashikuar te ndertohet linja kryesore e shperndarjes PE100RC PN10bar DN/OD 400 mm ne vazhdim te tubacionit ekzistues te fshtit Golem ne afersi te rotindos te Mali Robit qe furnizohet nga Depo Golem 4000m³.



- a. Per fshatin Agonas ne projekt zbatimi parashikohet ndertim i linjave te shperndarjes nga puseta e komandimit ne tubin kryesor te shperndarjes PE100RC, PN10bar, DN450mm, rrjeti eshte i pajisur me saraçineska Tip Shpigel, Hidrant, kolektoret 5-7 dalje dhe box individual. Duke qënë se linjat qe kalojnë në rrugë te paasfaltuar, gjatë gërmimit të kanaleve dhe i gërmuar do të largohet pjeserisht dhe mbushja e kanalit do të bëhet me çakull mali dhe stabilizant për të përmirësuar parametrat e rrugës.
- b. Per fshatin Kolje ne projekt parashikohet ndertimi i linjave te shperndarjes nga puseta e komandimit ne tubin kryesor te shperndarjes PE100RC, PN 10bar, DN/OD 450mm, rrjeti eshte i pajisur me saraçineska Tip Shpigel, kolektoret 5-7 dalje, Hidrant, box me dy dalje dhe box individual. Duke qënë se linjat kalojnë në rrugë te asfaltuar, gjatë gërmimit të kanaleve dhe i gërmuar do të largohet dhe mbushja e kanalit do të bëhet me çakull për të përmirësuar parametrat e rrugës dhe evituar dëmtimet e mundëshme nga cedimet. Rruget e asfaltuara do te kthehen ne gjendjen fillestare me asfalt. Ne linjat qe kalojnë në rrugë te paasfaltuar, gjatë gërmimit të kanaleve dhe i gërmuar do të largohet pjeserisht dhe mbushja e kanalit do të bëhet me çakull mali dhe stabilizant për të përmirësuar parametrat e rrugës.
- c. Per fshatin Rakell ne projekt parashikohet ndertimi i linjave te shperndarjes nga puseta e komandimit ne tubin kryesor te shperndarjes PE100RC, PN 10bar, DN/OD 450mm, rrjeti eshte i pajisur me saraçineskat Tip Shpigel, Hidrant, kolektoret 5-7 dalje dhe box individual. Duke qënë se linjat kalojnë në rrugë te asfaltuar, gjatë gërmimit të kanaleve dhe i gërmuar do të largohet dhe mbushja e kanalit do të bëhet me çakull për të përmirësuar parametrat e rrugës dhe evituar dëmtimet. Rruget e asfaltuara do te kthehen ne gjendjen fillestare me asfalt. Ne linjat qe kalojnë në rrugë te paasfaltuar, gjatë gërmimit të kanaleve dhe i gërmuar do të largohet pjeserisht dhe mbushja e kanalit do të bëhet me çakull mali dhe stabilizant për të përmirësuar shtresat e rrugës.

- d. Per fshatin Qerret ne projekt parashikohet ndertimi i linjes unazore te shperndarjes me puseta e komandimit ku vijne edhe dy tubat kryesor te shperndarjes PE100RC, PN 10bar, DN/OD 400mm nga depo e re Agonas 6000m³ dhe nga Depo Golem ekz. 4000m³, ne projekt jane parashikuar linjat e shperndarjes sipas zonave, pusetat e komandimit, saraçineskat Tip Shpigel, Hidrant, box pallate, boks biznes dhe box individual. Duke qënë se linjat kalojnë në rrugë te asfaltuar, betonuar dhe pllaka betoni gjatë gërmimit të kanaleve dheu i gërmuar do të largohet dhe mbushja e kanalit do të bëhet me çakull për të përmiresuar parametrat e rrugës.

Ne linjat qe kalojnë në rrugë te paasfaltuar, gjatë gërmimit të kanaleve dheu i gërmuar do të largohet pjeserisht dhe mbushja e kanalit do të bëhet me çakull mali dhe stabilizant për të përmiresuar parametrat e rrugës. Rrugët e do te kthehen ne gjendjen fillestare me asfalt, beton, pllaka dhe stabilizant sipas rastit.

Ne kete njesi administartive matesat e ujit parashikohen te jene te thjeshte.

15. PËRSHKRIM I NYJEVE PER MENAXHIMIN, MIREMBAJTJEN DHE SHFRYTEZIMIN E RRETIT

Per te menaxhuar sa me mire rrjetin jane ndertuar nyjet e komandimit te cilat jane paisur me te gjitha rakorderite e nevojshme. Sipas terenit jane vendosur ajruer dhe shkarkues. Eshte parashikuar kalimi me tub celiku dhe konstruksione metalike te perbera. Ne puseta ku presionet jane te larta jane vendosur reduktore presioni. Ne zona jane vendosur hidrante nentkesore ne rastet e renies se zjareve. Nyjet te cilat sherbejne per komandim e rrejtit dhe kane nevojte per mirembajtje jane ndertuar pusetat e betonit te cilat kane kapak gize i papershkueshem nga uji siperfaqesor dhe e hidroizoluar muret.

Per lidhjen e konsumatorit me rrjetin jane parashikuar tre tipe pusetash per mates me lexim ne fushe te njome, puseta per ndertesa individuale 1÷3 katëshe te cilat lidhen me rrjetin me permasa 55x30cm me mates 25mm, puseta per ndërtesa mbi 3-kate, magazina, biznese sherbimi, hotele dhe pusete pallati te cilat lidhen me permasa 85x40 cm me mates 50mm.





TABELLE MATERIALE PUSETA P - 01 - ZONA I

1	Hidrant nentkete per kushtet me shprehje DN 100 mm PN 10 bar	1000	1
2	Grupi Për rrua Manometri DN 100 mm dhe saraçina DN 100 mm PN 10 bar	1000	1
3	Reduktor për DN 200 / 100 mm PN 10 bar	1000	1
4	Fluxi Qendruesor DN 100 mm PN 10 bar	1000	1
5	Hidrant nentkete per kushtet me shprehje DN 100 mm PN 10 bar	1000	1




Model Pusete Manovrimi Ne DMA

PLANIMETRIA E PUSETËS




KAPAKU I DIMENSIONES



PRERJE TERTHORE



PRERJE GJATESORE



Ana Ndertimore E Pusetes Manovrimi, Ne DMA

PUSETA TIP - 02






TABELA E MATERIALEVE PUSETA TIP - 02

1	Flaneshë adaptor për tub HDPE rrethor DN 400 mm, Pn 16 bar	copë	2
2	Pjesë Çmontuese DN 350 mm, Pn 16 bar	copë	3
3	Kryq me flaneshë DN 350 mm Pn 16 bar	copë	2
4	Tub gjatë DN 350 mm me flaneshë Pn 16 bar L = 700 mm	copë	1
5	Redukcion XR DN 350 / 100 mm Pn 16 bar	copë	4
6	Sercizueshë me pafundë DN 100 mm, Pn 16 bar	copë	8
7	Berçil rrethor DN 100 Pn 16 bar	copë	2
8	Tub gjatë DN 100 mm me flaneshë Pn 16 bar L = 500 mm	copë	2
9	Mates ujë inductiv DN 100 mm Pn 16 bar	copë	2
10	Tub gjatë DN 100 mm me flaneshë Pn 16 bar L = 400 mm	copë	2
11	Pjesë Çmontuese DN 100 mm, Pn 16 bar	copë	4
12	Tub me flaneshë DN 100 x 100 x 100 mm Pn 16 bar	copë	2
13	Flaneshë adaptor për tub HDPE rrethor DN 110 mm, Pn 16 bar	copë	2


Model Pusete Manovrimi Ne Linjen Kryesore Qe Furnizon DMA




PRERJE GJATESORE




PRERJE TERTHORE




KAPAKU I DIMENSIONES




Ana Ndertimore E Pusetes Manovrimi, Linja Kryesore Qe Furnizon DMA




Model Saraçineske Tip Shpigel



Model Hidrant Zjarri DN 80



Model Mates Uji Per Pallate DN 50



Model Mates Uji Individual DN 25

Duke qënë se bokset e matesave do te vendosen ne mur sipas rastit jane parashikuar prishje muri, suvatim dhe lyerje me qellim kthimin ne gjendjen e meparshme.

16. SISTEMI SCADA

Rrjeti i furnizimit me uje i DMA-ve do te pajiset me komandim ne distance qe nga depo deri tek puseta e manovrimit te zones perkatese per te menaxhuar ne distance, sasine e ujit, humbjet ne rrjet, presionet per secilen zone. Sistemi qendror i komandimit ne distance Scada do te instalohet ne zyrat e ndermarjes dhe do te operhet nga inxhinieri hidroteknik me eksperience ne menaxhimin e rrjetit.

17. KONKLUZIONE

Projekti i njesise administartive Synej dhe Golem ka rëndësi të madhe turistike por kane ndikim te madh për furnizimin me uje te qytetit te Kavajes dhe Durrësit. Keto fshatra kane popullsi te madhe dhe konsum te larte te cilat aktualisht marin pak uje direkt ne linje dergimi te Çermes ose nga depo Agonas 200m³ dhe Golem 2x2000m³. Depo Agonas nuk perballon kapacitetet e furnizimit me uje te zones se mbulon. Ndertimi i ketyre ujesjellesave eshte jetik per banoret e zones dhe zhvillimin e turizmit pasi ne disa fshatra mungon rrjeti i ujesjellesit dhe zones bregdetare te Qerretit e cila ka zhvillim shume te madh vitet e fundit.

Keto projekte ka këto anë pozitive.

1. Furnizimin me ujë të banorëve rezidente, pushuesve ditor, turistëve dhe bizneseve.
2. Në thjeshtësinë e veprës, si në konstruktimin e saj, ashtu edhe në funksionimin.
3. Mbulimi i plotë me rrjet të furnizimit me uje per zonat e njesive administrative.
4. Rikonstrukcion/Ndertim i linjave, depove, lidhja 100% e popullatës që jeton në zonën.

5. Garantimi i furnizimit me uje per te gjitha fshatrat, vendosja e matesave per cdo lidhje, furnizimi me 24 ore uje, me presionin e nevojshem dhe cilesine e ujit sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar ne fuqi.
6. Ndertimi e skemave hidraulike te qendrueshme per nje periudhe afatgjate 50-vjecare.

18. REFERENCAT; STANDARDE DHE LITERATURA:

- Kushtet teknike të projektimit KTP 11 dhe 12 (Ujësjiellës dhe Kanalizime), 1978
- Standardi European BS EN 752, UNI EN 752
- Standardi European BS EN 12050, UNI EN 12050
- Standardi European BS EN 12056, UNI EN 12056
- Standardi European BS EN 1610
- Standardi European BS EN 124
- Standardi European DIN EN 1955, etj

“Invictus” sh.p.k

Dr. Andrin KËRPAÇI

STUDIM GJEOLGJIK

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE UJESJELLESIT TE NJESIVE ADMINISTRATIVE GOLEM
DHE SYNEJ - BASHKIA KAVAJE"

"SHQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS" SH.A.

PERMBAJTJA E LENDES

I. - QELLIMI STUDIMIT & VENDODHJA E OBJEKTIT.

II. - GJEOLOGJIA INXHINIERIKE.

II-1. Baza topografike.

II-2. Ndertimi gjeologjik.

II-2.1. Stratigrafia .

II-2.2. Tektonika .

II-3. Sizmiciteti.

III.- PERSHKRIMI GJEOLIGO-INXHINERIK I VEPRAVE.

III-1. Depot e ujit.

III-2. Linjat kryesore të tubacioneve shperndarese.

IV. - HIDROGJEOLOGJIA.

VI. - KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.

VII. – MATERIALI GRAFIK.

I. - QELLIMI STUDIMIT & VENDODHJA E OBJEKTIT.

Studimi per fazen e projekt-zbatimit i kushteve gjeologo-inxhinerike te skemes per rikonstrukcion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave Qerret, Agonas, Rakell, Kolje & Bukaq, Nj.Adm.Golem dhe Nj.Adm.Synej, Bashkia Kavaje eshte kryer me kerkesen e pales projektuese, ne baze te kontrates te lidhur me grupin e studimit te firmes E.F.B. sh.p.k e specializuar ne fushen e gjeologjise inxhinerike dhe hidrogjeologjise te kryesuar nga Ing. Bekim LILAJ. Qellimi i ketij studimi eshte saqrim i kushteve gjeologo – inxhinerike te zones ku do te ndertohen apo rikonstruktohen veprat e skemes ne studim. Me poshte japim nje pershkrim te pjeseve perberese te skemes:

A-Depot e ujit:

1-. Depua e ujit (ekzistuese) e emertuar Depo Kavaje e pozicionuar ne nje zone kodrinore mbi qytetin e Kavajes. Gjate rikonjicionit u evidentua se kjo depo eshte ne gjendje te mire.

2-. Depua e ujit (e re) e emertuar Depo Agonas e pozicionuar ne nje zone kodrinore ne afersi te ujembledhesit te bujqesie Agonas.

B-Linjat kryesore te tubacioneve shperndarese.


Per studimin e linjave kryesore te tubacioneve te ujesjellesit eshte kryer rikonjicioni gjeologo-inxhinerik si dhe eshte perdorur materiali arkival (studime te mepareshme te kryera nga autoret ne zone).

1-. Linja te ujesjellesit qe lidhen me Depon e ujit Kavaje (te pozicionuara kryesisht pergjate rrugeve te qytetit te Kavajes si dhe fshatit Bukaq).

2-. Linja te ujesjellesit qe lidhen me Depon e ujit Agonas (te pozicionuara kryesisht pergjate rrugeve te fshatrave Agonas, Rakell, Kolje, Qerret, etj).

Gjate rikonjicionit (dhe punimeve fushore) te kryer se bashku me grupin e projektimit u kryen sonda te cekta investiguese, grop-sonda te kryera me ekskavator per marjen e mostrave per percaktimin e treguhesve fiziko-mekanik, u shfrytezua materiali arkival (studime te mepareshme te kryera nga autoret e studimit ne zonen nen studim), si dhe u krye rilevimi gjeologo-inxhinerik i shesheve ku do te ndertohen veprat e skemes nen studim.

RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT TË FSHATIT QERRET, NJ.ADM.GOLEM DHE NJ.ADM.SYNEJ
BASHKIA KAVAJE
ORTOFOTO E ZONES SE PROJEKTIT



RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT TË FSHATIT BUKAQ, NJ.ADM.SYNEJ, BASHKIA KAVAJË
PLANIMETRIA E ZONËS SE PROJEKTIT



II. GJEOLGJIA INXHINIERIKE

II-1 Baza topografike

Per projektin eshte perdorur studimi i detajuar i kryer ne teren nga ana e grupit topografik si dhe baza topografike nga Harta ne shkalle 1:25000, Plansheta e Kavaja (K-34-100-A-c) prodhim I vitit 1983, botuar ne vitin 1985.

II-2.Ndertimi gjeologjik

II-2.1.Stratigrafia.

Depozitimet qe takojme ne zonen nen studim jane:

Ne ndertimin gjeologjik te zones te studimit tone takohen depozitime me moshe relativisht te re, te cilat jane:

1. *Depozitimet e Mioceni i siperm (N_1^3)*
2. *Depozitimet e Plioceni i poshtem (N_2^1 h)*
3. *Depozitimet e Pliocenit i mesem (N_2^2 r)*
4. *Depozitimet e Kuaternarit (Q4al)*
5. *Depozitimet e Kuaternarit (Q4)*

- 1- Depozitimet Mioceni i siperm.

Tortoniani (N_1^3t)

Keto depozitime kane perhapje te gjere si ne sipërfaqe dhe thellesi. Depozitimet e Tortonianit si ne sipërfaqe dhe ne thellesi perfaqesohen nga dy litofacie. Litofacia ranoro – argjilore, si dhe litofacia argjilo-ranore. Litofacia ranoro - argjilore karakterizohet nga ranore e argjila te nderthurur dhe me gelqerore lithotamnike. Ranoret paraqiten me ngjyre gri te çelur deri te zverdhur, ndersa ne thyerje te fresket kane ngjyre bezhe te erret. Jane kompakte, kokerrmedhenj, deri kokerrmesem. Trashesite e shtresave luhaten nga 0.5-1.5m. deri 5-6m.

Argjilat paraqiten me ngjyre gri ne te kaltert me ndertim guackor dhe me trashesi 2-3m. deri 15-20m. Shpesh brenda tyre takohen horizonte te ndjekshem me makrofaune 1-2m. te trashe si dhe shumengjyresha. Ne disa rajone tek horizontet e makrofaunes dallohen kristale te vegjel gipsi.

Messiniani (N_1^3m)

Nga ana litologjike ekzistojne dy litofacie, duke pasqyruar pak a shume te njejten histori zhvillimi si ne Tortonian. Litofacia ranoro-argjilore, dhe litofacia argjilo-ranore.

Litofacia ranoro-argjilore perfaqesohet nga nderthurje paketash ranorike me paketa argjila-alevrolitore. Ranoret predominojne ne prerje dhe paraqiten ne trajten e paketave me trashesi 6-7m. deri 15-20. Ne pergjithesi jane kokerndryshem, me shtresezim te pjerret dhe rralle here verehen dhe zaje te vegjel midis ranoreve.

Argjilat kane pamje me teper alevrolitore dhe paraqiten me ngjyre gri hiri. Midis tyre takohen disa horizonte makrofaune te tipit kryesisht ostrea, te ndjekeshme ne distanca te medha. Argjilat paraqiten ne trajten e paketave te trasha, dhjetra metroshe te cilat ne drejtim te lindjes kalojne dora-dores ne argjila jo te pasterta deri me alevrolite. Gipset kane perhapje ne trajte linzash brenda hapsires se kesaj litofacie dhe trashesi deri disa metra.

-2- Depozitimet e Plioceni i poshtem ($N_2^1 h$) Suita Helmesi:

Depozitimet e formacionit Helmasi fillojne me shfaqjen ne prerje te shtresave ranore dhe konglomerateve te pangopur, qe percaktojne dyshemene e tij dhe njekohesisht shenojne pranine e transgresionit pliocenik. Vihet re qe ne shtrirjen jug-veri trashesia e konglomerateve te bazes rritet. Mbi shtresat ranore dhe konglomeratike prerja vijon me shtresa argjilore dhe paketa argjilo-ranore shtrese holle e mesem.

Ranoret kane forma shtresore me trashesi nga 4-8 cm deri ne 20-30 cm, ngjyre hiri te verdhe, te shkrifet nga çimentimi i dobet. Ata jane kokerrvegjel dhe mesem, polimineral, te tipit kuarcoro-feldshpatik.

Argjilat predominojne ne prerje, jane gri hiri deri ne te kalterta, te buta deri ne kompakte, here-here shume mikore.

Konglomeratet perbehen nga zaje te perberjes dhe formave te ndryshme. Takohen zaje te rumbullakuara e gjysem te rumbullakuara me madhesi mesatare 4-10cm. Jane kryesisht zaje kuarcitesh, serpentinite, gabrodunitesh si dhe gelqerore e ranore te moshave te vjetra deri ne te reja, duke filluar nga ato te Jurasikut.

-3- Depozitimet e Pliocen i mesem (N_2^2r)

Depozitimet e formacionit “Rrogozhina” vendosen mbi pakon argjilore te formacionit “Helmasi” dhe kane maredhenie normale me te. Ne sipërfaqe takohen, me te gjitha karakteristikat litologjike te tyre. Keto depozitime kane karakter trashaman, ranore, gravelite, konglomerate me zaje me ndershtresa te holla argjilash. Ne prerjen suita fillon me shtresa ranore e alevrolite shtrese holle, mbi to vijojne paketa konglomeratike e zaje qe nderthuren me paketa ranori, shtrese mesem, trashe dhe masive me trashesi shtrese deri ne 4-6m.

Ranoret jane kokervegjel deri trashe, shpesh gravelitike, poliminerale, te tipit kuarcoro- feldshpatik me permbajtje serpentinas. Ne pergjithesi ranoret si dhe alevrolitet permbajne koncentracione te larta te metaloreve, te epidotit, granateve, amfiboleve.

Ne konglomeratet takohen zaje te rumbullakosur dhe gjysem te rumbullakosur te shkembinjve magmatike dhe sedimentare. Masa çimentuese e konglomerateve e zajeve eshte argjilo-alevrito-ranore, gravelitike dhe e tipit bazal. Ne ranoret dhe konglomeratet e ketij formacioni gjenden shtresezime te pjerrta e te kryqezuara, karakteristike e trashesise te formacionit mollasik.

- 4 - Depozitimet Aluviale te Kuaternarit ($Q4$ al)

Depozitimet aluviale vendosen direkt mbi tavanin e nderthurieve te pakove ranoro-argjilore. Keto depozitime perfaqesojne materialin aluvial te tarracave te lumenjeve. Nga perberja litologjike depozitimet aluviale jane te depozitimeve te ndryshme dhe perfaqsohen nga zhavore e zhur (poplat ne perindje te paket) kryesisht gelqerore e ranore. Depozitimet aluviale jane te perpunuara deri gjysem te perpunuara. Shkalla e njeshmerise se tyre eshte e larte ndersa gjendja e lageshtise se ketyre depozitimeve eshte e larte ndersa gjendja e lageshtise se ketyre depozitimeve eshte e ngopur me uje. Materiali mbushes perfaqesohet nga rere e surere ne masen 10-30%.

- 5 - Depozitimet e Kuaternarit ($Q4d$)

Depozitimet e Kuaternarit perfaqesohen nga depozitimet me origjine detare. Keto depozitime perfaqesojne pjesen e siperme te prerries tone te cilat deri ne thellesine 4.5-5.0m perfaqesohen nga rrera kokermesme me permbajtje zhurri dhe zhavori te imet gelqeror e silicor ne masen 10% me ngjyre hiri-bezhe, deri mesatarisht te ngjeshur ndersa nen te takohen rere e imet detare me ngjyre gri te kaltert pak deri mesatarisht te ngjeshura dhe me veti te dobta gjeoteknike sesa rerat me ngjyre hiri bezhe (rerat e

plazhit). Ne pjesen e sipërme të prerjes takohen dhe linza suagjilash e argjilash lymore me pak rere e rrenje pemesh. Me në thellesi këto depozitime kalojnë në surera, suagjila e argjila.



HARTA GJEOLGJIKE E RAJONIT

II-2.2. Tektonika.

Rajoni që po meret në studim ndodhet në zonën strukturalo-faciale të Ultesirës Adriatike.

ULTESIRA ADRIATIKE

Ultesira Adriatike ndodhet në pjesën qendrore e veriperendimore të Albanideve të jashteme, në buzën e orogjenit në kontakt me platformën Adriatike. Ajo përfaqëson një ultesirë paramalore që shtrihet mbi zonat e Sazanit, Jonike, Kruja dhe basenin e Adriatikut jugor. Në pjesët anësore, sidomos aty ku vendosen mbi orogjenin depozitimet molasike të ultesirës vendosen transgresivisht mbi vazhdimin e strukturave të zonës Jonike (Çakran, Kreshpan, Patos-Verbas, etj.) dhe të zonës Kruja (sinklinali i mbivendosur i Tiranës). Në pjesën qendrore ku ajo vendoset mbi zonën e Adriatikut Jugor, përgjithësisht pranohet shuarja e mosperputhjeve dhe mardhenie suksesive të depozitimeve. Në rajonet jugperendimore,

depozitimet molasike te Ultesires, duke filluar nga ato te Burdigalianit e me te reja, vendosen transgresivisht mbi depozitimet karbonatike te zones platformike te Sazanit.

Molasat e mbuleses fillojne nga Seravaliani, duke u ndjekur me lart nga Tortoniani, Mesiniani dhe Plioceni dhe se fundi edhe nga Kuaternari. Nje rrudhosje e lehte ndodh ne fund te Miocenit. Ne fillimin e Pliocenit, fillon terheqja dhe zhytja e ultesires, shoqeruar me grumbullime te fuqishme (disa km., te sedimenteve te karakterit kryesisht konglomeratik ne buzen lindore (Formacioni Rogozhina) dhe te karakterit me argjilor ne buzen perendimore (Formacioni Helmasi"). Nga fundi i Pliocenit nga kompresioni i fuqishem ndodhi rrudhosja perfundimtare e ultesires ne te cilen u formuan strukturat rrudhosese e shkeputese te saj.

Ne fund te Pliocenit, pasi u formuan strukturat e mesiperme vazhdoi ngritja e strukturave pozitive edhe ne Kuaternar dhe zhytja e sinklinaleve ndarese qe u mbushen me depozitime te moshes ne fjale. Me qe ne lindje te ultesires perhapen moshat e Miocenit rezulton se levizjet pozitive neotektonike, por te diferencuara, me intensitet me te madh ne strukturat pozitive dhe me te vogel ne ato negative, filluan qe ne Pliocen dhe vazhduan edhe ne Kuaternar duke formuar ansamblin gjeomorfologjik te relievit te sotem. Eshte kjo arsyeja qe ne lumin Erzen i cili i pret terthor keto struktura jane formuar edhe 3-4 taraca erozivo-akumuluse deshmi kjo e ngritjeve tektonike ne Kuaternar. Po te merret per baze Tortoniani (ose Serravaliani) me te cilen fillon ultesira ne pjesen me lindore ai vendoset ne trajte pullash ne lartesine 1000 m. mbi strukturen karbonatike te Dajtit kurse ne perendim baza e tij peson nje fleksurim te pernjehereshem nen ballin e mbihypjes dhe shplarje deri ne kuotat 150-250m. pas te cilave ai zhytet ne sinklinalin e Tiranes deri ne disa km. (2-3km.).

Ky fleksurim i madh flet per nje ngritje te fuqishme neotektonike sipas mbihypjes te strukture se Dajtit duke lene reliketet ishullore te relievit te vjeter te asaj kohe mbi lartesine 1000 m.

Per kete ngritje flasin kanionet e prera nga perrenjte qe çajne mespermes kete strukture. Edhe Shpella e Pellumbasit, me ariun e vjeter qe jetonte aty, ne faqen e lumit Erzen ne lartesi te madhe, eshte deshmi e nje ngritje intensive ne kohet e voneshme.


Ne teresi Ultesira Adriatike, duke gjykuar nga ndertimi tektonik dhe sidomos nga mardheniet me katin e poshtem strukturor, mund te ndahet ne tre sektore :

Spektori lindor:- Shtrihet prane buzes lindore te Ultesires, duke filluar nga Kanina-Treblova, Selenice-Kreshpan, Ardenica, Marinze-Bubullime-Kemishtaj. Ky sektor vazhdon me mulden e Kuçoves, Pekisht e me ne veri me mulden e Galushit dhe akoma me ne veri me sinklinalin e Tiranes.

Spektori qendror:- Ketu perfshihet rajoni i ultesires nga buza e orogjenit dhe me ne veri, ku ultesira vijon mbi zonen e Adriatikut Jugor. Ne pergjithesi pranohet vijushmeri e depozitimeve. Ne siperfaqe si rezultat i fazes rrudhosese postpliocenike verehen struktura antiklinale ne forme vargresh.

Sektori perendimor:- Perfshin kryesisht zonen detare, pra pjesen me perendimore te Ultesires, ku molasat mbivendosen mbi zonen tektonike te Sazanit. Te dhenat e marra kohet e fundit nga punimet sheshore seizmike detare sqarojne plotesisht maredheniet midis zones platformike dhe zonave te tjera me ne lindje. Ne pergjithesi verehet nje zhytje graduale e platformes karbonatike drejt lindjes nepermjet shkeputjeve normale. Nga te dhenat e puseve te shpuar ne det, si ne zonen tone detare dhe ne zonen italiane, rezulton se depozitime me te vjetra qe kontaktojne transgresivisht mbi gelqeroret platformike jane ato te Burdigalianit.

SKEMA TEKTONIKE E ALBANIDEVE



II-3.Sizmiciteti

Zona jone e studimit, ku do te ndertohej objekti nen studim bazuar ne hartën e Rajonizimit Sizmik te Republikes Shqiperise, karakterizohet nga lekundje sizmike prej 8 balesh.

Si dallohet edhe nga harta zona ne studim pozicionohet teresisht ne **“Zone e vatrave te termeteve te fugishem”, ku kemi nje ritje te intensitetit te lekundjeve sizmike me nje balle per kushte te keqia trualli. Ky fakt do te duhet te meret detyrimisht ne konsiderate nga ana e projektit.**



III.-PERSHKRIMI GJEOLIGO-INXHINERIK I VEPRAVE.

Gjate punimeve fushore te kryer nga grupi i studimit u percaktuan dhe u studiuan, vendet ku do te ndertohen veprat perberese e skemes nen studim. Me poshte do te pershkruajme keto vepra.

III-1-Depot e ujit:

1-. Depua e ujit (ekzistuese) e emertuar Depo Kavaje e pozicionuar ne nje zone kodrinore mbi qytetin e Kavajes. Gjate rikonjicisionit u evidentua se kjo depo eshte ne gjendje te mire.



2-. Depua e ujit (e re) e emertuar Depo Agonas e pozicionuar ne nje zone kodrinore ne afersi te ujembledhesit te Agonasit.

Gjate rikonicionit (dhe punimeve fushore) te kryer se bashku me grupin e projektimit per kete depo u krye sonda nje grop-sonde me ekskavator me nje thellesi prej rreth 3.0ml nga ku u maren dhe mostrave per percaktimin e treguhsve fiziko-mekanik. Nga dokumentimi i gropes rezulton kjo prerje litologjike.

- 1 -. Shtresa nr.1

Kjo shtrese perfaqeson token vegjetale dhe perbehet nga suargjila dhe surera me rrenje te shumta bimesh, ne gjendje plastike me lageshti. Per vete kushtet e ndertimit, kjo shtrese nuk mund te sherbeje per hedhjen e themeleve te depos. Kjo shtrese takohet ne intervalin 0.0 deri 1.2ml.

- 2 -. Shtresa nr.2

Kjo shtrese perfaqeson depozitimet deluviale te Kuaternarit dhe perfaqesohet nga suargjila te lehta deri ne surera pluhurore, me ngjyre kafe te celur deri kafe te verdhe, me njolla e pikezime te shumta te bardha e

gri te celur (lenda karbonatike). Materiali paraqitet me lageshti, deri mesatarisht i ngjeshur dhe ne gjendje plastike. Materiali mbushes perfaqesohet nga guralec te ralle deri ne masen 5%. Kjo shtrese takohet ne intervalin 1.2 deri 2.5ml. Treguhsit fiziko-mekanik te kesaj shtrese te jane:

Granulometria

Fraksioni argjilor.....	= 9.10%
Fraksioni pluhuror.....	= 56.30%
Fraksioni ranor... ..	= 31.20%
Fraksioni cakellare.....	= 3.40%

Lageshtia natyrale... ..	$W_n=22.30\%$
Pesha specifike.....	$\gamma = 2.67\text{gr/cm}^3$
Pesha e volumit ne gjendje natyrale.....	$\Delta= 1.90\text{gr/cm}^3$
Pesha e volumit te skeletit.....	$\delta= 1.55 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 41.95 \%$
Koficienti i porozitetit... ..	$\varepsilon = 0.722$
Moduli i kompresionit.....	$E = 85 \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendeshem.....	$\varphi=18^\circ$
Kohezioni	$c=0.15 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar.....	$\sigma =1.7 \text{ kg/cm}^2$

- 3 -. Shtresa nr.3

Kjo shtrese perfaqeson depozitimet deluvialo-eluviale te Kuaternarit te perbera nga surera e suargjila me material mbushes te perfaqesuar kryesisht nga copra e blloqe ranori (e vende vende nje tjetersim te tyre ne nje shtrese dherore). Materiali paraqitet me ngjyre kafe te celur, kafe ne bezhe me njolla e shtreseza gri e te verdha. Keto depozitime jane ne gjendje plastike deri plastike te forta, deri te ngjeshura dhe me lageshti. Kjo shtrese takohet ne intervalin 2.5 deri 3.0ml. Treguhsit fiziko-mekanik te kesaj shtrese te jane:

Granulometria

Fraksioni argjilor.....	= 9.40%
Fraksioni pluhuror.....	= 50.10%
Fraksioni ranor... ..	= 28.70%
Fraksioni cakellare.....	= 11.80%

Lageshtia natyrale...	$W_n=27.40\%$
Pesha specifike	$\gamma = 2.66\text{gr/cm}^3$
Pesha e volumit ne gjendje natyrale.....	$\Delta= 1.95\text{gr/cm}^3$
Pesha e volumit te skeletit.....	$\delta= 1.53 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 42.48 \%$
Koficienti i porozitetit... ..	$\varepsilon = 0.7385$
Moduli i kompresionit.....	$E = 110 \text{ kg/cm}^2$
Kendi i ferkimit te brendeshem... ..	$\varphi=24^\circ$
Kohezioni	$c=0.15 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar.....	$\sigma =1.9 \text{ kg/cm}^2$

Gjate rikonicionit te kryer se bashku me grupin e projektimit per kete depo u konstatua dhe prezenca ne afersi te saj te disa bunkereve te vjeter, fakt ky qe duhet te meret ne konsiderate nga ana e projektit.



Foto te vend-streimeve ne afersi te zones ku do te ndertohet Depo Agonas (Kanaparaj)



Foto e zones ku do te ndertohet Depo Agonas (Kanaparaj)





B-Linjat kryesore te tubacioneve shperndarese.

Per studimin e linjave kryesore te tubacioneve te ujesjellesit eshte kryer rikonjicioni gjeologo-inzhinerik si dhe eshte perdorur materiali arkival (studime te mepareshme te kryera nga autoret).

1-. Linja te ujesjellesit qe lidhen me Depon e ujit Kavaje (te pozicionuara kryesisht perqjate rrugëve te qytetit te Kavajes si dhe fshatit Bukaq).

Gjate rikonjicionit te kryer se bashku me grupin e projektitimit u kryen dokumentim i zhveshjeve natyrale, sonda te cekta ivestigative me sonde dore si dhe gropsonda te cekta me ekskavator.

Nga dokumentimi i keryre punimeve rezulton se:

a-. Zonat kodrinore ne afersi te depos se ujit ndertohen nga keto shtresa:

- 1 -. Shtresa nr.1

Kontraktori duhet te marre pjese ne te gjitha takimet e organizuara nga Inxhinieri ne objektin e punes ose ne zyren e Inxhinierit per te diskutuar progresin e puneve dhe ose problemet qe lidhen me to. Ne vecanti, Inxhinieri do te beje pershtatjet e duhura per takimet mujore ne terren te thirrura nga Inxhinieri per te pare progresin e puneve. Takimet ne objekt do te perfshijne normalisht inspektimin e puneve, se bashku me Kontraktorin, Inxhinierin dhe Punedhenesin dhe Kontraktori do te beje me te miren e mundshme per te ndihmuar ne kete inspektim te perbashket te punimeve.

1.28. NDIHMA E SHPEJTE

Kontraktori do te siguroje dhe mirembaje kantierin ne vendin ku ndodhet duke u pajisur me te gjitha cantat e duhura te ndihmes se shpejte ne kushte te mira dhe te pastra ne menyre qe te jene te gatshme ne cdo kohe per punonjesit e tij, Inxhinierin dhe stafin e tij. Kontraktori do te kete punonjesit perkates te cilet duhet te jene te instruktuar per menyren e ndihmes se shpejte. Lista e telefonave, per ndihmen e shpejte si doktore, ambulance apo ndonje burim tjeter i jashtem duhet te jete i vendosur ne nje vend te dukshem te kantierit.

1.29. STANDARDET

Te gjitha standratet ISO, EN ose ekuivalente Shqiptare dhe/ose standarte te tjera ekuivalente dhe manuale te dhena ne kushtet e Kontrates do te jene pjese e Kontrates. Te gjitha referencat te dhena ne specifikimet teknike do te jene botime te fundit apo rishikime te tyre. Kontraktori duhet te aplikojë standartet, rregullat teknike dhe ligjet e permenduar ne dokumentet e ofertes.

1.30. PRONESIA PRIVATE

Inxhinieri do te jete i informuar nga Kontraktori ne avance 7 dite mbi fillimin e aktiviteteve ne prona private.

1.31. SPECIFIKIMET TEKNIKE – TE PERGJITHSHME

Te gjitha zerat ne Specifikimet dhe ne Preventiv perfshijne te gjitha punimet duke perfshire, materialet, pajisjet, ndertimin dhe instalimin si dhe pune shtese. Certifikatat per cilesine e te gjitha

materialeve dhe paisjeve duhet te perfshihen. Per llogaritjet e sasive gjate procesit te tenderit dhe matjet e sasive gjate ndertimit duhet te kihet paraysh se:

Pagesat do te behen per sasite e matura ne terren sic jane punimet e tokes qe do te maten dhe paguhen sipas seksionit aktual te kanalit te mbushur apo te germuar.

1.32. LISTA E MANUALEVE TEKNIKE TE OPERIM/ MIREMBAJTJE DHE DOKUMENTAT QE DUHET TE FURNIZOHEN NGA KONTRAKTORI

Dokumenta teknike ne lidhje me Manualet e Operimit dhe Mirembajtjes se Pajisjeve qe do te furnizohen nga Kontraktori jane:

- a) Nje (1) set i manualeve te operimit per cdo pajisje ne Shqip. Manualet e operimit japin ne pergjithesi informacion te pergjithshem dhe specifik per operim normal, kushtet e operimit, kuptimin dhe perdorimin e instrumentave, kuptimin e sinjaleve, etj. Keto manuale jane dokumenta baze per trajnime.
- b) Tre (3) sete te manualeve te sherbimit dhe mirembajtjes te sherbimit normal te rregullt dhe mirembajtjes se cdo tipi te pajisjeve ne anglisht dhe shqip. Set i manualeve te sherbimit dhe te mirembajtjes duhet te kene specifikimet teknike standarte te prodhuesit per pajisjet, specifikimet per pjeset e konsumueshme dhe procedurat per mirembajtje dhe sherbim te rregullt dhe riparim normal. Nje abstrakt i ketyre manualeve, vecanerisht ne pikpamjen e procedurave te mirembajtjes se rregullt dhe riparimit normal do te perdoren si dokumenta baze per trainim.
- c) Dy (2) sete ne Shqip te katalogeve per instrumentat Mekanike/elektrike bazuar ne dokumentat teknike, standartet, specifikimet dhe normat duke pershkruar ne detaje te gjitha proceset e mirembajtjes, vizatimet dhe numrin e pjeseve te kembimit. Keto manuale do te perdoren baze per mirembajtjen dhe operimin e tyre dhe jane ne anglisht.
- d) Dokumentat teknike te specifikuara nen klazuolen a) deri ne c) do te paraqiten ne dy sete ne CD-ROM.

1.33. PAJISJET E KANTIERIT

Per kompletimin e puneve te dhena nen kete kontrate, Kontraktori duhet te:

- Siguroje aplikimet, veglat dhe materialet qe jane kerkuar per zbatimin e puneve te specifikuara ne kontrate duke perfshire edhe transprotin e tyre dhe veprimet me to,
- Transportoje, montoje, mobiloje zyrtat e kantierit, akomodimin, magazinën dhe cdo gje tjeter qe kerkohet per to,
- Te siguroje lidhjet e elektrikut, ujit, telefonit si dhe te cdo pajisje qe duhet per to ne vendin e ndertimit,
- Te siguroje rruget hyrese tek magazinat, asfaltimin dhe rruge trafiku ne vendin e ndertimit sipas kerkesave,
- Te zbatoje punimet e tokes, perfshi edhe heqjen e bimesise sic kerkohet per te lehtesuar hyrjen ne kantier,
- Te gjeje vendet e duhura per pajisjet e kantierit

Kostot per mirembajtjen dhe operimin e pajisjeve, duke perfshire rentimin dhe tarifa te tjera duhet te perfshihen ne cmim.

Kontraktori duhet te mirembaje pajisjet ne objekt per te gjitha periudhen e ndertimit duke perfshire edhe nderprerjet te cilat nuk jane shkaktuar nga Punedhenesi dhe te furnizojë me energji, uje dhe material te tjera te kerkuara per zbatimin e puneve.

Kontraktori do të heqë të gjitha pajisjet dhe të risjellë në gjendjen e merpashme sipërfaqet e përdorura dhe rruget në kuptimin e menazhimit të tokës. Papastërtitë do të hiqen.

Kontraktori duhet të instalojë, mirembajë dhe të zgjidhë lidhjet e ujit dhe të elektrikut nëse do të përdoret për nevojat e punimeve të tokës, tubat, kabllo të ketyrë ndërmarrjeve në bazë të një marrëveshjeje me këto ndërmarrje për periudhën e ndërtimit.

Zyra e Mbikqyresit të punimeve/ Inxhinierit: Një zyrë për Inxhinierin duhet të sigurohet nga Kontraktori në terren. Zyra duhet të ketë një dhomë tualeti, dhe të gjitha pajisjet e nevojshme për një kohë pune normale. Zyra duhet të jetë rreth 25 m² duke përfshirë sistem ngrohje/ftohje, gjenerator/furnizim me energji dhe pastrim ditor. Kontraktori duhet të paguajë koston e zyrës. Gjeneratori duhet të jetë i pajisur me një motor diesel dhe të jetë me kapacitet 4 kVA. Akomodimi i propozuar duhet të aprovohet paraprakisht nga Inxhinieri.

Shuaresit e Zjarrit: Shuaresit e Zjarrit duhet të jenë në objekt në numrin dhe cilësinë e dhënë në këto specifikime (shuares zjarri me ngarkesë pluhuri nominale prej 12 kg).

Pajisjet Sanitare: Kontraktori do të ketë pajisje sanitare sipas numrit të puntoreve dhe stafit në terren por jo më pak se dy kabina tualeti dhe një dhomë dushi si dhe 4 lavamanë.

Shëndeti dhe Siguria: Gjate punës në objekt, të gjithë punonjësit duhet të jenë të veshur me veshje sipas standarteve me veshje të mbrojtura për punë si helmëta, kepuce pune, çizme, pantallona, kemishe, gota uji, etj. Në të gjithë zonën e kantonit kontraktori duhet të vendosë tabelë me frazë të sigurtë në punë sipas procesit të punës. Përpara fillimit të një procesi të ri të punës dhe çdo muaj, Inxhinieri duhet të lexojë rregullat teknike për sigurinë nga libri i standarteve teknike.

Dokumentacioni Fotografik: Përpara, gjatë dhe pas zbatimit të punimeve, foto me ngjyra duhet të behen për evidencë të gjendjes ekzistuese të trasës së vendndodhjes së linjave respektive dhe impianteve të cilat mund të demtohen gjatë ndërtimit. Të gjitha demtimet duhet të fotografohen me qëllim të mos kemi pretendime të pajustificuara nga pronarët. Fotot do të behen në presencë të Inxhinierit. Dokumentacioni i plote do të dorëzohet tek Punëdhënësi.

1.34. FOTOGRAFITE E SHESHIT TË NDËRTIMIT

Sipërmarresit duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikqyresit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve. Nuk do të behen pagesa për fotografimin e kantonit të punimeve pasi këto shpenzime janë parashikuar të mbulohen nën koston administrativë të Sipërmarresit.

1.35. BASHKËPUNIMI NË ZONË

Ndërtimi do të behet në zonë të kufizuar. Sipërmarresit duhet të ketë vecanerisht kujdes në:

- a) nevojën për të mirembajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për banorët dhe tregëtarët që janë në zonë, gjatë periudhës së ndërtimit.
- b) prezencën e mundeshme të kontraktoreve të tjerë në zonë me të cilët do të koordinohet puna

E gjithë puna, do të behet në një mënyrë të tillë, që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjithë pajisjeve të mundeshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe puntorëve të tij, stafin e Punëdhënësit si

edhe te cdo punojnjesi qe mund te punesohet ne zbatim dhe/ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose cdo gje tjeter.

Ne pregatitjen e programit te tij te punes, Sipermarresi gjate gjithë kohes do te beje llogari te plote dhe do te koeporoje me programin e punes se Kontraktoreve te tjere, ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun.

1.36. BASHKEPUNIMI NE ZONE

Sipermarresi do te mare masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe te pasurive ne dhe rreth sheshit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite, pajisjet dhe cdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

Gjate zbatimit te punimeve Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet. Sipermarresi duhet te siguroje pengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne crregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun.

1.37. MBROJTJA E AMBIENTIT

Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjithë veprimet e mundshme per te siguruar qe ambjenti lokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera . Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Mbikqyresi i Punimeve, mund te coje ne nderprerjen e kontrates.

1.38. TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI I MATERIALEVE

Transporti i cdo materiali nga Sipermarresi do te behet me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithë ngarkesa te jete e siguruar. .Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri. Te gjitha materialet qe sillen nga Sipermarresi, duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion, per tu kontrolluar nga Mbikqyresi i Punimeve ne çdo kohe.

1.39. SHESHI PER MAGAZINIM

Sipermarresi duhet te beje me shpenzimet e tij marrjen me qira ose blerjen e nje terreni te mjaftueshem per ngritjen e magazinave me shpenzimet e tij.

1.40. KOPJIMI I VIZATIMEVE (VIZATIMET SIÇ ESHTË ZBATUAR)

Sipermarresi duhet te pergatise vizatimet per te gjitha punimet “sic jane faktikisht zbatuar” ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates.

Gjate zbatimit te punimeve ne kantier, Sipermarresi do te ruaje te gjithë informacionin e nevojshem per pregatitjen e “Vizatimeve sic eshte zbatuar”. Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentat e tjera te cilat mbulojne punen e vazhdueshme te perfunduar, material i cili do te jete i disponueshem ne cdo kohe gjate zbatimit per Menaxherin e Projektit. Keto vizatime do te azhurnohen ne menyre te vazhdueshme dhe do t’i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve çdo muaj per

aprovim, pasi Punimet te kene perfunduar, sebashku me kopjen perfundimtare. Materiali mujor do te dorezohet ne kopje leter.

Vizatimet e riprodhuara do te perfshijne pozicionin dhe shtrirjen e te gjithë konstruksioneve mbajtese te lena gjate germimeve dhe vendosjen ekzakte te te gjitha sherbimeve qe jane ndeshur gjate ndertimit. Sipermarresi gjithashtu duhet te pergatise seksionet e profilin gjatesor te rishikuar, pajisur me shenimet qe tregojne shtresat e tokes qe hasen gjate te gjitha punimeve te germimit.

Si perfundim, kopjet e riprodhuara te Vizatimeve “ sic eshte zbatuar” do t’i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve per aprovim. Vizatimet “sic eshte zbatuar” ,te aprovuara, do te behen prone e Punedhenesit. Nuk do te behen pagesa per berjen e Vizatimeve “sic eshte zbatuar” dhe Manualeve, pasi kosto e tyre eshte parashikuar te mbulohet nga shpenzimet administrative te Sipermarresit.

1.41. PROVAT

Ky seksion perfqeson procedurat e kryerjes se provave per materialjet me qellim qe te siguroje dhe perputhje me kerkesat e Specifikimeve.

Tipi dhe Zbatimi i Provave; Do te kryhen provat e meposhtme:

- Permbajtja e Ujit
- Densiteti Specifik
- Indeksi i Plasticitetit
- Densiteti ne gjendje te thate (Metoda e Zevendesimit me Rere)
- Shperndarja Sipas Madhesise se Grimcave (Sitja)
- Proktori i Modifikuar dhe Normal
- CBR (California Bearing Ratio)
- Provat e Bitumit
- Provat e Betonit (Thermimi i Kampioneve)

Standartet per Kryerjen e Provave; Te gjitha provat do te behen ne perputhje me metodat standarte shqiptare ose me te tjera nderkombetare te aprovuara.

Marrja e Kampioneve edhe Numri i Provave; Metoda e marrjes se kampioneve do te jete sic eshte specifikuar ne metodat e aplikueshme te marrjes se kampioneve dhe te kryerjes se provave ose sic udhezohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

Frekuenca e kryerjes se provave do te perputhet me treguesit ne Specifikimet Teknike dhe nese nuk gjendet atje, do te jepet nga Mbikqyresit te Punimeve. Marrja e ndonje kampioni shtese mund te udhezohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

Ene te tilla si canta, kova e te tjera, do te jepen nga Sipermarresi. Marrja e kampioneve do te kryhet nga Sipermarresi ne vendet dhe periudhat qe udhezohen Mbikqyresit te Punimeve. Marrja, transportimi e sjellja e tyre ne laborator do te behet nga Sipermarresi.

Nderprerja e Punimeve; Nderprerja e punimeve per arsye te marrjes se kampioneve do te perfshihet ne grafikun e punimeve te Sipermarresit. Nuk do te pranohet asnje ankese nga nderprerja e punimeve, per shkak te marrjes se kampioneve.

Provat ne laborator, do te behen ne nje kohe te pershtatshme me metodën e pershkruar.

Provat e Kryera nga Sipermarresi; Per arsye krahasimi, Sipermarresi eshte i lire te kryeje vete ndonje prej provave. Rezultatet e provave te tilla do te pranohen vetem kur te kryhen ne nje laborator te

aprovuar me shkrim nga Mbikqyresit te Punimeve. Te gjitha shpenzimet e provave te tilla pavaresisht se nga vijne rezultatet do te mbulohen nga Sipermarresi.

2. PUNIME TOKE

Ky seksion permban percaktimet e pergjithshme dhe kerkesat per punimet e germimeve ne toke (ne vellim dhe/ose me shtresa) dhe germimet per struktura ne kanale, perfshire germim nen uje. Me tej ajo mbulon te gjitha punimet qe lidhen me konstruksionin kanalit, largimin e materialeve te papershtatshme dhe rifiniturat e shpatit te prerjes.

2.1. STANDARDET

Keto standarte dhe rregulla do te zbatohen per germimet e kanaleve te tubave dhe ndertimin e linjave te tubacioneve:

DIN EN 1610	Manual per Instalimin e Tubave
DIN 19630	Manual per ndertimin e linjave te furnizimit me uje
DIN 4124	Gropat e ndertesave, kanalet, skarpitet, gjeresia e hapesires se punes,
DIN 4129	Rregullimi per mbrojtjen ndaj aksidenteve ne punet e ndertimit

2.2. PAJISJET NDIHMESE PER TRAFIKUN E PERKOHSHEM

Kantieri do te jete sipas rregullave te trafikut me sinjalet e trafikut te kerkuar, instalimet mbrojtese dhe te sigurise. Kontraktori do te mirembaje dhe ndricoje pajisjet duke perfshire edhe kostot operacionale te tyre per te gjitha periudhen e ndertimit deri ne hapjen e trafikut. Pajisjet per bllokimin e trafikut, sigurine ne trafik, ndricimin dhe sinjalistiken do te sigurohen per bllokimin e pjesshem dhe total te rruges ne zonen e ndertimit. Tarifat per leje nga sektori publik per ceshtjet e rrugeve duhet te perfshihen ne kostot perkatese.

Ne se kerkohet, Kontraktori duhet te siguroje nje set te ndricimit te perkohshem me ndricues trafikur per rregullimin e trafikut me operim tre faza, e kuqe, jeshile, e verdhe me ndalese te ndryshme. Seti i ndricimit te perkohshem te trafikut me nje rivendosje te perseritur te ndricimit te trafikut mund te kerkohet. Ne varesi te progresit te puneve, nje rivendosje e ndricimit te trafikut mund te kerkohet. Postet e sinjaleve te rrugeve do te jene sipas policise. Kosto e operimit dhe e elektrikut dhe lidhjet me sistemin do te perfshihen ne kostot e Kontraktorit.

2.3. RRETHIMI I LEVIZSHEM PER OBJEKTIN

Per te arritur sigurine ne terren, te gjitha gropat e ndertesave dhe kanaleve duhet te mbyllen me nje rrethim te levizshem gjate ndertimit te linjave te tubave deri sa mbushja e tyre te plotesohet. Rrethimi i levizshem i objekteve (lartesi: 2,00 m) duhet te jete i asambeluar me elemente hekuri me shufra celiku, bazament betoni duke perfshire te gjitha materialet e nevojshme per rrethim. Aty do te perfshihen dyert dhe portat e duhura.

2.4. RRUGET E TRAFIKUT TE PERKOHSHEM

Per mirembajtjen e trafikut gjate te gjitha periudhes se ndertimit duhet te ndertohen rruge te perkohshme trafikur. Perpara fillimit te ndertimit, Kontraktori do te pregatise nje plan trafikur per

rruget e perkohshme dhe te marre lejen e sektorit perkatese per ceshtjet e rrugeve. Per ti sjelle ne gjendjen origjinale keto rruge te perkohshme duhet te behet heqja e tyre pas perfundimit te punimeve duke perfshire edhe punime shtese.

2.5. DHERAT E SIPERFAQES

Kur eshte e aplikueshme, per germimet e kanaleve dhe gropave, shtresat e dherave (trashesi mesatare: 30 cm) perfshi barin, shkurret e te tjera duhet te hiqen dhe te ndahen nga germimi i shtresave me te thella. Per riperdorimin e tyre, keto dherave te vendosen ne vendin e ndertimit.

Pas rimbushjes se kanaleve dhe gropave te ndertesave, Kontraktori do te transportoje dherat e siperfaqes dhe te mbushje shtresat e saj sipas trashesise se kerkuar ne siperfaqe te pjerrta dhe horizontale ne terren.

2.6. PRISHJA E ASFALTIT TE RRUGEVE EKZISTUESE

Kontraktori duhet te prese dhe te thyjeje asfaltin ekzistues, troturet ekzistues duke perfshire bordurat sic kerkohet per ndertimin e rrugeve dhe germimin e kanaleve te tubave, transportit dhe largimit te materialeve sipas rregullave respektive. Certifikatat e largimit nevojitet te paraqiten tek Inxhinieri.

2.7. GERMIMET

Cmimi njesi i zerave te punes per germimet do te perfshine, por nuk do te kufizohen per germime ne te gjitha gjeresine dhe thellesine, me cdo mjet qe te jete i nevojshem, duke perfshire germime me dore, nen apo mbi nivelin e ujrave nentoksore, ose nivelin e ujrave siperfaqesore, perfshire perzierje dheu te cdo lloji, mbeshtetset, perforcimin ne te gjitha thellesite dhe gjeressite, me cdo lloj mjete qe te jete nevoja, perfshire edhe germimet me dore, dhe do te perfshije largimin e ujrave nentoksore dhe siperfaqesor ne cdo sasi dhe nga cdo thellesi, me cdo mjet te nevojshem, do te perfshije nivelimin, sheshimin, ngjeshjen e formacioneve, proven dhe per cdo pune shtese per mbrojtjen e formacioneve perpara cdo inspektimi, sic specifikohet, largimin dhe grumbullimin e pemeve te larguara, rilevimi topografik i kerkuar, vendosja e piketave te perhershme, dhe te atyre te perkoheshme, realizimi i matjeve, sigurimi i instrumentave per tu perdorur nga Mbikqyresi i Punimeve, furnizimi dhe transporti i fuqise puntore, mbajtja e vendit te punes paster dhe ne kushte higjeno-sanitare, dhe cdo nevojte aksidentale e nevojshme per realizimin e Punimeve brenda periudhes se Kontrates dhe pelqimit te Mbikqyresit te Punimeve.

Aty ku materiali i germuar eshte perdorur per mbushje; depozitimi duke perfshire dhe transportin ne dhe nga depozitimi, ngarkimin, shkarkimin, transportin me dore, jane perfshire ne cmimin njesi per germimet.

Kosto e transportimit te materialit te tepert te germuar deri ne vendin e hedhjes, te aprovuar nga Mbikqyresi i Punimeve, nuk perfshihet ne cmimin njesi te germimit. Kosto e transportimit te materialit te tepert ne vendin e hedhjes mbulohet nen cmimin njesi te transportit te materialeve.

Pervec transportimit te materialit te tepert te gjitha llojet e transportit perfshire edhe transportin e materialeve per perforcim, mbulim, pergatitjen e shtratit, etj perfshihen ne cmimin njesi te germimit. Nese nuk eshte pohuar ndryshe, te gjitha aktivitetet e tjera te pershkruara me siper do te konsiderohen te perfshira ne cmimin njesi te germimit.

Germimi ne dhera duhet te aplikohet ne te gjitha materialet qe mund te germohen si me krahe (perfshi me kazma) ashtu dhe me makineri.

Perpara fillimit te ndonje germimi, Kontraktori do te takoje institucionet lokale (per energji, komunikimin, etj) per te lokalizuar kabllot ekzistuese dhe tubat. Cdo instruksion i dhene nga keto ndermarrje do te ndiqet.

Per te identifikuar vendin e tubave ekzistuese dhe kabllot, Kontraktori do te siguroje germime te zakonshme te kanaleve shtese. Atje ku kabllot dhe tubat ekzistuese nderpresin kanalin ose ecin paralel, Kontraktori duhet te germoje me krah. Per te gjithë kohen e ndertimit, kabllot dhe tubat ekzistuese duhet te sigurohen dhe mbeshteten.

Kabllot, kokat e tyre dhe tubat qe jane paralel ne kanalin e tubave do te mbeshteten ne menyre te sigurt. Kabllot e mundshme ekzistuese mund te hiqen perkohesisht ne se lejohet dhe te vendosen ne kantier. Pas perfundimit te puneve, kabllot dhe tubat duhet te rivendosen dhe te shenohen me nje shirit kabli per kujdes.

Kontraktori do te lejohet te perdore eksploziv vetem me lejen e Inxhinierit dhe Punedhenesit. Pas gjetjes se lejes se dhene, te gjitha shperthimet do te behen nga persona te trainuar dhe te kualifikuar nen supervizimin e nje drejtuesi me experience i cili ka nje certificate zyrtare autentike per shperthimet. Kostot per sigurimin, heqjen dhe rivendosjen e linjave ekzistuese te sherbimit do te perfshihen ne cmim njesi.

Kanalet dhe gropat e pusetave do te germohen sipas standarteve (i.e. DIN 4124, DIN EN 1610). Kanali i tubave do te jete sipas profilit. Gjeresia e pjeses se poshtme e kanalit do te jete sipas DIN EN 1610 per diametrin nominal te tubit. Thellesia e kanalit dhe e pusetave do te jepet ne vizatime.

Gjeresia Minimum e kanalit ne lidhje me diametrin nominal te tubit DN			
DN	Gjeresia mininmale e kanalit (Dj + X)		
	Kanal me mbeshtetje	Kanal pa mbeshtetje $\beta > 60^\circ$	Kanal pa mbeshtetje $\beta \leq 60^\circ$
≤ 225	Dj + 0,40	Dj + 0,40	Dj + 0,40
> 225 to ≤ 350	Dj + 0,50	Dj + 0,50	Dj + 0,40
> 350 to ≤ 700	Dj + 0,60	Dj + 0,60	Dj + 0,40
> 700 to ≤ 1200	Dj + 0,80	Dj + 0,80	Dj + 0,40
> 1200	Dj + 1,00	Dj + 1,00	
X i korrespondon hapesires minimale ndermjet tubave dhe mureve te kanalit			
Dj – Diametri i jashtem i tubit i dhene ne m			
β - kendi i pjerrtesise se mureve te kanalit i matur nga horizontali			

Germimi duhet te kryhet ne perputhje me nivelet ne Vizatime. Cdo thellesi me e madhe e germuar nen nivelin e formacionit, brenda tolerances se lejuar, duhet te behet mire me mbushje me materiale te pranueshme me karakteristika te ngjashme nga Sipermarresi me shpenzimet e tij.

Kujdes i vecante duhet te ushtrohet kur germohet per te mos hequr material pertej vijes se specifikuar te prerjes dhe me pas duke shkaktuar rrezikshmeri per qendrueshmerine strukture te pjerrtesise ose duke shkaktuar erozion ose disintegrimin e pjeseve te ngjeshura.

Permasat e prerjeve duhet te jene ne perputhje me detajet e seksione terthore tip sic tregohen ne Vizatime.

Dherat e germuar e klases 3-4, ne se eshte e mundur te magazinohen ne anen tjetër te kanalit ne sasine qe kerkohet per rimbushje te kanaleve. Dherat e germuar qe nuk mund te vendosen ne ane te kanalit duhet te transportohen ne nje vend tjetër te siguruar nga Kontraktori dhe do te perdoren per rimbushje te kanalit te tubave. Kontraktori do te parashikojë nje vend magazinimi te dherave per te lejuar transportin e tyre ne distance te gjate dhe pa demtim te tubave.

Gjithashtu, dherat e klases 3-5 mund te germohen me metoda manuale dhe ose makineri. Kontraktori duhet te marre aprovimin e Inxhinierit per perdorimin e cdo metode dhe ai duhet te kete nje protokoll, perfshi librin e masave me volume dhe dimensionet e kanalit per cdo prej tyre.

Kontraktori duhet te parashikojë te germojë dherat e klases 6-7 me cekic pneumatik sipas standarteve dhe kushteve teknike mbi sigurine e punimeve. Kontraktori duhet te marre aprovimin e Inxhinierit per germimet speciale te dherave te klases 6-7.

Kanalet do te germohen ne dimensionet dhe nivelin e e treguar ne vizatime dhe /ose ne perputhje me instruksionet me shkrim te Mbikqyresit te Punimeve. Zeri I treguar ne tabelen e Volumeve (Preventiv) lidhur me germimet ,sic eshte largimi I materialit te germuar, etj. do te perfshijë cdo lloj kategorie dheu, nese nuk do te jete specifikuar ndryshe. Germimi me krahe eshte gjithashtu i nevojshem ne afersi te intersektimeve te infrastrukturave te tjera per te parandaluar demtimin e tyre. Me perjashtim te vendeve te permendura me sipër , mund te perdoren makinerite.

Ne se nuk urdherohet apo lejohet ndryshe nga Mbikqyresi i Punimeve nuk duhet te hapen me shume se 30 metra kanal perpara perfundimit te shtrirjes se tubacionit ne kete pjese kanali.

Thellimet per pjeset lidhese do te germohen me krah mbasi fundi i kanalit te jete niveluar. Pervec se kur kerkohet ndryshe, kanalet per tubacionet do te germohen nen nivelit te pjese se poshteme te tubacionit sic tregohet ne vizatime, per te bere te mundur realizimin e shtratit te tubacioneve me material te granular.

Germimi per strukturat duhet te jete ne perputhje me Vizatimet. Anet duhen mbeshtetur ne menyre te pershtatshme gjate gjithë kohes. Nje alternative eshte qe ato mund te ngjeshen ne menyre te pershtatshme. Germimet duhet te mbahen te pastra nga uji. Tabani i te gjithë germimeve duhet te nivelohet me kujdes. Cdo pjese me material te bute ose mbeturina shkambi ne taban duhet te hiqet dhe kaviteti qe rezulton te mbushet me beton.

Guret dhe materialet me te medha se 25 cm do te mblidhen dhe largohen me shpenzimet e Kontraktorit. Kontraktori do te largojë dherat e hequra me shpenzimet e veta.

Pergatitjet per nenshtresat (shtrati i tubave) ne pjesen e poshtme te kanalit do te devijojne deri ne jo me shume se 2 cm nga thellesia e kerkuar e germimit. Te gjitha punet shtese te lidhjeve te tubave dhe germimet e pusetave do te perfshihen ne cmimin njesi.

Kanalet duhet te rimbushen pas instalimit te tubave dhe pjeseve lidhese te tyre brenda dites se punes. Kontraktori do te jete pergjegjes per cdo demtim te kanaleve te hapur gjate diteve te shiut dhe qe nuk ka permbushur kushtet e mesiperme.

2.8. MBESHTETJET E KANALIT

Gjate germimit te kanaleve, Kontraktori do te perdore mbeshtetese ne te dy anet e kanalit duke filluar nga fundi kanalit ne te gjithë thellesine qe jane me shume se 0,9 m (pervec se kur eshte shkemb ose dhe i forte).

2.9. SHTRATI I TUBAVE

Per nje themel uniform te tubave, Kontraktori duhet te siguroje nje shtrese rere ose zhavorri (madhesia maksimale e kokrrizës: 20 mm) sipas DIN EN 1610 me nje trashesi 100 mm + 1/10 DN ne mm. Trashesia minimale e shtratit te tubit ne shkemb ose dhe te ngjeshur do te jete 150 mm. Shkalla e ngjeshjes kerkohet me nje minimum dendesie te thate prej 95% per dhera te shkrifet dhe 90% per dhera te lidhur. Kontraktori do te zbatoje testet (testi: plate load test sipas DIN 18134) per te verifikuar shkallen e ngjeshjes.

2.10. SHTRATI I ZHAVORRIT

Perpara ndertimit te pusetave, Kontraktori do te instaloje nje shtrese zhavorri me trashesi 10 cm. Nje shkalle ngjeshje ne te thate prej 95 % eshte e kerkuar. Kontraktori duhe te beje edhe testet perkatese (testi: plate load test sipas DIN 18134) per te verifikuar shkallen e ngjeshjes.

2.11. MBUSHJE FILLESTARE

Deri ne 30 cm mbi tub, Kontraktori duhet te mbushe kanalin me zhavorr ose rere (max i kokrrizes: 20 mm) ne shtresa deri ne 30 cm (ne te dy anet e tubave, kjo shtrese do te jete deri ne 20 cm) duke perdorur nje ngjeshje manual ose ngjeshje te vogel. Nje shkalle ngjeshje prej 95 % eshte e kerkuar. Kontraktori duhe te beje edhe testet perkatese (testi: plate load test sipas DIN 18134) per te verifikuar shkallen e ngjeshjes.

2.12. SHIRITI I KUJDESIT DHE SHTRESAT GJEOTEKSTILE

Mbi mbushjen fillestare, nje shirit plastik kujdesi duhe te vendoset ne te gjithë gjatesine sipas DIN V 54841 –1 per te mbrojtur tubin dhe ndonje detektim te mevonshem. Ngjyra dhe pershkrimi do te jene sipas qellimit. Shiriti i kujdesit do te jete me nje ngjyre brilante dhe gjeresi 40 mm.

Ne dherat shume te holle ose ne ane te filtrit te anes se asfaltimit ose ne rastet me pjerresi mbi 10 %, Kontraktori duhet te perdore nje filter gjeotekstili ne polyester ose PE. Materiali duhet te perdoret i aprovuar nga Inxhinieri.

Copa te ndryshme "geotextile" do te vendosen se bashku per linjat e drenazhimit dhe te KUN; copat duhet te mbivendosen te pakten 50 cm.

Pjesa e poshtme e copes se "geotextile" ne kontakt me pjesen e poshtme te kanalit dhe per nje lartesi prej te pakten 20 cm ne cdo ane do te mprenjohet me bitum te nxehte te shkalles 2 kg/m². Imprenjimi behet perpara instalimit te "geotextile" ne kanal pas vendosjes ne vend. "Geotextile" do te rrije jashte kanalit ne nje sasi qe duhet per dublimin e mbivendosjes ne maje te drenazhit (dy here gjeresi e kanalit).

Kanalet e drejta do te mbushen me material te germuar te thyer, pastruar me te pakten nje shtrat prej 10 mm pastruar me nje site 70 mm. Materiali do te mbushet i plote ne menyre qe ta beje gjeotekstilin te rrije sa me mire tek muret e kanalit. Pas kompletimit te mbushjes, "geotextile" do te mbivendoset ne maje dhe do te mbulohet me dhe te ngjeshur.

2.13. RIMBUSHJA E KANALEVE

Kontraktori duhet të mbushë kanalet e germuar me dhe të ngjeshur (shtresa me trashësi jo më shumë se 30 cm dhe që është e lirë nga mbetjet, materialet e keqja apo bimesi. Mbushja do të zbatohet në shtresa 30 cm për secilën. Një shkallë ngjeshje prej 95 % është kërkuar. Kontraktori duhet të zbatojë testet (testi: plate load test sipas DIN 18134) për të verifikuar shkallën e ngjeshjes. Kontraktori duhet të mbushë kanalet për të gjithë tubat e instaluar (përveç zonave të bashkimit të tubave). Në këtë zonë, tubi duhet të ketë mbulësë druri ose plastike për të mbrojtur ato nga materialet e pista dhe ose material të papranueshëm) gjatë një dite pune.

Tabani i dheut i shtresave rrugore është pjesë e trupit të dheut ku shpërndahen nderjet e shkaktuara nga ngarkesat e levizshme të automjeteve dhe e vete konstruksionit. Ky taban mund të jetë në mbushje ose në germim. Si në njerin rast edhe në tjetrin është e nevojshme që të sigurohet një taban, që të jetë në gjendje të transmetojë me poshtë, në trupin e dheut ngarkesat që vijnë nga shtresat rrugore, pa pësuar deformime mbetëse.

Mbushja gjithandëj duhet të ketë një densitet që i referuar standartit AASHTO të modifikuar të jetë max. në të thatë jo më pak se 90%, për shtresat e poshtme të ngjeshura dhe 95%, për shtresën e sipërme 30cm (subgrade).

Çdo shtresë duhet të ngjishet me lageshtinë optimale duke shtuar ose tharë shtresën sipas rastit dhe kërkesës së llojit të materialit që do të përdoret në mbushje të rrugës.

Çdo shtresë e re në mbushje duhet të miratohet nga Mbikqyresit të Punimeve, pasi të jetë siguruar se shtresa paraardhëse nuk ka deformacione ose probleme me burime uji apo lageshtirë të tepert.

Zgjedhja e pajisjeve të ngjeshjes është e lirë të bëhet nga Sipermarresi, mjafton që pajisjet ngjeshëse të sigurojnë energjinë e nevojshme dhe të arrijnë densitetet e kërkuara në ngjeshje për shtresën në ndërtim.

2.14. MBUSHJA E PUSËTAVE

Pas ndërtimit të pusëtave, Kontraktori duhet të mbushë gropën e germuar me dhe të ngjeshur jo-kohësive, (klasa 3-4, koeficient: $U=6-10$, përmbajtje argjil dhe (madhësi kokrrizë ≤ 0.06 mm): max.10%) e lirë nga mbetjet, materiale të keqja apo bimesi. Mbushja do të zbatohet në shtresa 40 cm për secilën. Çdo shtresë do të ngjishet nga një ngjeshës i aprovuar përpara vendosjes së çdo shtrese. Një shkallë ngjeshje prej 95 % është kërkuar. Kontraktori duhet të zbatojë testet (testi: sipas DIN 18134) për të verifikuar shkallën e ngjeshjes.

2.15. DERRASAT PËR KALIMIN E KANALEVE

Gjatë ndërtimit të kanalave, Kontraktori do të sigurojë dhe mirembajë disa derrasa për kalimin e sigurt të kanaleve me një ndërtim të qëndrueshëm. Këto derrasa të levizshme për kalimin e kanaleve do të kenë edhe mbrojtësë të thjeshta. Një Instruksion i Inxhinierit apo Pundhënesit për këto kalime duhet të bëhet.

2.16. SIGURIMI I RRETHIMEVE DHE MUREVE EKZISTUESE

Gjate punes se ndertimit, rrethime dhe mure ekzistuese duhet te mbeshteten dhe te sigurohen. Cdo lloj i themeleve qe eshte i ekspozuar gjate punimeve te tokes dhe ka nje risk per te rene, duhet te sigurohet dhe mbeshtetet sipas zgjedhjes se Kontraktorit duke perfshire edhe punet shtese.

Si pjese e punes ne zerat e germimit Sipermarresi, me shpenzimet e veta, do te perforcoje te gjitha ndertimet, muret si edhe strukturat e tjera qendrueshmeria e te cilave duhet te garantoje mosrrezikimin gjate zbatimit te punimeve dhe do te jete teresisht pergjegjes per te gjitha demtimet e personave ose te pasurive qe do te rezultojne nga aksidentet e ndonje prej ketyre ndertimeve, mureve ose strukturave te tjera.

Neqofte ndonje nga keto pasuri, struktura, instalime ose sherbime do te rrezikohen ose demtohen si rezultat i veprimeve te Sipermarresit, ai menjehere duhet te raportojte per keto rreziqe ose demtime te Inxhinieri si dhe autoritetet qe kane lidhje me te dhe menjehere te mare masa per ndreqjen gjithmone sipas pelqimit te Mbikqyresit te Punimeve ose te autoriteteve perkatese.

Nese germimi i zakonshem nuk eshte i mundur apo i keshillueshem, gjate germimeve duhet te vendosen struktura mbajtese per te parandaluar demtimet dhe vonesat ne pune si edhe per te krijuar kushte te sigurta pune. Sipermarresi do te furnizojte dhe vendose te gjitha strukturat mbajtese, mbulese, trare dhe mjete te ngjashme te nevojeshme per sigurimin e punes, te publikut ne pergjithesi dhe te pasurive qe jane prane. Strukturat mbrojtese do te hiqen sipas avancimit te punes dhe ne menyre te tille qe te parandalojne demtimin e punes se perfunduar si edhe te strukturave e pasurive qe jane prane. Sapo keto te hiqen te gjitha boshlleqet qe mbeten nga heqja e ketyre strukturave duhet te mbushen me kujdes dhe me material te zgjedhur dhe te ngjeshur. Sipermarresi do te jet krejtesisht pergjegjes per sigurimin e punes ne vazhdim, te punes se perfunduar, te punetoreve, te publikut dhe te pasurive qe jane prane. Kosto e perforcimit dhe veshjes se germimeve eshte perfshire ne cmimin njesi per germimet.

Sipermarresi do te kete kujdes te vecante per sherbimet ekzistuese qe jane nen siperfaqe te cilat mund te ndeshen gjate zbatimit te punimeve dhe qe kerkojne kujdes te vecante per mbrojtjen e tyre , si tubat e kanalizimeve, tubat kryesore te ujesjellesit, kabllot elektrike kabllot e telefonit si dhe bazamentet e strukturave qe jane prane. Sipermarresi do te jete pergjegjes per demtimin e ndonje prej sherbimeve si dhe duhet t'i riparoje me shpenzimet e tij, nese keto sherbime jane ose jo te paraqitura ne projekt. Nese autoritetet perkatese pranojne te rregullojne vete ose nepermjente nje nenSipermarresi te emruar nga ai vete , demet e shkaktuara ne keto sherbime, Sipermarresi do te rimbursoje te gjitha koston e nevojeshme per kete riparim, dhe ne se ai nuk ben nje gje te tille, keto kosto mund t zbriten nga cdo pagese qe Punedhensei ka per ti bere ose do ti beje Sipermarresit ne vazhdim te punimeve.

2.17. SIGURIMI I POSTEVE DHE SINJALEVE EKZISTUESE TE NDRICIMIT

Postet e ndricimit, treguesit dhe shenajt e trafikut qe jane vendosur ne zones e trasese dhe kane problem per qendrueshmerine e tyre gjate periudhes se ndertimit do te mbeshteten dhe sigurohen me kujdes kundrejt kolapsit dhe paqendrueshmerise.

2.18. MBROJTJA E PEMEVE

Pemet do te mbrohen ndaj demtimeve mekanike nga perdorimi i koshave me lartesi vetikale afro 2.00 m dhe gjeresi te vrimes prej afro 10 cm ndermjet pemeve dhe koshit me material te pershtatshem (dhe i ngjeshur, ose te njejte).

Rrenjet e pemeve do te mbrohen nga germimet e rrugeve. Ne mbrojtjen e pemeve, Kontraktori do te marre masat sipas DIN 18920 “Mbrotja e Pemeve, bimeve dhe vegetation gjate ndertimit” si dhe “manual per ndertimin e rrugeve ”, pjesa Landscaping (RAS-LG 4). Per sigurimin e rrenjeve do te perdoret manual i germimeve. Rrenjet e prishura dhe te thyera do te trajtohen sipas DIN 18920. Demtimet e rrenjeve kryesore do te trajtohen ne menyre profesionale. Rrenjet e dala do te sigurohen dhe mbrohen nga cpimet me veshje te ngrohta ose thase.

2.19. HEQJA E UJIT

Si pjese e punes ne zerat e germimit dhe jo me kosto plus per Punedhenesin, Sipermarresi do te ndertoje te gjitha drenazhimet dhe do te realizoje kullimin me kanale kulluese ,me pompim ose me kova si edhe te gjitha punet e tjera te nevojeshme per te mbajtur pjesen e germuar te paster nga ujerat e zeza dhe nga ujera te jashme gjate avancimit te punes dhe derisa puna e perfunduar te jete e siguruar nga demtimet. Sipermarresi duhet te siguroje te gjitha pajisjet e pompimit per punimet e tharjes se ujit si edhe personelin operativ, energjine e te tjera, dhe te gjitha keto pa kosto shtese per Punedhenesin. I gjithë uji i pompuar ose i drenazhuar nga vepra duhet te hiqet ne nje menyre te aprovueshme prej Mbikqyresit te Punimeve. Duhet te meren masa paraprake te nevojeshme kunder permytjeve. Ne kete proces do te perfshihet mirembajtja, operimi, kontrolli, sherbimi i impiantit per te gjithë periudhen e ndertimit, leja per shkarkimin e ujit te ujrave te shiut dhe sistemet e ujrave te zeza apo te lumit nese ka.

2.20. MBROJTJA E SHERBIMEVE EKZISTUESE

Sipermarresi do te kete kujdes te vecante per sherbimet ekzistuese qe jane nen siperfaqe te cilat mund te ndeshen gjate zbatimit te punimeve dhe qe kerkojne kujdes te vecante per mbrojtjen e tyre , si tubat e kanalizimeve, tubat kryesore te ujesjellesit, kabllot elektrike kabllot e telefonit si dhe bazamentet e strukturave qe jane prane. Sipermarresi do te jete pergjegjes per demtimin e ndonje prej sherbimeve si dhe duhet t’i riparoje me shpenzimet e tij, nese keto sherbime jane ose jo te paraqitura ne projekt. Nese autoritetet perkatese pranojne te rregullojne vete ose nepermjent nje nenSipermarresi te emruar nga ai vete , demet e shkaktuara ne keto sherbime, Sipermarresi do te rimbursuje te gjithë koston e nevojeshme per kete riparim, dhe ne se ai nuk ben nje gje te tille, keto kosto mund I zbriten nga cdo pagese qe Punedhensei ka per ti bere ose do ti beje Sipermarresit ne vazhdim te punimeve.

2.21. PASTRIMI I SHESHIT

Te gjitha sheshet ku do te germohet, do te pastrohen nga te gjitha shkurret, bimet, ferrat, rrenjet e medha, plehrat dhe materiale te tjera siperfaqesore. Te gjithë keto materiale do te spostohen dhe largohen ne menyre qe te jete e pelqyeshme per Punedhenesin. Te gjitha pemet dhe shkurret qe jane pecaktuar nga Punedhensei qe do te ngelen do te mbrohen dhe ruhen ne menyren e aprovuar.

Te gjitha strukturat ekzistuese te identifikuara per tu prishur do te largohen sipas udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve. Kjo do te perfshije dhe spostimin e themeleve te ndertimeve qe mund te ndeshen.

Sipermarresi do te marre te gjitha masat e nevojeshme per mbrojtjen e vijave ekzistuese te ujit, rrethimeve dhe sherbimeve qe do te mbeten ne sheshin e ndertimit. Kosto e pastrimit te kantierit eshte e detyrueshme te paguhet brenda cmimit njesi per punimet e germimit .

2.22. MIREMBAJTJA E GERMIMEVE

Te gjitha germimet do te mirembahen sic duhet nderkohe qe ato jane te hapura dhe te ekspozuara, si gjate dites ashtu edhe gjate nates. Pengesa te mjaftueshme, drita paralajmeruese, shenja, si edhe mjete te ngjashme do te sigurohen nga Sipermarresi. Sipermarresi do te jete pergjegjes per ndonje demtim personi ose pronesie per shkak te neglizhences se tij.

2.23. MATJET

Te gjitha zerat e germimeve do te maten ne volum. Matja e volumit te germimeve do te bazohet ne dimensionet e marra nga vizatimet ne te cilat percaktohen permasat e germimeve.

Cdo germim pertej limiteve te percaktuara ne keto vizatime, nuk do te paguhet, nese nuk percaktohet me pare me shkrim nga Mbikqyresi i Punimeve. Megjithate, nese germimi eshte me pak se volumi i llogaritur nga vizatimet, do te paguhet volumi faktik i germimeve sipas matjeve faktike.

2.24. MBUSHJA DHE MBULIMI

Pergjithshme

Punimet mbushese do te realizohen ne perputhje me permasat dhe nivelet qe tregohen ne vizatime dhe/ose sic percaktohen ndryshe me shkrim nga Mbikqyresi i Punimeve. Punimet do te realizohen ne nivelin qe te kenaqin kerkesat e Mbikqyresit te Punimeve.

Materialet qe do te perdoren per punimet mbushese do te jene te lira nga gure dhe pjese te forta me te medha se 75 mm ne cdo permase, dhe gjithashtu te paster nga perbersa druri apo mbeturina te cdo lloji. Materiali mbushes do te ngjeshet sipas menyres se aprovuar.

Kanalet dhe shpatet, transhete dhe mbushjet e rrugeve do te ngjeshen gjithashtu. Nese nuk specifikohet ndryshe apo kerkohet ndryshe nga Mbikqyresi i Punimeve, materiali mbushes dhe mbulues do te merret nga punimet e germimeve. Nese Mbikqyresi i Punimeve percakton se materiali nuk eshte i cilesise se duhur atehere, do te perdoret material i zgjedhur i sjelle nga nje zone tjeter. Materiali i zgjedhur do te jete homogjen dhe do ti kushtohet rendesi pastrimit nga llumrat, boshlleqet dhe cdo parregullesia tjeter.

Mbushjet dhe mbulimet do te jene ne shtresezime te vashdueshme dhe gati horizontale per te arritur trashesine e treguar ne vizatime ose sic mund te kushtezohet nga Mbikqyresi i Punimeve. Mbulimi ne punimet e mbushjes dhe mbulimit, me material siperfaqesor, nuk eshte i lejueshem. Shtresa e siperme e fundit e mbushjes dhe e mbulimit duhet te mbahet ne gjendje sa me te sheshte te jete e mundur. Ne vendet ku kerkohet mbushje ose mbulim shtese, lartesia e treguar ne vizatime per mbushje dhe mbulim do te rritet ne perputhje me udhezimet e dhenat.

Pergatitja e shtratit

Jetegjatesia e tubacioneve Polietilenit te shtruara ne toke varet shume nga cilesia e shtratit. Materiali dhe ngjeshmeria e duhur e shtratit menjanon difektet qe mund te shkaktohen nga deformimet e padeshiruara dhe mbingarkimet vendore. Nevoja per shtrat te veçante gjykohet sipas llojit te tokes. Shtrati nuk eshte i nevojshem, kur toka eshte e forte, me strukture kokrrizore dhe $D_{max} < 20$ mm. Por edhe ne keto raste fundi (tabani) duhet ngjeshur. Ne te gjitha rastet e tjera dhe shtrat, me trashesi minimale 10 cm, ne shkemb dhe ne toke me gure 15 cm. Ne toke te disfavorshme, si toke me shume permbajtje organike, les qe shembet lehte, shtrese nen nivelin e ujit freatik, nen shtrat duhet projektuar edhe shtrese mbeshtetese. Materiali dhe se ndertimi i saj percaktohen vecmas per çdo rast nga projektuesi. Per shtratin mund te perdoret dhe i shkrifet dhe i ngjesheshem ose dhe pak i lidhur, pa shuka. Diametrat maksimale te grimcave:

- ne rastin e tubave PVC dhe Polietilenit normale, me faqe te rrafshet: $D_{max} < 20$ mm
- ne rastin e tubave te lemuar: $D_{max} < 5$ mm

Ky material shtrati duhet vendosur ne tere zonen e tubit, deri 30 cm mbi buzën e sipërme te ketij (shih projektin). Ne tere zonen e tubit hedhja dhe ngjeshja duhet te behen ne shtresa jo me te trasha se 15 cm. Per tubat me diameter te vogel trashesia e shtreses se poshtme nuk mund te jete me shume se $D/2$. Mbushja me hedhje te dheut me makineri eshte rreptesisht e ndaluar. Hedhja e dheut, levizja dhe ngjeshja e tij do te behen vetem me krahe. Per ngjeshje rekomandohen tokmake me buze te rrumbullakuara. Ne terren te pjerrët duhet ndertuar dhembë betoni kunder shkarjes (shif projektin). Madhesine dhe dendesine e dhembëve e gjykon projektuesi. Per orientim: Kur pjerrësia eshte mbi 10% dhe kur zona mbi tub mban uje, kur pusetat jane me larg se 80m nga njera-tjetra, propozohen dhembë çdo rreth 50m.

2.25. MIREMBAJTJA E DRENAZHEVE

Mbulimi do te behet ne menyre te tille qe te mos mbetet apo te akumulohet uje ne pjese e pambushura ose kanalet pjeserisht te mbushura. Materialet e depozituara ne kanalet e rrugeve ose ne rruge te tjera ujqore qe nderpriten nga linja e kanaleve do te largohen menjehere pas perfundimit te procesit te mbulimit duke kthyer formen dhe permasat e kanaleve ne gjendjen e meparshme. Drenazhimet siperfaqsores nuk do te nderpriten per kohe te gjate nese nuk do te jete e nevojshme.

2.26. ÇMIMI NJESI PER MBUSHJE, MBULIM ME ZHAVORR DHE NGJESHJE

Cmimi njesi per mbushjen, mbulimin me zhavorr mbulon: materialin mbushes, ngarkimin, shkarkimin, transportin, ngritjen, transportin me dore, ngjeshjen ne shtresa, lagjen kur eshte e nevojshme, provat, te gjitha llojet e materialeve, makinerive, fuqise puntore dhe cdo aktivitet tjeter pershkruar ketu me siper te cilat jane te domosdoshme per ekzekutimin e punimeve.

Matjet: Matjet e volumit te mbushjeve dhe mbulimeve do te bazohen ne permasat e nxjerra nga vizatimet qe lidhen me kete proces. Cdo ndryshim i volumit te mbushjeve dhe mbulimeve pertej limiteve te treguara ne keto vizatime nuk do te paguhet, pervec se kur percaktohet ndryshe paraprakisht me shkrim nga Mbikqyres i Punimeve.

3. TUBAT

3.1. TË PËRGJITHSHME

Kontraktori do te furnizojë dhe instalojë komplet tubat dhe pjesët lidhëse të tyre siç kërkohe për ndërtimin e linjave të S.F.U. sipas vizatimeve.

Tubat, rakorderitë dhe pajisjet e tjera të kontrollit të rrjedhjes, do të transportohen, magazinohen dhe montohen/vendosen sipas instruksioneve të dhëna nga Prodhuësi, për të siguruar qëndrueshmërinë e perberësve të tyre dhe për të gjetur garancinë e prodhuesit, të gjitha tubat, pjesët lidhëse dhe aksesoret do të furnizohen vetëm nga një prodhues.

Tubat dhe pjesët lidhëse do të transportohen në terren në një magazinë të ndërmjetme, pa ngarkesë, do të instalohen në kanal në linjë të drejtë, në thellësinë dhe pjerresinë e treguar në Vizatime dhe të ngjitur duke përfshirë të gjitha punët e nevojshme shtesë sipas instruksioneve të prodhuesit.

Prodhuësi i tubave do të sigurojë llogaritjet strukturore. Tubat dhe pjesët lidhëse do të kenë kontroll cilësie sipas EN, DIN apo të ngjashme dhe shenjat e prodhuesit.

Kujdes duhet të tregohet për sigurimin e kushteve të shtratit të tubave sipas specifikimeve të dhëna. I gjithë tubi duhet të vendoset në pozicion dhe të instalohet drejt sipas profilit dhe drejtimit të pjerresisë të dhënë në seksionin gjatësor mbi shkallën e kërkuar. Përpara se tubat të jenë bashkuar ato do të pastrohen nga të gjitha lllumrat, guret apo objekte të tjera që mund të kenë hyrë brenda tyre.

Në fund të çdo dite pune dhe kur puna është ndërprerë për një periudhë kohore, fundet e lira të tubave të shtruar duhet të mbrohen nga mbulesa të përshtatshme kundrejt hyrjes së pislleqeve apo materialeve të tjera të huaja.

Kur shtrimi i tubave nuk është në progres, fundet e hapura të tubave të instaluar do të mbyllën për të mos lejuar hyrjen e ujit të kanalit në linjë. Gjithmënjëherë uji duhet të përjashtohet nga futja në brendësi të tubave dhe mbushja do të jetë e tillë që të mbrojë tubat nga pluskimi. Nëse ndonjë tub do të pluskojë, ai do të hiqet nga kanali dhe do të vendoset sipas direktivave të dhëna nga Inxhinieri.

Asnjë tub nuk do të vendoset në kushte të lageshtisë së kanalit që nuk lejon vendosjen e shtratit në mënyrën e duhur ose kur për opinionin e Inxhinierit, kushtet e kanalit apo të motit janë të përshtatshme për instalimin korrekt të tyre.

Tubat do të vendosen me pjerresinë të dhënë në Vizatime.

Mbushja e kanaleve të tubacioneve DN/Dj 20 ÷ DN/Dj 500 mm do të jetë si më poshtë (listuar nga poshtë-lart):

- Shtrati i tubit (10 cm)
- Anash tubit (30 cm)
- Mbushja e parë (10 cm)
- Mbushja e dytë (30 cm)
- Mbushja finale (deri në majë të kanalit të tubit)

3.2. TUBAT DHE RAKORDERITE PE100 RC

3.2.1. KERKESAT E PERGJITHSHME TE ARTIKULLIT

Tubat duhet te jene te perbere prej materiali termoplastik PE100RC, me veti te mira te fluiditetit dhe rezistences ndaj forces se presionit dhe fenominit te plasaritjes. Tubat duhet te jene te pershtatshem per tu instaluar ne terrene te ashpra, si dhe te jene konform me standardet e meposhtem.

- Resistance ndaj fenomenit te plasaritjes sipas ISO 16770
- MFR 190/5 jo me teper se 0.05 g/10 min sipas ISO 1133-1
- Densiteti specifik i materialit (ne 23°C) jo me teper se 0.96 g/cm³ sipas ISO 1183
- Percjellshmeria termike ne (20°C) jo me teper se 0.4 W/m*K sipas DIN 52612
- Resistenca ne ushtrim tensioni mekanik jo me pak se 20 MPa sipas ISO 527
- Zgjatimi i lejuar ne ushtrim tensioni mekanik jo me teper se 9 % sipas ISO 527

3.2.2 KERKESAT CILESORE TE TUBIT PE100 RC

Tubat PE100 RC duhet te jene prodhuar sipas kerkesave te Udhezimeve ne Standardet EN 12201 dhe PAS 1075, gjithashtu te jene te pershtatshem per perdorim ne sistemet e ujit te pijshem.

Per te vertetuar perputhshmerine e kerkesave te mesiperme, duhet te paraqitet Dokumentacioni Aprovues perkates i leshuar nga nje Institucion Kombetar ose Nderkombetar i Specializuar, i cili verteton produkti i ofertuar permesh te gjitha kerkesat cilesore te siperkerkuara.

3.2.3 KERKESAT E SIGURISE SE TUBIT PE100 RC

Tubat PE100 RC duhet te shfaqin siguri te larte gjate instalimit dhe perdorimit te tyre ndaj fenomeneve dhe faktoreve riskues si presioni, vetndezshmeria e materialit, procesi i bashkimit me elemente te tjere instalues te se njejtës natyre materiali.

- Durabiliteti ne presion sipas Udhezimeve 2014/68/EU dhe DVD 2210-1
- Siguria ndaj vetndezshmerise, jo nivel me te ulet se Klasi B sipas DIN 4102

Per te vertetuar perputhshmerine e kerkesave te mesiperme, duhet te paraqitet Dokumentacioni Aprovues perkates i leshuar nga nje Institucion Kombetar ose Nderkombetar i Specializuar, i cili verteton produkti i ofertuar permesh te gjitha kerkesat cilesore te siperkerkuara.

3.2.4 MARKIMI I TUBAVE

Tubat duhet te jene te markuar duke u bazuar ne Udhezimet e Standardit EN 12201, ku te jene te lexueshme dukshem te dhenat e meposhteme:

- Prodhuesi dhe marka tregtare e prodhuesit
- Dimensioni nominal
- Klasi serise SDR
- Materiali
- Presioni nominal
- Marka e konfirmimit te nje Trupi Certifikues te Akreditur
- Data e prodhimit
- d. Kaseta e hidrantit do të jetë e prodhuar konform UN 10779, me material çeliku të lyer me material kundra gërryerjes, me poliester ngjyrë të kuqe RAL 3000, me kapak, me përmasa minimale 1350 x 590 x 460 mm. Kaseta duhet të jetë e mbështetur mbi një shtyll me seksion drejtkëndësh, prej çeliku të lyer njësoj si kaseta, dhe me lartësi H = 550 mm. Kapet me vida mbi një bazament betoni. Kaseta duhet të përmbajë hedhësin e ujit, sipas CSI EN 15182, i cili duhet të jetë me levë me 3 pozicione, UNI 70, me dalje d = 16 mm; dy zorra, secila me DN 70 mm ($\varnothing 2 \frac{1}{2}$ "), me material të padjegshëm nga jashtë dhe me material gome tip EPDM nga brenda sipas EN 14540. Gjatësia e secilës prej zorrave të jetë L = 30 ml. Çelësi i hapjes së kapakëve të daljes së hidrantit, i cili është pajisje pjesë e hidrantit tip kolonë, të përmendur më sipër.
- e. Fikse zjarri me gaz inert ose me shkumë, konform EN 3.7, 6 ose 9 Lt.

4.10.2 Kërkesat Cilesore per Hidrante

Hidranti duhet te jete i pajisur si set, se bashku me elementet e instalimit si trup i vetem ne te dyja nivelet , poshte siperfaqes dhe siper saj. Elementet e nivelit te poshtem duhet te jene te pajisur me flanaxhe. Elementet e nivelit te siperm duhet te jene te pajisur me reduktorin e operimit ku te behet e mundur operimi i hapjes dhe mbylljes sa me thjeshte. Gjithashtu kerkohet qe elementi i nivelit te siperm te jete te pakten me 2 dalje , ku te behet e mundur instalimi me linja te jashtme per shfrytezim eficient te hidrantit.

4.10.3 Kërkesat e Sigurise per Hidrante

Hidranti duhet te jene projektuar dhe prodhuar sipas standardit EN 1074-6.

Elementet e konjksionit ne nivelin e poshtem te siperfaqes duhet te jete i tipit me flanaxhe te vrimezuar, ndersa ne nivelin e siper te siperfaqes duhet te jete i tipit mberthim mekanik me bulona dhe dado. Daljet ne elementin e siperm te siperfaqes duhet te jene te izoluara me tapa te filetuara dhe te lidhura me tirant apo zinxhir me elementin.

4.10.4 Kërkesat e Markimit Hidrante

Hidranti duhet te jete I markuar , ku te jene te lexueshme dukshem te dhenat e meposhteme:

- Prodhuesi dhe marka e tregtare e prodhuesit
- Presioni nominal
- Dimensioni nominal i flanaxhes
- Dimesionet nominal te daljeve

- Data e prodhimit
- Matrikulli i makines prodhuese

4.10.5 Kerkesat Cilesore Shtanga (Shpindel Zgjatues)

Shtangat duhet te jene konstruktivisht prej materiali celik special te galvanizuar. Gjatesia preferenciale e shtangave eshte 0.5-1 m. Maja e shtanges duhet te jete e pershtatshme per tu komanduar me volan, ndersa baza duhet te jete ne forme trapezoidale e pershtatshme per tu instaluar ne kokat e aksit komandues te saracineskave.

4.10.6 Kerkesat e Sigurise per Shtanga

Qendrueshmeri te larte ndaj forcave mekanike , resitente ndaj korrozionit.

4.10.7 Kerkesat e Markimit per Shtanga

Shtanga duhet te jete e markuar , ku te jene te lexueshme dukshem te dhenat e meposhteme:

- Prodhesi dhe marka e tregtare e prodhuesit
- Gjatesia lineare
- Dimensioni i bazes
- Data e prodhimit
- Matrikulli i makines prodhuese

4.11 ARMATURA DHE RAKORDERI

4.11.1 Kerkesat e Pergjithshme te Artikullit

Armaturat dhe Rakorderite duhet te jene konstruktivisht te perbera prej materiali cilesor gize, ku te shfaqin rezistence te larte ndaj presioneve nominal te kerkuar dhe ndaj forcave mekanike te ushtruar nga forca e paisjeve instalatore gjate procesit te instalimit. Kerkohen qe Armaturat dhe Rakorderite te jene te pajisura me sistemi konjeksioni me fllanxha dhe te pershtatshme te perdoren per linjat e ujrave te bardha dhe ujrat e perdorur.

4.11.2 Kerkesat Cilesore per Pjese Bashkuese

Pjesa Bashkuese duhet te jete e pajisur me dopjo fllanxha sebashku me bulonat e dadot per te mundesuar nje konjeksion solid ne elementin ku do te instalohet.

Pjesa bashkuese duhet te mundesoj axhustimin e gjatesise deri ne + / - 25 mm.

4.11.3 Kerkesat e Sigurise per Pjese Bashkuese

Fllanxhat duhet te projektohet dhe prodhohen sipas standardit EN 1092-2 dhe bulonat duhet te jene te perbera prej celiku te galvanizuar.

4.11.4 Markimi I Pjeseve Bashkuese

Pjeset Bashkuese duhet te jene te markuara ,ku te jene te lexueshme dukshem te dhenat e meposhteme:

- Prodhuesi dhe marka tregtare e prodhuesit
- Dimensioni nominal
- Presioni nominal
- Data e prodhimit
- Matrikulli i makines prodhuese

4.11.5 Kerkesat Cilesore per Brryl me Fllanxhe

Brrylat duhet te kene te inkorporuara nga te dyja krahet me fllanxha dhe duhet te jene te veshura me shtrese epoksi.

Brrylat duhet te jene te lakuar gjeometrikisht ne 90°dhe ne perputhshmeri me standardin EN 545.

4.11.6 Kerkesat e Sigurise per Brryl me Fllanxhe

Fllanxhat e brrylave duhet te jene projektuar dhe prodhuar sipas standardit EN 1092-2.

4.11.7 Kerkesat e Markimit per Brryl me Fllanxhe

Brrylat me Fllanxhe duhet te jene te markuara ,ku te jene te lexueshme dukshem te dhenat e meposhteme:

- Prodhuesi dhe marka tregtare e prodhuesit
- Dimensioni nominal
- Presioni nominal
- Lakueshmeria gjeometrike e sakte e shprehur ne grade
- Data e prodhimit
- Matrikulli i makines prodhuese

4.11.8 Kerkesat Cilesore per T me Fllanxhe

T-ja me Fllanxhe duhet te kete te inkorporuar nga te dyja krahet , fllanxha dhe duhet te jene te veshura me shtresi epoksi.

Ne varesi te preventivit T-te me fllanxhe duhet te jene me dalje te barabarta ose me dalje te reduktuara.

4.11.9 Kerkesat e Sigurise per T me Fllanxhe

Fllanxhat e T-ve duhet te jene projektuar dhe prodhuara sipas standardit EN 1092-2

4.11.10 Kerkesat e Markimit per T me Fllanxhe

T-te me Fllanxhe duhet te jene te markuara ,ku te jene te lexueshme dukshem te dhenat e meposhteme:

- Prodhuesi dhe marka tregtare e prodhuesit
- Dimensioni nominal
- Presioni nominal
- Lakueshmeria gjeometrike e sakte e shprehur ne grade
- Data e prodhimit
- Matrikulli i makines prodhuese

4.11.11 Kerkesat Cilesore per Reduksion

Reduksionet duhet te jene nga te dyja krahët te pajisura me fllanxha te inkorporuara ne trup.
Reduksionet duhet te jene veshura me shtrese epoksi dhe te prodhuara sipas standardit EN 545.

4.11.12 Kerkesat e Sigurise per Reduksion

Fllanxhat e reduksioneve duhet te jene projektuar dhe prodhuar sipas standardit EN 1092-2.

4.11.13 Kerkesat e Markimit per Reduksion

Reduksionet duhet te jene te markuara ,ku te jene te lexueshme dukshem te dhenat e meposhteme:

- Prodhesi dhe marka tregtare e prodhuesit
- Dimensioni nominal x Dimensioi i nominal i reduktuar
- Presioni nominal
- Data e prodhimit
- Matrikulli i makines prodhuese

4.11.14 Kerkesat Cilesore per Adaptor me Fllanxh-Spigot

Adaptor Fllanxh-Spigot konstruktivisht duhet te jete nga njera krah fllanxhe dhe tjetern me spigot .
Adaptori duhet te jete i pershtatshem per te mundesuar konjeksionet me tub tip PE, PVC.
Adaptori Fllanxh-Spigot duhet te jete i pershtatshem per tu perdorur per sistemet e ujit te pijshem.

4.11.15 Kerkesat e Sigurise per Adaptor me Fllanxh-Spigot

Fllanxha duhet te jete e projektuar dhe prodhuar sipas standardit EN 1092-2. Spigoti duhet te jete i tipit me konjeksion mekanik dhe ne buzet e brendshme duhet te kete gomine per perputhshmeri te larte me tubat PE, PVC. Gomina duhet te jete ne perputhshmeri me standardin EN 681-1.

Per te vertetuar perputhshmerine e kerkesave te mesiperme ,duhet te paraqitet Dokumentacioni Aprovues perkates i leshuar nga nje Institucion Kombetar ose Nderkombetar i Specializuar,i cili verteton produkti i ofertuar perm bush te gjitha kerkesat cilesore te siperkerkuara.

4.11.16 Kerkesat e Markimit per Adaptor me Fllanxh-Spigot

Adaptoret me Fllanxh -Spigot duhet te jene te markuara ,ku te jene te lexueshme dukshem te dhenat e meposhteme:

- Prodhesi dhe marka tregtare e prodhuesit
- Dimensioni nominal fllanxhes
- Dimensioni nominal spigotes
- Presioni nominal
- Data e prodhimit
- Matrikulli i makines prodhuese

4.11.17 Kerkesat Cilesore per Cafore me Fllanxh

Caforja duhet te jete e pershtatshme per tu instaluar ne tubat PE apo PVC . Ne brendesi te saj duhet te jete e veshur me shtrese elastomeri per te mos demtuar tubat gjate procesit te instalimit.

Caforet duhet te kene dalje vertikale me sistemi konjeksioni fllanxhe te vrimezuar.

4.11.18 Kerkesat e Sigurise per Cafore me Fllanxh

Fllanxh e Cafore duhet te jete e projektuar dhe prodhuar sipas standardit EN 1092-2.

4.11.18 Kerkesat e Markimit per Cafore me Fllanxh

Caforet me Fllanxh duhet te jene te markuara ,ku te jene te lexueshme dukshem te dhenat e meposhteme:

- Prodhuesi dhe marka tregtare e prodhuesit
- Dimensioni nominal fllanxhes
- Dimensioni nominal i hapsires se instalimit te tubit
- Presioni nominal
- Data e prodhimit
- Matrikulli i makines prodhuese

4.12 PJESET LIDHESE

4.12.1 PJESE LIDHESE PREJ GIZE

Pjeset lidhese prej gize do te jene sipas ISO 2531, EN 545, EN 598 ose ekuivalent me bashkues te ankorueshem dhe me bulona.

- Presioni i lejuar i punes 16/20 bar sipas kerkesave te projektit
- Rondele gome EPDM
- Defleksioni kendor i lejuar i bashkimit: 4°

Te dhenat e gizes jane:

- Zgjatimi ne thyerje: 10%
- Moduli i elasticitetit: 1.7 x 10000000000 kg/m2
- Sforcimet Tangenciale: ≥ 420 MPa

Veshja: Brenda dhe jashte: veshje puder 250 μ m me veshje rezine blue epoxy sipas DIN EN 14901,

Ne perputhje me rregullat Europiane te ujit te pijshem per te gjitha materialet ne kontakt me ujin duhet te nje certificate nga nje autoritet i aprovuar i pavarur.

Kerkesat e testit:

- Test i presionit: 1.5 x presioni i lejuar i punës, , por jo më pak se 10 bar
- Koha e testit: 12 ore

Standardet:

- Metodet e testeve dhe kerkesat EN 545-2002, ISO 2531
- Linjat e llac cimentos sipas EN 545-2002, ISO 4179
- Rondelet sipas EN 681-1, ISO 4633

Perputhjet nevojiten te jene te certifikuara nga nje autoritet i pavarur i aprovuar.

4.12.2 PJESE LIDHESE TE GIZES SFEROIDALE

Pjeset lidhese te gizes sferodiale (DCI) do te jene sipas EN 545, fllanxhat sipas EN 1092-2 (DIN 2805), standardet e cpimi sipas DIN 2501, perfshi bulonat, dadot, rondelete , etj.

Lidhjet me Fllanxhat perfshijne:

- Dadot sipas DIN EN ISO 4034
- Bulonat sipas DIN EN ISO 4016
- Rondelet sipas DIN EN ISO 7091

4.12.3 VALVOL PORTE E INTEGRUAR PER LIDHJE ME TUBAT PE

Pjeset tip Ti me valvole porte do te jete me fundet me gota te shtrengueshme (sipas DIN 8076-1/-3) per tuba PE 100 dhe PVC (DIN 8074/8075, DIN 8061/8062), me unaze kycese per bashkues shtrengues me strukture speciale, vulosje me lubrifikim permanent, te gjitha vidat dhe dadot prej celiku inoksi, vidat te mbrojtura me mbulesa plastike.

Materiali: GGG40, mbrojtje e cilesise se larte ndaj korrozionit me veshje puder te fluidizuar Brenda dhe jasht sipas DIN 3476 (P) and DIN 30677-2 (trashesi e veshjes >250 µm, zero-porosity ne 3000 V, adesioni brenda dhe jasht >12 N/mm² pas ekspozimit te ujit te nxehte).

Unaza kycese: Ms 58 or RG 7.

Vidat dhe dadot: celik inoksi (cilesia A2)

Perdorimi: per uje te pijshem

Presioni Max. i punes: 16 bar

4.12.4 RAKORDERITË PE100 DHE PREJ ÇELIKU

Rakorderitë PE100 do të jenë me bashkim tip kokë më kokë (butt fusion) ose me elektroda për ngrohje-shkrirje të materialit PE (electrofusion). Presioni maksimal i punës: 16 bar

- Perdorimi: Uje i pijshem

Rakorderitë per tuba celiku do te jene ST3 sipas EN 10204. Brrylat do te jene me funde te sheshte per saldim sipas EN 10253 ose ekuivalent

4.12.5 BASHKUES E-MULTI-JOINT

Bashkuesi E-Multi-joint apo pershtatesit e me flanaxhe te jene shkalle te ndryshme, flanaxha te cpuara sipas DIN 2501, bashkues qe perputhet me ISO 9002, i mbrojtur me puder epoxy ose rilsan najlon 11 te mbrojtur, PN 16/25, DCI, perfshi vida dhe dado plotesisht te mbrojtura nga korrozioni dhe rondele e vida te pershtatshme per tuba jo te standartizuara te cdo materiali.

4.12.6 FLLANXHE ADAPTOR PER TUBAT PE

Fllanxhe Adaptor do te jene me shtrengim dhe vulosje per tubat PE dhe flanaxha sipas DIN 2501. Soket i shtrengueshem per tuba PE dhe PVC (DIN 8074/8075, DIN 8061/8062), unaze grip per lidhje shtrenguese te Ms 58 or RG 7 me dhembe special, vulosje paralubrifikuese, te gjitha vidat e dadot me celik inoksi (material A2), vida te mbrojtura nga kapuc plastik, sipas DIN 8076-1/-3.

Materiali: GGG40, mbrojtje e cilesise se larte ndaj korrozionit me veshje puder te fluidizuar brenda dhe jashte sipas DIN 3476 (P) and DIN 30677-2 (trashesi e veshjes >250 µm, zero-porozitet ne 3000 V, adesioni brenda dhe jasht >12 N/mm² pas ekspozimit te ujit te nxehte).

- Perdorimi: Uje i pijshem
- Presioni Max. i punes: 16 bar

4.12.7 FLLANXHE ADAPTOR PER TUBAT DCI DHE TUBA CELIKU

Fllanxhe Adaptor do te jene me shtrengim dhe vulosje te tubave, (flanaxha DCI) per tubat DCI sipas DIN 28600, dimensionet e flanaxhave dhe vrimave sipas EN 1092-2 PN 10 (DIN 28605 / DIN 2501), unaza e presionit te hekurit EN-GJL-250 sipas EN 1561 (GG 250-DIN 1691), trashesia e veshjes: min 250µm, zero porosity: min 3000 V Spark test, adezion: min 12 N/mm²; vulosje e tubit nga rondele

EPDM, rondoje flat EPDM integruar ne unaze presioni, unaze grip me dhembje me special celiku 1.0037, perfshi dado, vida, rondoje (EPDM). Pershtates me fillanxhe per tuba celiku sipas EN 1092.

4.12.8 SHPINDEL, ZGJATUES TELESKOPIK

Aksi zgjatues Teleskopik vertikal do te jete per instalime te valvolave tip porte, te instaluara nentoke pa puseta. Aksi zgjatues per zgjatim teleskopik deri tek thellesia e tubave, ka kambana mbrojtese plastike (shih udhezuesit e prodhuesit) tub rreshqites PE, me pajisje ndaluese kunder pjeses shtytese, katror te galvanizuar me koke shpindeli GGG 40, telescopuar ne tub katror me njesi operuese GGG 40, lartesi e pershtatshme, DN 80 - DN 200: me kapak rrethor per fiksime te boneteve te valvolave.

4.12.9 KUTI SIPERFAQESORE PREJ GIZE ME KAPAK PER VALVOLAT PORTE ME AKS TELESKOPIK VERTIKAL

Kutia siperfaqesore do te jete per valvolat porte me kapak (sipas DIN 4056).

- Kutia sipas DIN 4056 me kapak me vend pa kend.
- Materiali: GG 25, trup i bituminizuar , kapaku i veshur me puder epoxy.
- Aksesore: unaze zgjatuese H = 10, 20, 30 ose 50 mm.
- Kutia siperfaqesore komplet

4.12.10 KUTI SIPERFAQESORE PER AJRUESIT PA PUSETE

Kutia do te jete per Ajruesit

- Materiali: GG 25, e izoluar me katrama, diameter i brendshem: 300 mm,
- Aksesoret: bazament
- Shkrimi mbi kapak: Ajrues

4.12.11 BAZAMENT BETONI PER KUTITE E VALVOLAVE PORTE

- Bazament i betonit per kutite siperfaqesore per valvolat porte sipas DIN 4056
- Bazament i pershtatshem per kutite e valvolave porte sipas DIN 4056 me pajisje kycesore per akszgjatues teleskopik
- Materiali: Beton

4.12.12 BAZAMENT BETONI PER VALVOLAT E MOSKTHIMIT DHE POMPAT CENTRIFUGALE

- Bazament betoni per valvola moskthimi dhe pompat centrifugale

5. PUSETE INDIVIDUALE

5.1 Saracineske me sferë

Kjo lloj saracineske ka per funksion te bllokoje furnizimin me uje ne linjen e tubacioneve te abonenteve/konsumatoreve te cilet kane detyrime ndaj shoqerise UKD. Artikulli duhet te jete i perbere nga trupi i saracineskes, topi dhe nga kapuci magnetic. Mekanizmi i cili kryen funksionin e

hapjes apo mbylljes duhet te jete i inkorporuar ndermjet aksit te saracineskes dhe kapucit magnetic. Konstruktivisht trupi saracineskes duhet te jete i perbere prej materiali bronzi dhe i pershtatshem te perballoje presione deri ne PN 10.

Dimensionet e saracineskes me celes magnetik:

- Permasa 1/2"
- Gjatesia lineare nepermjet siperfaqeve te filetimit 50mm-60 mm
- Lartesia e kapucit magnetik jo me teper se 46 mm

5.2 Saracineske me sferë

Saracineska flutur duhet te jete e perbere prej materiali inoksi e tipit me top. Saracineska duhet te jete e pershtatshme per presion nominal PN 10 dhe temperaturave -10°C deri ne + 50 °C

- Permasa e filetimit duhet te jete ¾" F
- Permasa e filetimit duhet te jete 1 ½" F
- Permasa e filetimit duhet te jete 2 " F
- Permasa e filetimit duhet te jete 2 ½" F

5.3 Kundra valvul flutur

Kondra valvula duhet te jete e perbere prej materiali bronzi e duhet te jete e tipit me pallot.

Kondra valvula duhet te jete e pershtatshme per te rezistuar presionit nominal PN 10 dhe temperaturave -10°C deri ne + 50 °C

- Permasa e filetimit duhet te 3/4" F

5.4 Nipples

Nipples duhet te jene te perbere prej materiali metalik zingato dhe te pershtatshem per presion nominal PN 10. Permasat duhet te jene sipas preventivit

5.5 Adaptor, Fashete, Rakorderi PE EF

Adaptor, Fashete, Rakorderi, Brryl PE EF duhet te jene te perbera prej materiali PE cilesor dhe ne perputhje me Udherzimet e Standardet Nderkombetare e Europiane :

- Adaptor, Fashete, Rakorderi, Brryl PE EF duhet jete i perbere prej materiali cilesor (PE 80 orse PE 100) I prodhuar sipas standardit EN 12001.
 - Adaptor Fashete, Rakorderi, Brryl PE EF duhet te kene te shenuar ne trup kerkesat teknike nominal jo me teper se 48V.
 - Adaptor, Fashete, Rakorderi, Brryl PE EF duhet te kene rezistence ndaj presionit nominal PN 10.
 - Adaptor, Fashete, Rakorderi , Brryl PE EF duhet te jete i pershtatshem per aplikime ne sistemet e ujit te pijshem , per te vertetuar kte duhet te paraqitet certifikata perkatese (psh DVGW).
- Permasat duhet te jene sipas preventivit.

5.6 Rakorderi flanaxhë për tub HDPE me filet

Rakorderi flanhë për tub HDPE me filet do perfishihen te gjitha materialet e perdorura per lidhjen me tubacionin ekzistues.

Rakorderi flanhë për tub HDPE me filet duhet te jene te perbera prej materiali PE cilesor dhe ne perputhje me Udherzimet e Standardet Nderkombetare e Europiane EN 12001, presion nominal PN 10-25,

6. MATES PRURJESH

6.1 MATESA FAMILJARE

Matesat familjare do te jene me trup metalik dhe duhet te projektohen ne perputhje me klimen e Europes. Matesat duhet te kene nje dizenjim modular, me nje kuti te jashtme dhe nje hapesire e brendshme per matje te vecante. Dhoma e matjes duhet te jete e levizshme ne menyre qe te nderrohet me lehtesi pa patur nevojte qe te cmontohet trupi i matesit.

Regjistrimi i prurjes do te behet me lexim te drejtperdrejte ne metra kub, me shigjeta te vecanta qe tregojne matjet ne te vlerat me te uleta. Shigjetat duhet te levizin ne drejtimin e akrepave te ores. Per nje rregullim te lehte dhe te sakte te kalibrimit, shifrat duhet te rregjistrojne aq sa per te lejuar lexim te sakte te 0.5% te vellimit nominal qe kalon. Te gjithte matesat e ujit duhet te jene te pajisur me nje kapak i cili duhet te jete i mbuluar dhe te mbuloje dhe pjesen e kutise se rregjistrimit ne menyre qe te mbroje lentet. Te gjithte matesat e ujit duhet te pajisen me tel dhe vula prej plumbi per qellimin e vulosjes se matesave.

Te gjitha pjeset qe jane ne kontakt me ujin duhet te kene siperfaqe te lemuara te mbrojtura ne menyre qe te evitojne depozitimet e mikrobeve. Matesat e ujit duhet te projektohen per nje jetegjatesi prej 10 vjetesh ne kushte normale funksionimi. Te gjitha matesat e ujit duhet te jene te miratuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Metereologjise te Shqiperise ose nga persona juridike te cilet jane autorizuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Metereologjise te Shqiperise sipas miratimit te MID (Direktiva e Bashkimit European per pajisjet matese) dhe ligjit Nr. 9875 me date 14.02.2008 perpara se te instalohen.

Matesat e ujit Familjare

Matesat e ujit familjar, DN½" deri ne DN 2" duhet te permbushin kerkesat dhe kushtet qe vijojne:

Kerkesa Teknike:

- Pjesa e bronzte e matesit te ujit duhet te jete ne perputhje me direktivat e ujit te pijshem 98/83/EC dhe 98/83/EG, norma origjinale e vertetuar nga Certifikata.
- Matesit e ujit DN 1" dhe DN 2" duhet te pershtaten per lexim ne distance (pulsimi duhet te korrespondoje me nje sasi prej 0,1 m³).

Shenime; Ne cdo mates uji duhet te jene te shenuara ne siperfaqen e jashtme ose ne xhamin e ekranit informacionet si me poshte:

- (i) Te pakten nje shigjete ne per te treguar drejtimin e rrjedhjes
- (ii) Masa nominale
- (iii) Shkalla nominale e rrjedhes (Q)
- (iv) Identifikimi i modelit
- (v) Viti i prodhimit
- (vi) Numri serial
- (vii) Numri i miratimit
- (viii) Emri i Prodhesit

Ne rast se nuk tregohet ndryshe, duhet te shenohet te trupi i matesit ose te gdhendet mbi kapak ose te jete e shenuar ne pjesen e brendshme ose perndryshe te shenohet ne nje vend te pershtatshem.

Paketimi

Cdo mates uji duhet te paktohet ne nje kuti prej letre te valezuar me dy fije. Cdo kuti leter e valezuar do te permbaje sikurse tipi i matesit te ujit, vlerat e Qn, gjatesine, temperaturen dhe presionin. Kutite e matesave duhet te montohen ne paleta dhe te ruhen nga shiu dhe lageshtia.

Garancia e Fabrikes

Furnizuesi duhet te siguroje nje garanci prej 3 vitesh per cdo difekt te prodhimit. Cdo mates qe nuk punon gjate periudhes se garancise do te zevendesohet ose te riparohet pa asnje pagese. Furnizuesi duhet te siguroje nje garanci prej 15 vitesh per te gjitha pjese e kembimit te matesave. Per me teper, ne fillim te cdo viti, furnizuesi duhet ti japi Punedhenesit nje liste cmimesh per vitin respektiv. Furnizimi dhe dorezimi i matesave te ujit me fushe te thate (tipi multi-jet dry type dial) do te perdoret si mates per shtepite qe kane mundesi per tu integruar ne Sistemin-AMR, te pergatitur per lexim ne distance.

Standarte:

Matesat duhet te jene ne perputhje me standartin EN14154 (perkatesisht ISO 4064), OIML R 49 botuar ne 2006 E. Prodhuesi duhet te jete i certifikuar sipas ISO 9001:2008 seria ose sipas nje certifikimi ekuivalent. Te gjitha matesat e ujit duhet te kene miratimin MID ose deklaraten e pershtatjes dhe Prodhimi dhe Materiali duhet te jene prodhuara ne vendet e EU-se.

Kerkesat teknike:

- Xham special me mundesine per montimin direkt pa kabell te pajisjes se leximit – preferoren pa shume fileto.
- Pajisja e leximit me shifrat qe rrotullohen and minimumi 3 ose 4 shifra te jene te lexueshme pasi te montohet pajisja e leximit ne distance.
- Te dhena Dinamike Metrologjike (Q3/Q1) R 80 (Klasa B) per Q 2.5 dhe 4.0m³/h (te jene te vertetuara me certifikate)
- Montime horizontale dhe vertikale, kerkohet pozicioni!
- Shifrat treguese: 5-numra, 4 shigjeta, 1 tregues i rrjedhjes
- Kutit te jete prej bronzi te presuar per nje performance sa me te mire hidraulike, ne perputhje me direktivat per ujin e pijshem 98/83/EC dhe me rregulloren 98/83/EG; vida rregulluese per kalibrim ne pjesen e siperm te kutise se brendshme
- Kapaku mbrojtës prej plastike speciale
- Valvul mos kthimi: te jete e instaluar ne pjesen e brendshme dhe pa prishur vulen
- Filtri i instaluar ne hyrje, duhet te hiqet me lehtesi pa cmontuar matesin dhe pa prishur vulen

6.2 MATES ELEKTROMAGNETIK DN 100/400

Matesi elektromagnetik i prurjeve te Ujit do te jete:

- Mates elektromagnetik DN 100/400, Split version
- Presioni i Operimit: PN 16-40
- $Q_{max} = 200 \div 220 \text{ m}^3/\text{h}$
- Siguria e matjes $\pm 0.15 \%$ i vleres se matur
- Dalja e pare analoge 0 - 21 mA.

- Opsion i Programueshem per celes te nje shkalle matje automatike
- Opsion për dalje analoge te dytë
- Dalje pulsesh per matje te dyfishte, perpara dhe kthim pas nga 0 - 800 Hz.
- Celes Transistor per anoncim te dopio alarm
- Celesa me perdorim te Programuar dhe nje RS 232
- Elektroda matje dhe tokezimi me celik inoksi
- Linja tubi matese EPDM, te pershtatshme per uje t epijshe
- Ekran LCD me tastier Vetmonitorues, diagnostifikues i gabimeve, program matjesh, rezultate matjesh (shkalla e prurjes, volume total, etj)
- 2 dalje pulsesh dhe 2 alarme
- Dalje 1 mA
- Sensor Matje te mbrojtur sipas IP 68
- Kabell lidhes ndermjet sensorit te matjeve, L=30 m
- Bateri me AC dhe back up
- Operimi i baterise: Dy bateri 3.6 V (Lithium), 2.5 vit jetegjatesi

6.3 SPECIFIKIMET TEKNIKE MATES INDUKTIV

6.3.1 Kerkesat e Pergjithshme te Artikullit

Matesi duhet te jete i tipit induktiv , ku te kryhet matja e prurjes me ane te parimit te Faradeit (induksioni magnetik) , i cili krijohet nga nderveprimi i ujit ne rrymen e cila kalon ndermjet bobines se dhenesit te sinjalit . $U = v \cdot k \cdot B \cdot D$

v =shpejtesia e mesatare e fluidit

k =koeficienti i formes gjeometrike

B =induksioni magnetik

D =diametri i brendshem

Tensioni i krijuar induktohet ne elektroda dhe me pas percillet ne sinjalizues ku vlerat e tyre perkatese jane propocionale me shpejtesine mesatare te rrjedhjes “v” dhe me volumen e prurjes “q”. Matesi duhet te jete i pajisur me ekran digjital ku te lexohen te dhenat e kryera nga matja ne varesi te kohes, gjithashtu matesi duhet te jete i pershtatshem qe ne prodhim per tu instaluar me konjeksion me fllanxha.

6.3.2 Kerkesat Cilesore per Mates Induktiv

Furnizmi me energji :	230 VAC, 50 Hz, 24 VAC/VDC
Fuqia ne hyrje :	4.6 VA
Materiali elektrodave:	Titan, CrNi celik , Tantalum
Materiali sensoreve:	Celik inoks dhe celik struktural me veshje poliuretani
Konjeksioni:	me fllanxha sipas EN 1092
Konduktiviteti minimal i matjes:	20 μ S/cm
Diapazoni i matjes:	dy-drejtimesh
Gabimi i lejuar:	jo me shume se 0.5%
Ekрани:	LCD , minumumi me 16 karaktere
Kontrolli:	minumi 2 butona te jashtem dhe 3 butona te brendshem per ndryshim parametrash
Sinjalet dales:	4-20 mA, komunikim RS485, M-Bus
Temperatura maksimale operative:	55°C
Shkalla e mbrojtjes:	IP68

6.3.3 Kerkesat e Sigurise per Mates Induktiv

Fllanxhat projektuar dhe prodhuar sipas EN 1092 dhe shkalle mbrojtje IP68.

Matesi induktiv duhet te jete prodhuar sipas Standardit per Sigurine e Paisjeve ne Tension te Ulet EN 61010-1:2000 dhe Standardit per Paisjet Elektrike Matese EN 61326-1:2006.

Matesi induktiv duhet te jete i pershtatshem per tu instaluar ne sistemet e ujit te pijshem dhe duhet te jete i testuar sipas Direktives se Instrumentave Mates, 2014/32/EU

Per te vertetuar perputhshmerine e kerkesave te mesiperme ,duhet te paraqitet Dokumentacioni Aprovues perkates i leshuar nga nje Institucion Kombetar ose Nderkombetar i Specializuar,i cili verteton produkti i ofertuar permbush te gjitha kerkesat cilesore te siperkerkuara.

6.3.4 Kerkesat e Markimit per Mates Induktiv

Matesi induktiv duhet te jete i markuar , ku te jene te lexueshme dukshem te dhenat e meposhteme:

- Prodhuesi dhe marka e tregtare e prodhuesit
- Permase nominale
- Presioni nominal
- Vlerat e furnizimit me energji
- Simbolet e aprovimit sipas 2014/32/EU
- Viti prodhimit

6.4 Instrumentet Matëse Elektromagnetike.

Detajet e shpejta

Emri i produktit: Instrumentet matëse të rrjedhjes flanged metër elektromagnetike rrjedhin uji

Materiale Liner: FEP, NE, PU, PTFE, PFA

Temperatura e mesme: -40 ~ 180 °C

Presioni: 0.6, 1.0, 1.6, 2.5, 4.0, 5.0, 6.4 MPa (ose specifikuar nga konsumatori)

Niveli i mbrojtjes: IP65, IP67, IP68

Fuqia e punës: 220VAC, 100V ~ 240VAC, 24VDC (0.5A)

Output aktual: 4 ~ 20mA

Komunikimi: RS485 (Modbus-RTU Modbus-Ascii) Hart

Struktura: Lloji i integruar, Lloji i ndarjes

Diametri: DN3 ~ DN2000

Lloji i rrjedhës së rrjedhës së matjes elektromagnetike përbëhet nga konvertuesi i EMF85 dhe sensori i llojit të fllanxhës.

Sensori i tipit fllanxhë përdor mënyrën e lidhjes së fllanxhës me tubacion, Ka lloje të ndryshme të materialit të elektrodës dhe materialit të rreshtimit.

Sensori dhe konvertuesi mund të kombinohen në matës elektromagnetik të integruar ose ndarë.

Metoda e rrjedhës së rrjedhës elektromagnetike mund të përdoret gjerësisht jo vetëm në procesin e procesit gjenaral, por edhe në industrinë kimike, furnizimin me ujë, pulpë ore të monitorimit të ujërave të ndotura ose plum etj.

- Parametrat teknik

ekran	3-line LCD anglisht ekran, tregojnë drejtpërdrejt të dhënat e rrjedhës përpara dhe të kundërt, përqindja e rrjedhjes dhe shpejtësinë e rrjedhës.
Parametër mjedis	Vendosja e parametrit me botton
Gjuhe	Anglisht, etj...
Prodhimi aktual	4-20mA, Rezistenca e ngarkesës ≤ 500Ω (mund të zgjedhë me protokollin HART)
PIO	CCan zgjidhni dalje pasive impuls, dalje aktive impuls, dalje shtetërore / output alarmi.
	Dalja impulsive pasive 30VDC (Off), 200mA (Ndezur); 0.0001 ~ 5000HZ; Gjerësia Puls: Cikli i detyrës 50% ose vlera fikse (≤100ms)

	Output aktiv pulsi 0.0001 ~ 2HZ, ≤150mA, 15VDC ± 20%; Gjerësia Puls: ≤100ms (Vlera e parazgjedhur: 20ms)
	Shteti / Outputi i Alarmit Kapaciteti i kontaktit: 30VDC (Off), 20mA (Ndezur) mund të zgjedhë dalje rele
komunikim	RS485 (MODBUS-RTU, MODBUS-ASC II)
Furnizim me energji elektrike	220VAC, 24VDC, 100-240VAC
alarm	Alarm i zbrazët i tubave, alarmi i kundërt, kufiri i sipërm dhe alarmi i kufirit të poshtëm.
Niveli i nxitjes	IP67
saktësi	0.5, 0.3
strukturë	Lloji i integruar, tipi Split

- Të dhëna teknike të sensorit të tipit fllanxhë

Aplikacion	Të gjitha lëngjet përçueshëm, duke përfshirë ujë, pije, media të ndryshme gërryese dhe lëngje të ngurta lëngu dyfazor (baltë, pulpë letre).
diametër	DN3 ~ DN2000
presion	0.6 ~ 4.0MPa (Varet nga diametër të ndryshme, fletë reference 1, presion të veçantë mund të personalizohet)
Materiale Elektrike	SS316L, HC, Hb, Ti, AT, W, Pt
Materiali i rreshtimit	Ne, PTFE, PU, FEP, PFA
temperaturë	-40 ~ 180 °C (Shënim: i kufizuar nga rezistenca e temperaturës së materialit të veshjes, fleta referuese 7)
Materiale Shell	Çeliku i karbonit (Stainless steel mund të personalizohet)
Niveli i Mbrojtjes	IP65, IP67, IP68
Lidhje	GB / T9119-2010 (Mund të lidhet direkt me fllanxhin HG20593-2009), JIS, ANSI ose të përshtatur.

- Performanca kryesore e materialeve të elektrodës

material	kod	Performanca e Rezistencës ndaj Korrozionit
316L	V	Përdoret në ujë industrial, ujë të brendshëm, ujërave të zeza, zgjidhje neutrale dhe acid të dobët të tilla si acid karbonik dhe acid acetik.
Hastelloy Alloy C	Hc	Acid me rezistencë oksidimi, të tilla si acidi nitrik, acid i përzier, acid kompleks i përzier me acid sulfurik. Ka një rezistencë korrozioni të mirë ndaj ujit të detit, solucionit alkali dhe tretësirës së klorurit. Rasti i pazbatueshëm: acid hidroklorik dhe acid hidrofluorik.
Hastelloy Alloy C	HB	Ka rezistencë të mirë korrozioni ndaj acidit jo-oksidativ, alkali, kripë. Rasti i pazbatueshëm: acid nitrik.
Ti	Ti	Kanë rezistencë të mirë korrozioni ndaj ujit të detit, kloridit, hipokloritit dhe hidroksideve të ndryshme. Rasti i pazbatueshëm: Reduktimi i acideve si acid klorhidrik, acid sulfurik, acid hidroklorik.
falemnderit	falemnderit	Pothuajse kanë rezistencën korrozioni ndaj të gjitha medikave kimike, të përdorura përgjithësisht për acid klorhidrik dhe acid sulfurik. Rasti i pazbatueshëm: acid hidroklorik, alkali dhe acid fumarant sulfurik.
Karabit tungsten	W	Kanë rezistencë të mirë veshin, përdoret për media të veshura si baltë dhe tul letër, por me rezistencë të dobët korrozioni.
Platinum-iridium Aloy	pt	Përveç acidit aqua dhe kripës së amonit, pothuajse kanë rezistencë korrozioni ndaj të gjitha acideve, alkalit dhe kripës.

7. PUNIME BETONI

Puna e mbuluar nga ky seksion i specifikimeve konsiston ne furnizimin e gjithë kantierit, punen, pajisjet, veglat dhe materialet, dhe kryerjen e të gjitha punimeve, ne lidhje me hedhjen, kujdesin, perfundimin e punes se betonit dhe hekurin e armimit ne perputhje rigoroze me kete kapitull te specifikimeve dhe projekt zbatimin.

Ne fillim te Kontrates Sipermarresi duhet te paraqese per miratim tek Mbikqyresi i Punimeve nje njoftim per metodat duke detajuar, ne lidhje me kërkesat e ketyre Specifikimeve, propozimet e tij per organizimin e aktiviteteve te betonimit ne shesh (teren). Njoftimi i metodave do te perfshije ceshtjet e meposhtme:

1. Njesia e prodhimit e propozuar
2. Vendosja dhe shtrirja e paisjeve te prodhimit te betonit
3. Metodat e propozuara per organizimin e paisjeve te prodhimit te betonit
4. Procedurat e kontrollit te cilesise se betonit dhe materialeve te betonit
5. Transporti dhe hedhja e betonit
6. Detaje te punes se berjes se kallepeve duke perfshire kohen e heqjes se kallepeve dhe procedurat per mbeshtetjen e perkohshme te trareve dhe te soletave.

7.1 CILESIA E BETONIT

Sipermarresi do te punesoje inxhinier te kualifikuar, te specializuar dhe me eksperience, i cili do te jete pergjegjes per kontrollin e cilesise te te gjithë betonit. Materialet dhe mjeshteria e perdorur ne punimet e betonit duhet te jete e nje cilesie sa me te larte qe te jete e mundur, prandaj vetem personel me eksperience dhe aftesi te plote ne kete kategori punimesh do te punohesohet per punen qe perfshin ky seksion specifikimesh.

DIN1045 do te jete baza e te gjitha puneve te betonit .

Betonet per pusetat betonarme do te jene C 25/30.

Betonet per mbeshteteset betonarme te tubave dhe blloqet e betonit do te jene C 20/25.

Nenshtrese pune e betonit do te jete C 12/15.

Perzierja e Betonit do te jete sipas tabelës se meposhtme:

Rezistenca e ngjeshjes karakteristike (N/mm ²) (28 dite)	35
Shkalla maksimale ujë/çimento	0.55
Permbajtja minimale e cimentos (kg/m ³)	350
Madhësia maksimale e inerteve (mm)	32

Pervec rasteve te aprovuara, do te perdoret cemento blast furnace CEM III/B DIN 1164 e cila do jete sipas standarteve Kombetare dhe do te kete koncentrim max. te C3A (Tricalciumaluminat) 3%.

Per shkak te ngarkesave te vecanta, betoni duhet te jete i papershkueshem nga uji (thellesia e penetrimit: ≤ 5 cm), resistent ndaj korrodimeve kimike sipas DIN 4030 dhe me rezistence te larte ndaj ngricave.

Temperatura e perzierjes se betonit nuk duhet te jete jo me pak se +5 C dhe jo me shume se +30 C.

Kontrolli i cilesise dhe analiza e lageshtise se kerkuar dhe treguesve te betonit te forcuar do te zbatohen sipas DIN 1045. Testet do te behen sipas DIN 1048 Part 1 dhe 5.

Perpara se te jete kryer ndonje proces i pergatitjes se betonit, zona brenda armaturave (ose siperfaqe te tjera sipas zbatimit) duhet te jete pastruar shume mire me uje ose me ajer te komprimuar. Cfaredo qe ka te beje me kete proces duhet te pergatitet sic eshte specifikuar.

Asnje proces betonimi nuk duhet te kryhet derisa Mbikqyesi i Punimeve te kete inspektuar dhe aprovuar (ne se eshte e mundur) germimin, masat e marra per mbrojtjen nga kushtet atmosferike, masat per shperndarjen e ujit per freskim dhe stazhionim, armaturat, ndalimin e ujit, fugat ndertimore dhe fiksimin e fundeve dhe masa te tjera, armimin dhe ceshtje te tjera qe duhet te fiksohen, si dhe te gjitha materialet e tjera per betonimin dhe masa te tjera ne pergjithesi. Sipermarresi duhet t'i jape Mbikqyresit te Punimeve njoftime te arsyeshme per te bere te mundur qe ky inspektim te kryhet.

7.2 MATERIALET

Çimento

- a. Çimento Portland e Zakonshme do te perdoret me BS 12 ose ASTM C-150 Tipi II-te ose Tipi V-te. Kjo do te perdoret aty ku betoni nuk eshte ne kontakt me ujera te zeza, tub gazi ose ujerat nentokesore.
- b. Çimento Portland Sulfate e Rezistueshme do te perdoret me BS 4027. Kjo do te perdoret per strukturat e betoneve duke perfshire pusetat dhe te gjitha perkatesite e tjera ne kontakt me ujerat e zeza, tubin e gazit ose ujerat nentokesore.

Çimento duhet te shperndahet ne paketa origjinale te shenuara te pa demtuara direkt nga fabrika dhe duhet te ruhet ne nje depo, dyshemeja e te cilit duhet te jete e ngritur te pakten 150mm nga toka. Nje sasi e mjaftueshme duhet mbajtur rezerve per te siguruar nje furnizim te vazhdueshem ne pune, ne menyre qe te sigurohet qe dergesat e ndryshme jane perdorur ne ate menyre sic jane shperndare. Çimentoja nuk duhet ruajtur ne kantier per me shume se tre muaj pa lejen e Mbikqyresit te Punimeve. Çdo lloj tjeter cimento, pervec asaj qe eshte e parashikuar per perdorimin ne pune nuk duhet ruajtur ne depo te tilla. E gjithë cimentoja duhet mbajtur e ajrosur mire dhe cdo lloj cimento, e cila ka filluar te ngurtesohet, ose ndryshe e demtuar apo e keqesuar nuk duhet te perdoret. Fletet e analizave te fabrikave duhet te shoqerohje cdo dergese duke vertetuar qe cimentoja, e cila shperndahet ne shesh ka qene e testuar dhe i ka plotesuar kerkesat e permendura me lart. Me te mberitur, certifikatat e provave te tilla duhen ti kalohen per t'i aprovuar Mbikqyresit te Punimeve. Çimentoja e perfituar nga pastrimi i thaseve te çimentos ose nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret. Kur udhezohet nga Mbikqyesi i Punimeve, çimento e dyshimte duhet te riestohet per humbjen e fortesise ne ngjeshje.

Inertet

Te pergjithshme

Me perjashtim te asaj qe eshte modifikuar ketu, inertet (te imta dhe te trasha) per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose ne perputhje me ASTM C 33 "Inertet e betonit nga burime natyrale". Ato duhet te jene te forte dhe te qendrueshem dhe nuk duhet te permbajne materiale te demshme qe veprojne kunder fortesise ose qendrueshmerise se betonit ose, ne rast te betonarmese mund te shkaterroje kete perforcim.

Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohen nga burimet te njohura per te arritur rezultate te kenaqshme per klase te ndryshme te betonit. Nuk do te lejohet perdorimi i inerteve nga burime, te cilat nuk jane te aprovuara nga Mbikqyesi i Punimeve.

Inertët e imta

Inertët e imta për kategoritë e betonit A, B dhe C (respektivisht M100, M200, M250) konform STASH 512-78, do të jenë prej rere natyrale, gure të shoshitur, ose materiale të tjera inerte me të njëjtat karakteristika apo kombinim të tyre. E gjitha kjo duhet të jetë pastruar shumë mire, pa masë të mpiksura, cila të buta e të vecanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, argjile dhe sasi të substancave të demtuese.

Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave të tjera demtuese është 5%. Materialet e marra nga gure të papershtashem për inerte të trasha nuk duhet të përdoren si inerte të imta. Inertët e imta të marra nga guret e shoshitur duhet të jenë të mprehte, kubike, të forta, të dendur dhe të durueshem dhe duhet të grumbullohen në një platformë për të patur një mbrojtje të mjaftueshme nga pluhurat dhe perzierjet e tjera.

Shkalla e shpërndarjes për inertët e imta të specifikuar si më lart, duhet të jenë brenda kufijve të mëposhtem, të përcaktuara nga Mbikqyresia e Punimeve.

Masa e Sites	Përqindja që kalon (peshe e thate)
10.00mm	100
5.00mm	89 në 100
2.36mm	60 në 100
1.18mm	30 në 100
0.60mm (600 µm)	15 në 100
0.30mm (300 µm)	5 në 70
0.15mm (150 µm)	0 në 15

Inertët e imta për kategorinë D të betonit duhet të jenë të një cilësie të mirë nga rera e brigjeve. Ajo duhet të jetë pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga më e holla deri tek më e trasha, pa copeza, nga argjila, zgjyra, hirera, plehra dhe cila të tjera. Nuk duhet të përmbajë më shumë se 10% të materialit më të hollë se 0.10mm (100µm) të hapësirës në rrjete, jo më shumë se 5% të pjesës së mbetur në 2.36mm site; i gjithë materiali duhet të kalojë nëpër një rrjetë 10mm.

Inertët e trasha

Inertët e trasha për kategoritë e betonit A, B dhe C do të përbehen nga materiale guri të thyer apo të nxjere ose një kombinim i tyre, me një masë jo më shumë se 20 mm, dhe do të jenë të pastër, të forta, të qëndrueshem, kubik dhe të formuar mire, pa lende të buta apo të thermueshme, ose copeza të holla të stergjatura, alkale, lende organike ose masë apo substancë të tjera të demshme. Lendet demtuese në inerte nuk duhet të kalojnë më shumë se 3 %. Klasifikimi për inertët e trasha të specifikuar sa më sipër duhet të jetë brenda kufijve të mëposhtem:

Masa e sites	Përqindja e kalimit (në peshe të thate)
50.0 mm	100
37.5 mm	90 në 100
20.0 mm	35 në 70
10.0 mm	10 në 40
5.0 mm	0 në 5

Inertët e trasha për kategorinë D të betonit duhet të jenë tulla të thyera të prodhuara prej tullave të cilësise së parë ose grumbulli i tyre, ose nga tulla të mbipjekura. Nuk do të thyhen për përdorim për inerte të imta as tullat e papjekura apo grumbulli i tyre dhe as ato që janë bërë porose gjatë procesit të pjekjes. Agregati me tulla të thyera nuk duhet të përmbajë gjethe, kashte dhe, rere ose materiale të tjera të huaja dhe ose mbeturina të tjera. Inertët prej tullave të thyera duhet të jenë të një diametri 25-40 mm dhe nuk duhet të përmbajë asgjë që të kalojë nëpërmjet sites 2.36 mm.

Raportet e inerteve te trasha dhe te imta

Raporti me i pershtatshem i volumit te inerteve te trasha ne volumen e inerteve te imta duhet te vendoset nga prova e ngjeshjes se kubikeve te betonit, por Mbikqyresi i Punimeve mund te urdheroje qe keto raporte te ndryshojne lehtesisht sipas klasifikimit te inerteve ose sipas peshes ne se do te jete e nevojshme, ne menyre qe te prodhohen klasifikimet e duhura per perzjerjet e inerteve te trasha dhe te holla.

Sipermarresi duhet te beje disa prova ne kubiket e marre si kampione dhe te shenoje inertet dhe fraksionimin e tyre, perzjerjen e betonit ne fillim te punes dhe kur ka ndonje ndryshim ne inertet e imeta apo te trasha ose ne burimin e tyre te furnizimit. Keta kubike duhet te testohen ne laborator ne kushte te njejta, pervec rasteve te ndryshimeve te vogla ne raportet perkatese te inerteve te imta dhe te trasha (lart apo poshte) nga raporti me i mire i arritur nga analizat e sites. Kubiket duhet te testohen nga 7 deri 28 dite.

Nga rezultatet e ketyre provave (testeve) Mbikqyresi i Punimeve mund te vendose per raportet e trashesise se inerteve te imta qe duhet te perdoren per cdo perzjerje te mevoneshme gjate zhvillimit te punes ose deri sa te kete ndonje ndryshim ne inerte.

Shperndarja

Ne kantier nuk do te sillen inerte per tu perdorur derisa Mbikqyresi i Punimeve te kete aprovuar inertet per tu perdorur dhe masat per larjen, etj.

Me tej nga Sipermarresi do te merren kampione ne cdo 75m³ nen mbikqyrjen e Mbikqyresit te Punimeve, per cdo tip inertit te shperndare ne kantier (teren) dhe te dorezuar perfaqesuesit te Mbikqyresit te Punimeve per provat e kontroleve te zakonshme. Kosto e te gjitha testeve do te mbulohet nga Sipermarresi.

Ruajtja e materialit te betonit

Çimento dhe inertet duhet te mbrohen ne cdo kohe nga demtuesit dhe ndotjet. Sipermarresi duhet te siguroje nje kontenier apo ndertese per ruajtjen e cimentos ne shesh. Ndertesa ose kontenieri duhet te jete e thate dhe me ventilim te pershtatshem. Ne se do te perdoret me shume se nje lloj cimentoje ne punime, kontenieri apo ndertesa duhet te jete e ndare ne nendarje te pershtatshme sipas kerkesave te Mbikqyresit te Punimeve si dhe duhet ushtruar kujdes i madh qe tipe te ndryshme cimentoje te mos jene ne kontakt me njera tjetren.

Thaset e cimentos nuk duhet te lihen direkt mbi dysHEME, por mbi shtresa druri apo pjese te ngritur trotuari per te lejuar keshtu qarkullimin efektiv te ajrit rreth e qark thaseve.

Çimentoja nuk duhet te mbahet ne nje magazine te perkohshme, pervec rasteve kur eshte e nevojshme per organizimin efektiv te perzjerjes dhe vetem kur eshte marre aprovimi i meparshem i Mbikqyresit te Punimeve.

Agregati duhet te ruhen ne kantier ne hambare ose platforma betoni te padeptueshme te pergatitura posacerisht, ne menyre qe fraksione te ndryshme inertesh te mbahen te ndara per gjithë kohen ne menyre qe perzierja e tyre te ulet ne minimum.

Sipermarresit mund t'i kerkohet te kryeje ne kantier procese shtese dhe/ose larje efektive te inerteve ateherë kur sipas Mbikqyresit te Punimeve ky veprim eshte i nevojshem per te siguruar qe te gjitha inertet plotesojne kerkesat e specifikimeve ne kohen kur materialet e betonit jane perzjere. Mbikqyresi i Punimeve do te aprovoje metodat e perdorura per pergatitjen dhe larjen e inerteve.

Uji per cimento

Uji i perdorur per beton duhet te jete i paster, i fresket dhe pa balte, papasteri organike vegjetale dhe pa kripera dhe substanca te tjera qe nderhyjne ose demtojne forcen apo durueshmerine e betonit. Uji

duhet te sigurohet mundesisht nga furnizime publike dhe mund te merret nga burime te tjera vetem nese aprovohet nga Mbikqyresi i Punimeve. Nuk duhet te perdoret asnjehere uje nga germimet, kullimet sipërfaqesore apo kanalet e vaditjes. Vetem uje i aprovuar nga ana cilesore duhet te perdoret per larjen e pastrimit e armaturave, kujdesin e betonit si dhe per qellime te ngjashme.

7.3 KERKESAT PER PERZJERJEN E BETONIT

Fortesia

Klasifikimet i referohen raporteve te cimentos, inertve te imta dhe inerteve te trasha. Kerkosat per perzjerjen e betonit duhet te konsistojne ne ndarjen propocionale dhe perzjerjen per fortesite e meposhtme kur behen testet e kubikeve;

a)	<u>Klasa e betonit</u>	<u>Fortesia ne shtypje ne N/mm2 (NEWTON/mm2)</u>	
		<u>7 dite</u>	<u>28 dite</u>
	Klasa A&A (M100) (s)1:1,5: 3	17.00	25.50
	Klasa B&B (M200) (s)1:2:4	14.00	21.00
	Klasa C&C (M250) (s)1:3:6	6.50	10.00
	Klasa D&D (M300) (s)1:6:12	Me pelqimin e Menaxherit te Projektit	
	Shenim. (s) = Çimento sulfate e rezistueshme.		

Raporti uje-cimento

Raporti uje-cimento eshte raport i peshes se cimentos ne te. Permbajtja e ujit duhet te jete efikase per te prodhuar nje perzjerje te punueshme te fortesise se specifikuar, por permbajtja totale e ujit duhet te percaktohet nga tabela e meposhtme:

b)	Klasa e betonit	Max. i ujit te lire/raporti cimento
	Klasa A&A (M100) (s)1:1,5:3	0.5
	Klasa B&B (M200) (s)1:2:4	0.6
	Klasa C&C (M250) (s)1:3:6	0.65
	Klasa D&D (M300) (s)1:6:12	Me pelqimin e Mbikqyresit te Punimeve
	Shenim. (s) = Çimento sulfate e rezistueshme.	

Qendrueshmeria

Raportet e perberesve duhet te jene te ndryshem per te siguruar qendrueshmerine e desheruar te betonit kur provohet (testohet), ne pershtatje me kerkosat e meposhtme ose sipas urdherave te Mbikqyresit te Punimeve.

Perdorimet e betonit	Min&Max (mm)
Seksionet normale te perforcuara te ngjeshura me vibrime, ngjeshja me dore e mases se betonit	25 ne 75
Seksione prej betonarmeje te renda te ngjeshura me vibracion, beton i ngjeshur me dore ne pllaka te perforcuara normalisht, trare, kollona dhe mure.	50 ne 100

Ne te gjitha rastet, raportet e agregatit ne beton duhet te jene te tilla qe te prodhohen perzjerje te cilat do futen neper qoshe edhe cepa te formave si dhe perreth perforcimit pa lejuar ndarjen e materialeve.

7.4 Matja E Materialeve

Inertet e imeta dhe te trasha do te peshohen ose te maten me kujdes ne pershtatje me kerkesat e Inxhinierit. Ato nuk do te maten ne asnje rast me lopata apo karroca dore. Cemento do te matet me thase 50 kg dhe masa e perzjerjes do te jete e tille qe grumbulli i materialeve te pershtatet per nje ose me shume thase.

7.5 Metodat E Perzjerjes

Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa mekanike te miratuar qe me pare. Perzjersi, hinka dhe pjesa perpunuese e tij duhet te jene te mbrojtura nga shiu dhe era.

Inertet dhe cemento duhet te perzjehen se bashku para se te shtohet uje derisa persjerja te fitoje ngjyren dhe fortesine e duhur. Duhet te largohen papastertirat dhe substancat e tjera te padeshirueshme. Uji nuk duhet te shtohet nga zorra apo rezervuare ne menyre te pakujdesshme. I gjithë betoni duhet te perzihet uniformisht ne fabrika moderne perzjerjeje per prodhimin maksimal te betonit te nevojshem per plotesimin e punes brenda kohes se percaktuar pa zvogeluar kohen e nevojshme per perzjerje. Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa betoni per kohezgjatjen e kerkuar per shperndarjen uniforme te perberesve per te prodhuar nje mase homogjene me ngjyre dhe fortesi por jo me pak se 1-1/2 minute. Perzjeresi duhet te perdoret nga punetore te specializuar qe kane eksperience te meparshme ne drejtimin e perdorimin e perzjeresit te betonit.

Me mbarimin e kohes se perzjerjes, perzjeresi dhe te gjitha mjetet e perdorura do te pastrohen mire perpara se betoni i mbetur ne to te kete kohe te forcohet.

Ne asnje menyre nuk duhet qe betoni te perzjehet me dore pa miratimin e Mbikqyresit te Punimeve, miratim ky qe do te jepet vetem per sasi te vogla ne kushte te vecanta.

7.6 Provat E Fortesise Gjate Punes.

Sipermarresi duhet te siguroje per qellimet e provave nje set 3 kubikesh per cdo strukture betoni, perfshire derdhje betoni nga 1-15 m³. Per derdhje betoni me shume se 15 m³, Sipermarresi duhet te siguroje te pakten nje set shtese 3 kubikesh per cdo 30 m³ shtese. Ne se mesatarja e proves se fortesise se kampionit per cdo porcion te punes bie poshte minimumit te lejueshem te fortesise se specifikuar, Mbikqyresi i Punimeve do te udhezaje nje ndryshim ne raportet ose permbajtjen e ujit ne beton, ose te dyja, ne menyre qe Punedhenesi te mos kete shtese kostoje. Sipermarresi duhet te percaktoje te gjitha kampionet qe kane te bejne me raportet e betonimit prej nga ku jane marre. Nese rezultatet e testeve te fortesise mbas kontrollit te specimentit tregojne se betoni i perftuar nuk i ploteson kerkesat e specifiuara ose kur ka prova te tjera qe tregojne se cilesia e betonit eshte nen nivelin e kerkesave te specifiuara, betoni ne vendin, qe perfaqeson kampioni do te refuzohet nga Mbikqyresi i Punimeve dhe Sipermarresi do ta levize dhe ta rivendose masen e kthyer te betonit mbrapsh me shpenzimet e veta. Sipermarresi do te mbuloje shpenzimet e te gjitha provave qe do te behen ne nje laborator qe eshte aprovuar Punedhenesit.

7.7 Transportimi I Betonit

Betoni duhet te levizet nga vendi i pergatitjes ne vendin e vendosjes perfundimtare sa me shpejt ne menyre qe te pengohet ndarja ose humbja e ndonje perberesi.

Kur te jete e mundshme, betoni do te derdhet nga perzjeresi direkt ne nje paisje qe do te beje transportimin ne destinacionin perfundimtar dhe betoni do te shkarkohet ne menyre aq te mbledhur sa te jete e mundur ne vendin perfundimtar per te shmangur shperndarjen ose derdhjen e tij.

Ne se Sipermarresi propozon te perdore pompa per transportimin dhe vendosjen e betonit, ai duhet te paraqese detaje te plota per paisjet dhe tekniken e perdorimit qe ai propozon per te perdorur per tu miratuar tek Mbikqyresi i Punimeve.

Ne rastet kur betoni transportohet me rreshqitje apo me pompa, kantieri qe do te perdoret, duhet te projektohet per te siguruar rrjedhjen e vashdueshme dhe te panderprere ne rrepre apo gryke (hinke). Fundi i pjerresise ose i pompes se shperndarjes duhet te jete i mbushur me uje para dhe pas cdo periudhe pune dhe duhet te mbahet paster. Uji i perdorur per kete qellim, duhet te largohet (derdhet) nga çdo ambient pune i perhershëm.

7.8 HEDHJA DHE NGJESHJA E BETONIT

Sipermarresi duhet te kete aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve per masat e propozuara perpara se te filloje betonimin.

Te gjitha vendet e hedhjes dhe te ngjeshjes se betonit, duhet te mbahen ne mbikqyrje te vazhdueshme nga pjesetaret perkates te ekipit te Sipermarresit.

Sipermarresi duhet te ndjeke nga afer ngjeshjen e betonit, si nje pune me rendesi te madhe, objekt i te cilit do te jete prodhimi i nje betoni te papershkushem nga uji me nje densitet dhe fortesi maximale.

Pasi te jete perzjere, betoni duhet te transportohet ne vendin e tij te punes sa me shpejt qe te jete e mundur, i ngjeshur mire ne vendin rreth perforcimit, i perzjere sic duhet me lopate me mjete te pershtatshme celiku per kallepe duke siguruar nje siperfaqe te mire dhe beton te dendur, pa vrima, dhe i ngjeshur mire per te sjelle uje ne siperfaqe dhe per te ndaluar xhepat e ajrit. Armatura duhet te jete e hapur ne menyre te tille qe te lejoje daljen e bulezave te ajrit , dhe betoni duhet te vibrohet me cdo kusht me mekanizma vibruese per ta bere ate te dendur, aty ku eshte e nevojshme

Betoni duhet te hidhet sa eshte i fresket dhe para se te kete fituar qendrueshmerine fillestare, dhe ne cdo rast jo me vone se 30 minuta pas perzjerjes.

Metoda e transportimit te betonit nga perzjeresi ne vendin e tij te punes duhet te aprovohet nga Mbikqyresi i Punimeve.

Nuk do te lejohet asnje metode qe nxit ndarjen apo vecimin e pjeseve te trasha dhe te holla, apo qe lejojne derdhjen e betonit lirisht nga nje lartesi me e madhe se 1.5m.

Kur hedhja e betonit nderpritet, betoni nuk duhet ne asnje menyre te lejohet te formoje skaje apo ane, por duhet te ndalohet dhe te forcohet mire ne nje ndalese te ndertuar posacerisht dhe te formuar mire per te krijuar nje bashkim konstruktiv efikas, qe eshte ne pergjithesi, ne qoshet e djathta drejt armatimit kryesor. Pozicioni dhe projekti i fugave te tilla, duhet te aprovohen nga Mbikqyresi i Punimeve.

Menjehere para se te hidhet betoni tjetër, siperfaqet e te gjitha fugave duhet te kontrollohen, te pastrohen me furce dhe te lahen me llaç te paster. Eshte e keshillueshme qe ashpersia e betonit te jete arritur kur ngjyra behet gri dhe te mos lihet derisa te forcohet.

Para se betoni te hidhet ne ose kundrejt nje germimi, ky germim duhet te jete i forcuar dhe pa uje te rrjedhshem apo te ndenjor, vaj dhe lende te demshme. Balta e qullet dhe materialet e tjera dhe ne rast germim guresh, copesa dhe thermija do te hiqen. Gropa duhet te jete e qullet por jo e lagur dhe duhet te ndermerren masa paraprake per te parandaluar ujerat nenetokesore qe te demtojne betonin e pa hedhur ose te shkaktojne levizjen e betonit.

Aty ku eshte e nevojshme apo e kerkuar nga Mbikqyresi i Punimeve, betoni duhet te vibrohet gjate hedhjes me vibratore te brendshem, te afta per te prodhuar vibrime jo me pak se 5000 cikle per minute. Sipermarresi duhet te tregojte kujdes per te shmangur kontaktin midis vibratoreve dhe perforcimit, dhe te evitoje vecimin e inerteve nga vibrimi i tepert. Vibratoret duhet te vendosen vertikalisht ne beton 500 mm larg dhe te terhiqen gradualisht kur fluckat e ajrit nuk dalin me ne siperfaqe. Nqs, ne vazhdim, shtypja eshte aplikuar jashte armatures, duhet te kihet kujdes i madh qe te shmanget demtimi i betonarmese.

Kur betoni vendoset ne ndalesa horizontale ose te pjerreta te kalimit te ujit, kjo e fundit duhet te zhvendoset duke i lene vendin betonit qe duhet te ngjeshet ne nje nivel pak me te larte se fundi i ndaleses se ujit para se te leshohet uji per te siguruar ngjeshje te plote te betonit rreth ndaleses se ujit.

7.9 BETONIM NE KOHE TE NXEHTE

Sipermarresi duhet te tregojte kujdes gjate motit te nxehte per te parandaluar carjen apo plasaritjen e betonit. Aty ku eshte e realizueshme, Sipermarresi duhet te marre masa qe betoni te hidhet ne mengjes ose naten vone.

Sipermarresi duhet te kete kujdes te vecante per kerkesat e specifiuara ketu per kujdesin. Kallepet duhet te mbulohen nga ekspozimi direkt ne diell si para vendosjes se betonit, ashtu edhe gjate hedhjes dhe vendosjes. Sipermarresi duhet te marre masa te pershtatshme per te siguruar qe armimi dhe hedhja e mases per tu betonuar eshte mbajtur ne temperaturat me te uleta te zbatueshme.

7.10 KUJDESI PER BETONIN

Vetem neqoftese eshte percaktuar apo urdheruar ndryshe nga Mbikqyresi i Punimeve, te gjitha betonet do te ndiqen me kujdes si me poshte:

1. Siperfaqe betoni horizontale: do te mbahet e laget vashdimisht per te pakten 7 dite pas hedhjes. Ato do te mbulohen me materiale uje mbajtes si thase kerpi, pelhure, rere e paster ose rrogos ose metoda te tjerra te miratuara nga Mbikqyresi i Punimeve.
2. Siperfaqe vertikale: do te kujdesen fillimisht duke lene armaturat ne vend pa levizur, duke varur pelhure ose thase kerpi mbi siperfaqen e perfunduar dhe duke e mbajtur vazhdimisht te laget ose duke e mbuluar me plasmas.

7.11 FORCIMI I BETONIT

Me perfundimin e germimit dhe aty ku tregohet ne vizatimet ose urdherohet nga Mbikqyresi i Punimeve, nje shtrese forcuese betoni e kategorise D jo me pak se 75 mm e trashe ose e thelle do te vendoset per te parandaluar shperberjen e mases dhe per te formuar nje siperfaqe te paster pune per strukturen.

7.12 KALLEPET OSE ARMATURAT

Armaturat ose kallepet duhet te jene ne pershtatje me profilet, linjat dhe dimensionet e betonimit te percaktuara ne skica, te fiksuara apo te mbeshtetura me pyka apo mjete te ngjashme per te lejuar qe ngarkimi te jete i lehte dhe format te levizen pa demtime dhe pa goditje ne vendin e punes.

Furnizimi, fiksimi dhe levizja e kallepeve duhet te jete pjese e punes brenda cmimit njesi te paraqitur ne Oferten e tenderit per kategori te ndryshme te betonit te furnizuar dhe te hedhur ne pune.

Kallepi duhet te ndertohet me vija qe mbyllen lehtesisht per largimin e ujit, materialeve te demshme dhe per qellime inspektimi, si dhe me lidhesa per te lehtesuar shkeputjen pa demtuar betonin. Te gjitha mbeshteteset vertikale duhet te jene te vendosura ne menyre te tille qe mund te ulen dhe kallepi te shkeputet lehte ne goditje apo sheputje. Kallepe per traret duhet te montohen me nje pjese ngritese 6mm per cdo 3m shtrirje.

Metodat e fiksimit te kallepit faqe te ekspozuara te betonit nuk duhet te perfshijne ndonje lloj fiksusi ne beton ne menyre qe te kemi siperfaqe te sheshte betoni. Asnje bulon, tel apo ndonje mjet tjetër perdorur per qellime fiksimit te kallepeve apo armimit nuk duhet te perdoret ne betonim i cili do te jete i papershkueshem nga uji. Lidhjet e perhershme metalike dhe spesoret nuk duhet te kene pjese te tyre fiksuse si te perhershme Brenda 50 mm te siperfaqes se perfunduar te betonit, dhe ndonje vrime e lene ne faqet e betonit e paekspozuar duhet qe te mbyllet permes nje suvatimi me llac cemento te forte 1:2.

Nje tolerance prej 3mm ne rritje ne nivel do te lejohet ne ngritjen e kallepit i cili duhet te jete i forte, rigjid perkundrejt betoneve te laget, vibrimeve dhe ngarkesave te ndertimit dhe duhet te mbetet ne pershtatje te plote me skicen dhe nivelin e pranuar perpara betonimit. Ajo duhet te jete sic duhet i papershkueshem nga uji qe te siguroje qe nuk do te ndodhin “disekuilibra” ose largimin e llacit per ne bashkimet, ose te lengut nga betoni.

Te gjitha qoshet e jashtme te betonit qe nuk jane vendosur pergjithmone ne toke duhet tu jepet 18mm kanal, pervec aty ku tregohet ndryshe ne vizatimet.

Tubat, tubat fleksibel (per linjat elektrike) dhe mjetet e tjera per fiksimin dhe konet ose te tjera pajisje per formimin e vrimave, kanaleve, ulluqeve etj, duhet qe te fiksohen ne menyre rigjide ne armaturat dhe aprovimi i Mbikqyresit te Punimeve do te kerkohet perpara.

Druri (derrasa) i armaturave nuk duhet te deformohen kur te lagen. Per siperfaqe te paekspozuara dhe punime jo fine, mund te perdoret derrase armature e palemuar. Ne te gjitha rastet e tjera siperfaqja ne kontakt me betonin duhet te jete e lemuar (zduguar). Druri duhet te jete i staxhionuar mire, pa nyje, te cara, vrime te vjetra gozhdash dhe gjera te ngjashme dhe pa material tjetër te huaj te ngjitur ne te.

7.13 NDERTIMI DHE CILESIA E ARMATURES

Armatura duhet te siguroje saktesine, sigurine e qendrueshmerise dhe te mbroje humbjen e lengut te cimentos nga perzierja e betonit dhe te mirmembaje ne pozicion korrekt, dimensionet dhe kendet deri ne perfundim te punes. Armaturat do te jene heqshme nga betoni pa goditje dhe pa demtime.

Armatura duhet te jete mjaft rigjide dhe e forte ne menyre qe t’i qendroje forces se betonit dhe te cdo ngarkese konstruktive dhe duhet te jete e formes se kerkuar. Njeri nga te dy materialet mund te

perdoret, druri ose metali. Cilido material te jete perdorur, duhet te jete i mberthyer ne menyre gjatesore dhe terthore, i perforcuar dhe gjithashtu per te siguroje rigjeditetin duhet te jete i papershkueshem nga uji ne te gjitha rastet e paparashikuara.

Armatura e mire duhet te perdoret per te prodhuar nje pune perfundimtare me cilesi te larte pavaresisht qe gjurmet e shenjave te kallepit te armimit mbi siperfaqen e betonit do te mbeten. Armatura duhet te jete nga veshje me derrase te thate, ose armature me siperfaqe metalike te cilesise se larte duhet te perdoren. Armatura e cilesise se ulet mund te perdoret per siperfaqe qe duhet te suvatohen ose ato te groposura ne toke, dhe duhet te montohen nga derrasa ne forme pykash me qoshet e lemuara dhe te sigurta ose nga armatura celiku te aprovuara.

Pjesa e brendshme e te gjithë armaturave (perjashto ato per punimet qe do te mbarohen me suvatim) duhet te lyhen me vaj liri, naftë bruto, ose sapun cdo here qe ato te fiksohen. Vaji duhet te aplikohet perpara se te jete vendosur perforcimi dhe nuk duhet lejuar qe lyerja te preke peforcimin. Vajosja etj, behen qe te parandaloje ngjitjen e betonit tek armatura .

Armatura duhet te goditet pa tronditur, vibruar ose demtuar betonin. Armatura qe do te riperdoret duhet te riparohet dhe pastrohet perpara se te rivendoset. Siperfaqet e brendshme te gjithë armaturave duhet te pastrohen komplet perpara vendosjes se betonit.

Kur armatura eshte prej lende drusore, siperfaqja e brendshme duhet te laget pikerisht perpara se te hidhet betoni per te shmangur keshtu absorbimin e lageshtires nga betoni.

Megjithate per ndonje armature momentale ose te propozuar duhet te merret miratimi i Mbikqyresit te Punimeve, dhe Sipermarresi duhet te mbaje pergjegjesi te plote per kapacitetin e tij dhe per permbushjen e kesaj klauzole si dhe per ndonje konsekuence te dukshme te nje pune te parakohshme ose te demshme.

Ai duhet te heqe dhe rivendose ndonje ngritje te manget ose derdhje te betonit per te cilen armatura ka defekte ne zbatim te kesaj klauzole, ne nje mase te tille sic ndoshta kerkohet nga Mbikqyresi i Punimeve.

Pasi te vendoset ne pozicion armatura duhet te mbrohet kundrejt te gjitha demtimeve dhe efekteve te motit dhe ndryshimeve te temperatures. Ne qofte se kjo eshte gjetur si e pazbatueshme per vendosjen e menjehereshme te betonit, armatura duhet te inspektohet perpara se betoni te hidhet per t'u siguruar qe bashkimet jane te puthitura, qe forma eshte sipas modelit dhe qe te gjitha papastertite jane rihetur perfshire ndonje veprim te ujit nga lageshtira e permendur me siper

Vetem lidhjet dhe shtrengimet etj. te aprovuara nga Mbikqyresi i Punimeve duhet te perdoren. Terheqjet, konet, pajisjet larese ose te tjera mekanizma te cilat lene vrima ose depresione ne siperfaqen e betonit me diametra me te medha se 20 mm nuk do te lihen brenda formave.

7.14 HEQJA E ARMATURES

Armatura nuk duhet te levizet derisa betoni te arrije fortesine e duhur per te siguruar nje qendrueshmeri te struktures dhe per te mbajtur ngarkesen ne keputje dhe cdo ngarkese konstruktive qe mund te veproje ne te. Betoni duhet te jete mjaft i forte dhe te parandalohet demtimi i siperfaqeve nepermjet perdorjes me kujdes te veglave ne heqjen e formave.

Armatura duhet te hiqet vetem me lejen e Mbikqyresit te Punimeve dhe puna e dukshme pas marrjes te nje lejeje te tille duhet te kryhet nen supervizionin personal te nje tekniku ndertimi kompetent. Kujdes i madh duhet te ushtrohet gjate levizjes se armatures per te shmangur tronditjet ose ne te kundert shtypjen ne beton

Ne rastin kur Mbikqyresi i Punimeve e konsideron qe Sipermarresi duhet te vonoje heqjen e armatures ose per shkak te kohes ose per ndonje arsye tjeter ai mund te urdheroje Sipermarresin qe te vonoje te tilla levizje dhe Sipermarresi nuk duhet te ankohet per vonesa ne konsekuence te kesaj.

Pavaresisht nga kjo ndonje njoftim i lejuar ose aprovim i dhene nga Mbikqyresi i Punimeve, Sipermarresi duhet te jete pergjegjes per ndonje demtim per punen dhe cdo demtim per rrjedhim shkaktuar nga levizja ose qe rezulton nga levizja e armatures.

Tabela meposhte eshte dhene si nje guide per Sipermarresin dhe nuk ka rruge qe cliron Sipermarresin nga detyrimet ketu:

Tipi i Armatures	Betoni
Soleta dhe traret ne ane te mureve dhe kollonat e pangarkuara	1 Dite
Mbeshtetjet e soleta dhe trareve te lena qellimisht ne vend	7 Dite
Levizja e qellimshme e mbeshtetseve Te soletave dhe trareve (temperatura e ambientit duhet te jete 25 grade celsius)	14 Dite
c) Betoni i parapergatitur	

Perjashto rastin kur specifikohet ndryshe ketu njesite e betonit te parapergatitur duhet te derdhen ne tipin e aprovuar te cdo kallepi me nje numer individual ose shkronje per qellime identifikimi. Numri i shkronjes duhet te jete ose i stampuar ose e futur ne kallep ne menyre qe cdo njesi e betonuar ne nje kallep te posacem do te deshmoje identifikimin e kallepit. Ne vazhdim data e betonimit te produktit duhet gjithashtu te gervishtet ose lyhet me boje mbi modelin. Pozicioni i shenjes se identifikimit te kallepit dhe dates duhet te jene ne faqen e cila nuk do te ekspozohet ne punen e perfunduar dhe duhet te aprovohet nga Mbikqyresi i Punimeve perpara se betonimi te filloje.

Betoni per njesine e parafabrikuar duhet te testohet sic specifikohet ketu dhe duhet te vendoset dhe kompaktohet nga menytrat e aprovuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Njesite e betonit te parafabrikuar nuk duhet te levizen ose transportohen nga vendi i betonimit derisa te kete kaluar nje periudhe prej 28 ditesh nga data e betonimit.

Klauzolat ketu referuar betonit, hekurit te armuar dhe armatures duhet zbatuar njesoj edhe per betonin e parapergatitur.

7.15 MBULIMI I CMIMIT NJESI PER BETONET

Cmimi njesi per nje meter kub beton l derdhur mbulon furnizimin e inerteve, cimentos dhe ujit dhe perzjerjen, hedhjen dhe ngjeshjen ne cdo seksion ose trashesi, kujdesin, provat dhe te gjitha aktivitetet e tjera qe pershkruhen me siper te cilat jane domosdoshmerisht te nevojshme per ekzekutimin e punimeve.

Pervec sa me siper, formimi i bashkimeve siç tregohen ne vizatimet ose siç instruktohen nga M.P., mbushja e bashkimeve me material izolues, vedosja e armimit ku te jete e nevojshme, armaturat dhe fuqia punetore jane perfshire ne cmimin njesi te betoneve.

Vetem kosto e transportimit te inerteve, cimentos hekurit nuk perfshihen ne cmimin njesi te betonit, por ne cmimin njesi te transportit.

Matjet: Matja e volumit te betonit te derdhur do te bazohet ne permasat e marra nga vizatimet qe lidhen me kete punim.

Cdo volum betoni pertej llimiteve te treguara ne vizatime nuk do te paguhen nese M.P. nuk ka instrkuar ndryshe paraprakisht me shkrim.

Cmimet njesi per zera te ndryshme punime betoni jane si me poshte:

Betone Kat. A&A(s) (M100, konform STASH 5112-78)

Betone Kat. B&B(s) (M200, konform STASH 5112-78)

Betone Kat. C&C(s) (M250, konform STASH 5112-78)

Betone Kat. D&D(s) (M300, konform STASH

7.16 ARMIMI I HEKURIT

Hekuri i armimit do te jete i viaskezuar (ne drejtim horizontal dhe vertikal) me qendrueshmeri te fushes 500 N/mm² sipas DIN 488. Mbulesa e betonit per hekurin duhet te jete 4.0 cm. Per te fiksuar hekurat e armimit ne forme, gjate hedhjes se betonit, Kontraktori do teperdore distancatore betoni (4 cope/m²).

Shufrat e armimit duhet te kthehen sipas masave dhe dimensioneve te vizatimeve, dhe ne perputhje te plote me rregulloren e, rishikuar se fundi te ASTM, shenimi A-615 me titullin "Specifikimet per shufrat e hekurit per betonarme". Ato duhet te perkulen ne perputhje me vizatimet e ASTM A-305, Celik 3 me sigma te rrjedhshmerise 250 kg/cm².

Hekuri i armimit duhet te jete pa njolla, ndryshk, mbeturina te mullijve, bojera, vajra, graso, dherave ngjitese ose ndonje material tjetër qe mund te demtoje lidhjen midis betonit dhe armimit ose qe mund te shkaktoje korrozion te armimit ose shperberje te betonit. Çimento per suva nuk duhet te lejohet. As madhesia dhe as gjatesia e shufrave nuk duhet te jene me pak se madhesia ose gjatesia e treguar ne vizatime.

Shufrat duhet te perkulen gjithmone ne te ftohte. Shufrat e perkulura jo sic duhet do te perdoren vetem ne se mjetet e perdorura per drejtimin dhe riperkuljen te jene te tilla qe te mos demtoje materialin. Asnje armim nuk do te perkulet ne pozita pune pa aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve, ne se eshte ngulur ne betonin e forcuar. Rrezja e brendeshme e perkuljeve nuk duhet te jete me e vogel se dyfishi i diametrit te shufrave per hekur te bute dhe trefishi i diametrit te shufres per hekur shume elastik.

Armimi duhet te behet me shume kujdes dhe te mbahet nga paisjet e miratuara ne pozicionin e paraqitura ne skica. Shufrat qe jane parashikuar te jene ne kontakt duhet te lidhen se bashku me siguri te larte ne te gjitha pikat e kryqezimit me tel te kalitur hekuri te bute me diameter.No.16. Kordonat lidhes dhe te tjeret si keto duhet te lidhen fort me shufrat me te cilat jane parashikuar te jene ne kontakt dhe pervec kesaj duhet te lidhen ne menyre te sigurte me tel. Menjehere para betonimit, armimi duhet te kontrollohet per sakesi vendosjeje dhe pastertie dhe do te korigjohet ne se eshte e nevojshme. Spesoret duhet te jene prej llaci me cimento dhe rere 1:2 ose materiale te tjera te miratuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Sipermarresi duhet te pershtase masa efektive per te siguruar qe perforcimi te qendroje i palevizur gjate forcimit te mases se hedhur dhe vendosjes se betonit.

Ne soletat e dhena me dy ose me shume shtresa perforcimi, shtresat paralele te hekurit duhet te mbeshteten ne pozicion me ndihmen e mbajteseve prej hekuri. Spesoret vendosen ne cdo mbajtese per te mbeshtetur shtresat e armimit nga forcimi ose armatura.

Pervec se kur tregohet ndryshe ne skica, gjatesia e nyjeve bashkuese duhet te jete jo me pak se 40 here e diametrit te shufres me diameter me te madh.

Armimet e ndertuara kur shtrohen perbri seksioneve te tjera te armimit ose kur xhuntohen, duhet te kene nje minimum xhunti prej 300mm per shufrat kryesore dhe 150 mm per shufrat e terthorta. Perdorimi i mbeturinave te prera nuk do te lejohet.

Pervec se kur eshte specifiuar apo treguar ndryshe ne skica, mbulimi i betonit ne perforcimin me te afert duke perjashtuar suvane ose punime te tjera dekorative dhe forcim betoni, do te jete si me poshte:

1. Per pune te jashtme dhe per pune ne siperfaqe toke dhe ne struktura ujembajtese -50mm
2. Per pune te brendeshme ne struktura joujembajtese:
 - a) per trare dhe kolona-50mm ne hekurin kryesor dhe ne asnje vend me pak se 40mm ne shufren me afer murit te jashtem
 - b) per forcimin e soletave-25mm per te gjitha shufrat ose diametri i shufres me te madhe, ciladoqofte me e madhja.

Prerja, perkulja dhe vendosja e armimit do te jete pjese e punes brenda cmimit njesi te vendosura ne Oferten e tenderit per armimin e hekurit te furnizuar dhe te vene ne pune.

Projektimi i armimit nga puna qe eshte duke u realizuar ose e realizuar tashme, nuk do te kthehet ne pozicionin e sakte vetem ne rast se eshte miratuar nga Mbikqyresi i Punimeve dhe do te mbrohet nga deformimi ose demtime te tjera. Saldimi i shufrave te perforcuara me perjashtim te rasteve te shufrave te fabrikua me saldime nuk do te lejohet. Shufrat e perforcuara te ekspozuara per shtesa te ardhshme, do te mbrohen nga korrozioni dhe rrezique te tjera.

7.17 BASHKIMET KONSTRUKTIVE

Perpara hedhjes se betonit eshte konkluduar te jete ne nje bashkim, siperfaqja e ashper do te lahet dhe te pastrohet ne menyre qe te gjitha materialet te jene te lira nga lageshtia e siperfaqes, vajrat dhe grasot. Keto siperfaqe do te jene te lageta dhe preferohen te lagen gjate nates duke patur paraysh qe te mos lejohet uji ne siperfaqet horizontale menjehere perpara betonimit. Nje shirit bashkues zgjerues prej gome do te vendoset ne te gjitha bashkimet e ndertimit per te mbrojtur futjen e ujrave nentokesore.

7.18 SHTRESAT E PUNES NEN BETON

Si nenshtrese per pusetat e betonit te parapregatitura, Kontraktori do te vendose nje shtrese me trashesi 10 cm te betonit te paarmuar C 12/15.

7.19 TOKEZIMI

Per lidhjen ekuipotenciale do te instalohen hekur i galvanizuar me seksion terthor 30x3.5 mm mbi shtresen e poshtme te armimit te dyshemese betonarme si tokezim i themeleve duke perfshire te gjitha distancatoret, lidhjet e telave te armimit dhe lugjet e lidhjeve. Hekuri i galvanizuar do te formoje nje unaze te mbyllur. Mbulesa e betonit te shufrave te hekurit do te jete te pakten 5 cm.

Dy lugjet e lidhjeve do te behen me hekur te galvanizuar me seksion terthor 30x3.5 mm sipas DIN 18014 dhe 18015. Kontraktori do te siguroje mbrojtjen ndaj korrozionit te lugjeve te lidhjeve.

7.20 BLOQET E ANKORIMIT

Bloqet e ankorimit do te ndertohen ne kende horizontale dhe vertikale me qellim qe te drejtojne frocat e jashtme ne toke. Projekti dhe dimensionimi i blloqeve te ankorimit do te jene sipas DVGW – Worksheet GW-310-1. Dimensionet ne perputhje me diametrat e tubave, presionin nominal te operimit dhe kendet jane treguar ne zerat perkates te Preventivit per cdo njeje. Blloqet e ankorimit do te ndertohen me beton te paarmuar C 20/25. Atje jane tre tipe te blloqeve te ankorimit:

- Blloqe ankorimi Horizontal
- Blloqe ankorimi Vertikal (me drejtim te forcave nga ajri); forcat nevojiten te transmetohen tek nje peshe e betonit nen tub permes ankerave te hekurit.
- Blloqe Vertikal Ankorimi (drejtimi i forces nga pjesa e poshtme e kanalit).

8. PUNIME METALI

8.1 KAPAKE GIZE PER Pusetat

Kapaku i Pusetave prej Gize sferoidale do te jete:

Diameter:	800 mm
Kapaku dhe korniza e Pusetes:	DIN 1229 Class D 400, EN 124
Korniza :	Gize me beton,
kapaku:	Gize me beton me dy xhepa ngritje

Kapaku i pusetes do te jete pa hapje ventiluese.

Mbishkrimi i kapakeve te jete sipas kerkeses se Punedhenesit.

8.2 KAPAKE BETONI TË ARMUAR PER Pusetat

Kapaket e pusetave prej betoni të armuar do te jene me përmasa dhe me armim siç jepet në detajet e pusetës. Kapakët e betonit do të përdoren në rastet kur pusetat do të jenë në trotuare ose jashtë korsisë së mjeteve motorike.

8.3 SHKALLE HEKURI

Cdo pusete do te pajisjet me shkalle hekuri sipas DIN 1212, Tipi E . vrimat per ankorimin ne mure do te cpohen dhe mbushen me llac cemento pas instalimit te shkalleve te hekurit, Shkalla e pare do te vendoset 30 cm poshte kapakut te pusetes. Distanca Maximale vertikale ndermjet shkalleve te hekurit do te jete 25 cm. Siperfaqja e hekurit do te jete e lyer me nje veshje antikorrozive.

9. TE NDRYSHME

9.1 SHITESAT DHE ELEMENTET E NDALIMIT TE UJIT (WATER STOP)

Te gjitha siperfaqet e mureve te jashtme te pusetave betonarme do te vishen me nje shtrese bitumi prajmer dhe dy shtresa me veshje bitumi te ftohte. Elementet water stop per bazamanetin dhe muret do te jene klas 2 sipas standarteve ISO.

ING. ANDRIN KËRPAÇI

TIRANE 2025

PREVENTIV ZBATIMI PUNIMESH

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE UJESJELLESIT TE NJESIVE ADMINISTRATIVE GOLEM
DHE SYNEJ - BASHKIA KAVAJE"

"SHQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS" SH.A.

ANALIZA ÇMIMESH

PROJEKT ZBATIMI

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE UJESJELLESIT TE NJESIVE ADMINISTRATIVE GOLEM
DHE SYNEJ - BASHKIA KAVAJE”

“SHQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS” SH.A.

GRAFIK PUNIMESH

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE UJESJELLESIT TE NJESIVE ADMINISTRATIVE GOLEM
DHE SYNEJ - BASHKIA KAVAJE"

"SHQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS" SH.A.

GRAFIKU I PUNIMEVE

OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE UJESJELLESIT TE NJESIVE ADMINISTRATIVE GOLEM DHE SYNEJ - BASHKIA KAVAJE"

NR.	Vite	1												2												3												4											
	Muaj	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48
1	NJESIA ADM. SYNEJ DHE GOLEM																																																
1.1	Ndertim I Linjes se dergimit dhe depo e Re Agonas																																																
1.2	Ndertim I Linjes kryesore te shperndarjes Kolje, Rakell, Agonas, Qerret nga Depo e Re Agonas																																																
1.3	Ndertim I Linjes kryesore te shperndarjes nga Maskuria																																																
1.4	Ndertim I rrjetit shperndares fshati Kolje																																																
1.5	Ndertim I rrjetit shperndares fshati Agonas																																																
1.6	Ndertim I rrjetit shperndares fshati Rakell																																																
1.7	Ndertim I rrjetit shperndares fshati Qerret																																																

PROJEKTOI
INVICTUS shpk
Dr. Ing. Andrin KËRPAÇI

RAPORT V.N.M.

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT TE UJESJELLESIT TE NJESIVE ADMINISTRATIVE GOLEM
DHE SYNEJ - BASHKIA KAVAJE”

“SHQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS” SH.A.

PERMBAJTJA

1. HYRJE

2. KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

2.1 Baza Ligjore.

3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

3.1 Pozicioni gjeografik.

3.2 Statusi i zones se studiuar dhe objektvi i projektit.

4. TREGUESIT TEKNIKE TE PROJEKTIT DHE KOSTOJA E PROJEKTIT

5. EKONOMIA E ZONES DHE AKTIVITETET KRYESORE TE SAJ

5.1 Statusi i zones ne studim.

5.2 Variantet e zhvillimit ne perspektve.

5.3 Mendimi i Komunitetit.

5.4 Planet e zhvillimit urban te zones.

5.5 Ekosistemet, habitatet dhe pesazhi egzistues.

5.6 Trashegimia arkitektonike dhe historike.

6. METODIKA E V.N.M

6.1 Objektivat dhe qellimi i V.N.M.-së.

6.2 Metodika e kryerjes se V.N.M.-së.

6.3 Identifikimi i ndikimeve ne mjedis nga zbatimi i projektit.

7. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE DHE VLERESIMI I SITUATES

7.1 Ndikimet ne mjedis gjate ndertimit te tubacioneve te rjetit te furnizimit me uje.

7.2 Ndikimet ne mjedis si rezultat i sjelljes se materialeve te ndryshme per ndertimin e objektit.

7.3 Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese.

7.4 Zhurmat.

7.5 Ndikimet ne ujrat siperfaqesore.

7.6 Ndikimet ne ujrat nentokesore.

8. PLANI I ZBUTJES SE NDIKIMEVE NEGATIVE & REHABILITIMET

8.1 Perdorimi tokes.

8.2 Ndikimi tek njerezit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu.

8.3 Ndikimet e linjave ne trashgimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike.

8.4 Ulja e intensitetit të erozionit dhe zbutja e ndryshimeve të topografisë.

9. NDIKIMET NE FLORE, FAUNE DHE GJEOLLOJINE

9.1 Bimet e ujit.

9.2 Flora dhe Fauna.

9.3 Humbja dhe demtimi i tipareve gjellogjike, paleontologjike, problemi mjedisit gjeologjik.

10. NDIKIMET E PRITSHME NE MJEDISIN PERRETH

10.1 Ndikimet fizike të projektit në ndryshimet e topografisë së zonës, tokës, etj.

10.2 Në cilësi dhe sasi të tokës.

10.3 Ndikimet në ujë.

10.4 Ndikimet e ndotësve dhe mbetjeve në cilësi të ujit

10.5 Ndikimet në ajër

10.6 Ndikimi në klimë

10.7 Aromat sulmuese

10.8 Ndikime të tjera klimatike

10.8 Ndikime të tjera indirekte dhe sekondare, që shoqërojnë projektin

10.10 Ndikimet shoqëruese të projektit me projekte të tjera ekzistuese e të propozuara

11. MASAT PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

11.1 Organizimi

11.2 Masat e sigurimit teknik në punë

11.3 Mbrojtja e mjedisit

11.4 Masat e mara për zbutjen e rrezikut në mjedis dhe shëndet

13. MATRICAT PERMBLEDHESE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

13.1 Matrica e ndikimeve në mjedis

13.2 Matrica e prioriteteve të ndikimeve në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit

14. ASPEKTET NEGATIVE DHE POZITIVE TE NDIKIMIT NE MJEDIS

14.1 Efektet negative

14.2 Efektet positive

15. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. HYRJE

Rajoni i Ultesires Perëndimore te Shqipërisë, ku bëjnë pjesë fshatrat Agonas, Kolje, Rakell, Qerret ne Njësitë Administrative Synej & Golem, Bashkia Kavajë eshte ndër hapësirat më të rëndesishme te zhvillimit ekonomik, dhe turistik te Shqiperise. Qyteti i Durresit eshte nje nga portat kryesore te hyrjes se mallrave dhe turisteve nepermjet portit te Durresit. Gjithashtu per shkak te distances se afert me Durresin e gjithe zona perreth rruges Kavaje - Durres – Tirane, ruges se vjeter Kavaje – Plepa – Tirane, dhe Lezhe - Kurbin – Kruje -Vore -Tirane eshte e zhvilluar si zone Turistike, Bujqesore, Blektoarle, Turistike dhe Industriale me biznese te natyrave te ndryshme.

Shqipëria është palë e një numri Konventash Ndërkombëtare (Barcelona, Ramsari, Konventa e Biodiversitetit, etj), dhe tashme ka një paketë të plotë ligjore për masat mbrojtëse të mjedisit dhe vlerësimin e impaktit ambjental të veprimtarive, shërbimeve apo ndërtimeve në mjedisin perreth tyre.

Ky kuader ligjor dhe angazhimet nderkombetare ne fushen e mjedisit, shtrojne shume detyra ndaj institucioneve per te zbatuar nje sistem sa me efektiv per administrimin e ujrave, tokes dhe ajrit, jo vetem ne drejtim te zgjidhjes se problemit per shfrytezimin e ujit per furnizimin e popullsisë me uje te pijshem, por dhe zbatimit te pergjegjesive te rrjedhura nga keto marreveshje. Vendi yne duke qene anetar i nje numri konventash, detyrohet te zbatoje nje sistem sa me efektiv ekonomik dhe social-mjedisor, per rregullimin e territorit, sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore.

Ne zhvillimin ekonomik-shoqëror te nje vendi, gjithnje ne perputhje me parimin universal te zhvillimit te qendrueshem, marrin rendesi te vecante gjetja e rrugëve dhe teknologjive me efikase, si per shfrytezimin sa me racional te pasurive natyrore, ashtu edhe per kontrollin cilesor dhe sasior te ndikimit mbi mjedis, sidomos ne burimet nenujore.

Shkarkimet e lengeta urbane dhe industriale ne ujrat siperfaqesore jane tashme nje dukuri e rendomte, te cilat ne menyre progresive kane ndikuar ne demtimin e cilesise se ujrave te lumejve tane dhe grykederdhjet e tyre. Keto ndikime, shpesh here te njohura por edhe te panjohura, jane me te dukshme ne impaktin qe kane ne shendetin e njeriut dhe ne mjedisin ne pergjithesi.

Shfrytezimi i baseneve ujembajtes ka cuar ne disa raste ne prishjen e ekuilibrave natyrore, per shkak te nje shfrytezimi pa kriter dhe pa rregulla sipas nje ligjshmerie te caktuar shkencore. Shfrytezimi i baseneve dhe akuifereve ujore eshte nderhyrje teper e rendesishme ne aktivitetin e tij normal. Per kete qellim nderhyrja, me synim shfrytezimin e ujit nga pusët ekzistuese, duhet koordinuar me aktivitete te tjera jetesore dhe ekonomike te zones. Vemendje e vecante duhet te kihet sidomos:

- kur keto basene/akuifere jane afer qendrave te banuara,
- kur nga keto basene/akuifere furnizohet me uje te pijshem popullsia,
- kur ka objekte industriale qe jane te lidhur me nevojat per uje teknologjik,
- kur zhvillohen aktivitete te akuakultures,
- kur jane zona qe kane nje status te vecante, etj.

Prishja e ketyre ekuilibrave vjen mund te vije si pasoje e nje shfrytezimi pa kriter te ketyre baseneve. Ne vendin tone basene ujembajtese qe kane rezerva te shumta te nje cilesi te larte jane shume pak kryesisht.

Ne Ligjin me Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” i ndryshuar (V.N.M.) eshte dhene ne menyre te qarte se cilat projekte i nenshtrohen vleresimit te ndikimit ne mjedis te cilat klasifikohen si me poshte:

1. Procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis (V.N.M) i nenshtrohen gjithë projektet e veprimtarite, qe jepen ne shtojcat 1 dhe 2 te ketij ligji, para miratimit tyre nga organet perkatese.

2. Projektet e veprimtarite i nenshtrohen dy niveleve te shqyrtimit per vleresim ndikimi:

a) Procesit te thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis nenshtrohen projektet e shtojces 1 dhe projektet e veprimtarise qe kerkojne te zbatohen ne nje zone te mbrojtur.

b) Procesit te permbledhur te vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM), te cilit i nenshtrohen projektet e shtojces 2 dhe ndryshimet ose rikonstruksionet e projekteve te shtojces 1.

TAB 1. KLASIFIKIMI I RAPORTIT TE V.N.M.-SE PER PROJEKT ZBATIMI “RIKONSTRUKSION RRJETI I UJËSJELLËSIT TE FSHATRAVE AGONAS, KOLJE, RAKELL, QERRET NE NJËSITË ADMINISTRATIVE SYNEJ & GOLEM, BASHKIA KAVAJË”

Pyetje qe duhen marre parasysh per klasifikimin gjate zbatimit te projekt-idese apo ushtrimit te veprimtarise:	Pershkruj shkurtimisht Po / Jo	Do te kete nderveprim/ndikim te rendesishem? Po / Jo - Perse?
1. Do te shkaktohen ndryshime fizike ne territor (ne topografine, perdorimin e tokes ose burimet ujore etj.)?	Jo	Jo (punimet pas perfundimit do te jene te maskuara nen toke)
2. Do te perdoren burimet natyrore si: toka, uji, materiale ose energji, vecanerisht ato burime qe nuk jane te rinovueshme ose me pakice?	Jo	Jo (toka per kalimin e tubave jane ne rruge ekz. dhe depot re Agonas ne toke shtet. Uji do te lidhet ne tubacionion Gize 500mm”
3. Parashikohet perdorimi, magazinimi, transporti apo prodhimi i substancave ose materialeve te demshme per shendetin dhe mjedisin?	Jo	Jo (materialele qe do te perdoren jane tuba PE te certifikuar sipas CE, inerte per kanalin, beton, hekur, asfalt, konstruksione metalike, rakorderi.
4. Do te prodhohen mbetje te ngurta?	Po (gjate ndertimit te objektit)	Jo (mbetjet do te trajtohen ne perputhje me VKM 575, date 24.06.2015 ne vendin e miratuar nga njesia vendore)
5. Do te kete shkarkime ne ajer te ndotesve, substancave te rrezikshme, toksike ose helmuese?	Jo	Jo (shkarkimet ne ajer pritet te jete pluhur nga germimet dhe mbushje per te cilat do meren masa zbutese duke lagur siperfaqen me uje)
6. Do te kete zhurma e vibrime apo clirime drite, energjie ose rrezatim elektromagnetik?	Po (zhurma - gjate ndertimit)	Po (do te punohet me orar te kufizuar 7 ⁰⁰ -15 ⁰⁰ per te ulur ndikimin ne mjedisin perreth)
7. Do te kete rrezik per ndotjen e tokes e ujerave nga shkarkimi i ndotesve ne siperfaqen e tokes, ujerave siperfaqesore, nentokesore, bregdetare ose ne det?	Jo	Jo (punimet jane siperfaqesore me thellesi 1.2-1.6m dhe do te kryhen me kujdes per te mos prishur strukturen e rruges ekzistuese)
8. Ka rrezik per aksidente qe ndikojne ne shendetin e njerezve apo ne mjedis?	Po (gjate ndertimit)	Jo (do te zbatohen me rigorozitet kushtet dhe rregullat e sigurimit teknik)
9. Do kete ndikime sociale, demografike, menyra tradicionale jetese, punesim etj?	Po (sociale, demografike, jetese, punesim)	Po (impakt pozitiv ne furnizimin me uje 24-ore, rritjen e popullsise si pasoje e mireqenises, rritje e turisteve dhe pushuesve ditor si pasoje e kushteve higjenike, rritje te punesimit gjate ndertimit dhe nga bizneset e ndryshme, rritje e blektorise si pasoje e disponimit te ujit per nevojat e bagetive te imta dhe trasha)
10. Ka faktore te tjere qe duhen marre ne konsiderate si zhvillime qe cojne ne pasoja mjedisore apo mundesi per mbivendosje ndikimesh te ndryshme nga veprimtari ekzistuese ose te planifikuara ne zone?	Jo	Jo (projekti i njesise administrative Synej dhe Golem do te zhvillohet ne rruget ekzistuese)
11. Ka zona te mbrojtura nga legjislacioni nderkombetar/kombetar per vlerat e tyre ne biodiversitet, ekologji, peizazh, vlere kulturore, historike e arkeologjike?	Jo	Jo (projekti i njesise administrative Synej dhe Golem kalon ne rruget ekz. thellesia e kanalit qe vendoset tubacioni eshte 1.2-1.6m.)
12. Ka zona te ndjeshme mjedisore, si zona bregdetare, male, pyje, kullota, flore, faun e eger, dru frutore ne zone?	Jo	Jo (projekti zhvillohet ne rruget ekz. te njesive Golem, Synej dhe ne perfundim kanali do te mbulohet. Depo e re ne Agonas eshte ndertese e ngjashme me banesat e zones)
13. Ka zona me specie te mbrojtura, te rendesishme ose te ndjeshme, rrezikuara kercenuara, ne rrezik zhdukje te faunes e flores, p.sh. per kryqezime, folenizime, pushime, dimerime, migrime etj. ne zone?	Po (nuk perfshihet ne listen MM)	Jo (ndertimi i rrjetit te tubacioneve te ujesjellesit nuk cënon florën dhe faunën)

14. Ka zona me ujëra tokësore, nëntokesore apo detare ne zone?	Po (Detare)	Jo (Punimet janë siperfaqesore 1.2-1.6m te cilat nuk kane ndikim dhe do te kryhen punime ne rruge ekzistuese)
15. Ka zona me tipare te spikatura panoramike ose skenike ne zone?	Jo	Jo
16. Ka rruge a infrastruktura te ngjashme qe perdoren nga publiku per te shkuar ne vende pushimi etj. ose rruge transporti te mbingarkuara qe mund te ndikohen?	Po (Rruget ekz.)	Po (ka ndikim te perkohshem ne levizjen e mjeteve dhe njerezve gjate ndertimit, por do te meren masa ne menaxhimin e trafikut dhe ne perfundim do te kthehen ne gjendjen fillestare)
17. Ka perdorime ekzistuese te tokes (banine, industri, tregti, pushim, bujqesi, pyje, turizem, zona te gjelbra, sportive, argetuese, prona te tjera private etj.) ose plane te ardhshme qe ndikohen?	Po (rruge, banime, tregeti, pushim, bujqesi, argetim)	Jo (ka ndikim gjate ndertimit. Projekti do te zhvillohet i ndare ne zona dhe njesi ne periudha te ndryshme)
18. Eshte zona nen rrezikun e ndotjes ose demtimeve mjedisore (ku standartet mjedisore jane tejkaluar)?	Jo	Jo
19. Eshte zona me probleme sa i perket termeteve, rreshqitjes dherave, erozionit, permbytjeve, kushteve ekstreme klimatike (ndryshime te temperatures, mjegulla erera te forta)?	Po (Termeti)	Jo (projekti nuk ka ndikime te ndjeshme pasi ne pjesen me te madhe jane tubacione nen toke. Per depon e re eshte kryher vezhgim gjeologjik)

2. KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

2.1 Baza Ligjore

Ndergjegjesimi ne Shqiperi eshte i nje niveli te mesem, kjo si rrjedhoje e zbatimit te legjislaciaonit mjedisor 15-20 vjecar qe eshte ne zhvillim dhe po plotesohet me tej sidomos me direktivat europiane per fushen. Aplikimet per V.N.M. kane si detyrim paketen ligjore te meposhteme:

- Udhzues metodik i Ministrise se Mjedisit, Tirane, “Per Pergatitjen e Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”
- Udhhezimin Nr.6, date 27.12.2006 “Per miratimi e metodologjises vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie”
- Ligj Nr.10431, Datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen E Mjedisit” i ndryshuar,
- Ligj Nr.10440, Datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis” i ndryshuar,
- Ligji Nr. 111/2012, date 03.12.2012 “Për Menaxhimin E Integruar Të Burimeve Ujore” i ndryshuar,
- Ligji Nr.21/2024 “Për Zonat e Mbrojtura”
- V.K.M. Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për Miratimin E Kërkesave Për Menaxhimin E Mbetjeve Inerte”
- V.K.M. Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësi e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit Në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”

Raporti i Vleresimit Ndikimit ne Mjedis perfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimit te projektit ne mjedisin fizik dhe social. Ky proces zhvillohet brenda atij te planifikimit dhe zbatimit te projektit, duke paraqitur prioritetet mjedisore dhe listen e veprimeve per zgjidhjen e tyre.

Raporti realizon bashkepunimin midis pushtetit vendor, pushtetit qendror dhe investitorit, duke i paraprire zhvillimit te sigurte dhe te qendrueshem. Ne vijim jane pershkruar vecorite kryesore te projektit, te cilat, se bashku me investigimet ne vendin e ndertimit te parashikuar, kane sherbyer per identifikimin e ndikimeve te mundeshme ne mjedis gjate nderhyrjes ne permiresimin e furnizimit me uje ne zonat e njesive administrative Golem, Synej, duke ndertuar rrjetin shperndares te furnizimit me uje.

3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

3.1 Gjendja Ekzistuese

Është e njohur problematika e garantimit të sasisë së ujit, që të mbulojë zonat e banuara nga ana sasiore ashtu dhe cilësore pas viteve '90. Janë pak qytete që tashme e kanë zgjidhur këtë problematike për furnizimin me ujë të pijshëm 24-ore në ditë. Kjo situatë vjen jo për shkak të mungesës së ujit në burimet tona natyrore, por si pasoje e disa faktorëve nga të cilët më të rëndësishmit janë ata që paraqiten më poshtë:

1. Rritja e nevojës për ujë pas viteve '90 me përdorimin e paisjeve të reja elektroshtëpiake.
2. Levizja demografike në drejtim të qyteteve ka qenë shumë e lartë
3. Vendosja e banoreve në zona të pa planifikuara në të cilat mungon infrastruktura inxhinierike dhe rrjetet ekzistuese nuk e përballojnë këtë shtesë popullore.
4. Humbjet teknike në rrjet.
5. Keqmenaxhimi i rrjeteve ekzistuese për shkak të mungesës së menaxhimit në distancë të konsumit, presioneve dhe humbjeve në rrjet.
6. Lidhjet e paligjshme ose faturimi aforë rrit artificialisht nevojën e ujit për banorë.
7. Një pjesë e faktoreve të mësipërme sjellin ndotjen mikrobiologjike të ujit duke e bërë atë të pa përdorshëm.

Zona e projektit përfshin njësitë administrative Golem, Synej, të qytetit Kavajë. Në zonat e projektit kemi një zhvillim informal dhe ndertime larg qendrës së fshatrave duke rritur humbjet dhe konsumin e ujit. Kështu zona kryesisht kanë si aktivitete normale bujqësi dhe blektorinë por vitet e fundit po zhvillohet edhe sektori i hotelierisë dhe shërbimeve të cilat punojnë në sezonin e verës me kapacitet të plotë duke ndikuar në rritjen e numrit të popullsisë rezidente dhe për pasojë rritjen e konsumit në orë piku pas plazhit (dreke dhe darkë) duke ulur sasinë e ujit për frymë ose duke u furnizuar me orare për shkak të kapacitetit të vogël të depoveve ekz.

Si rezultat i ndertimeve të reja në zonat informale përreth qendrës së fshatit janë rritur abonentët po duke qenë zona me të vështirë për tu kontrolluar nga ndermarja janë rritur edhe lidhjet e paligjshme në tubacionin ekz. Nderhryrjet e paligjshme në rrjet, kanë sjellë rritje të konsumit të ujit pasi nuk paguhet sasia e konsumuar dhe nderhryrja nga njëri të pa specializuar në tubacion krijon shpesh defekte dhe rrjedhje të ujit. Niveli i faturimit dhe mbledhja e të ardhurave të faturuara është shumë i ulët për shkak të shtrirjes shumë të madhe të rrjetit, pamundësi të kontrollit të gjithë territorit, kultures së ndryshme të konsumatorëve për të paguar ujin e konsumuar dhe përdorimin e ujit të pijshëm në bujqësi, lidhjeve të paligjshme dhe mungesa e matësve individual për banorët.

Rrjeti i ekzistues i furnizimit me ujë nuk arrin të plotësojë nevojën për furnizim me ujë për këta banorë me sasinë dhe cilësinë e duhur pasi aty me parë janë bërë vetëm investime të pjesëshme vetëm për të përmirësuar gjendjen e emergjencës. Janë ndërtuar rrjete tubacionesh në vazhdim të rrjeteve ekzistuese, pa rritur kapacitetin e puseshpimeve apo depo të reja prandaj lind nevoja për ndërtimin e një rrjeti tërësisht të ri që të trajtojë të gjithë zonën të plotë me kushtet e reja dhe të bëjë të mundur furnizimin me ujë 24 orë me prurjen dhe presionin e kërkuar për të gjithë vitin dhe të përballojë fluksin e pushuesve sezonalë, me sasinë e ujit që është llogaritur për të marrë nga

linjat e dergimit nga burimet e Çermes. Me poshte po pershkruaj situaten ekzistuese per secilen njesi administartive me problematikat qe ka:

Fshati Agonas furnizohet nga depo Agonas 200m³ e vjeter qe lidhet me tub PE 110mm, me tubin e Gizes 500mm qe vjen nga puseshipimet e Çermes. Fshati nuk ka rrjet shperndares, kolektore dhe matesa. Prane depos eshte ndertuar nje stacion pompimi i vjeter per zonat qe nuk mbulohen nga kuota e depos.

Fshati Kolje nuk ka pike furnizimi, depo dhe rrjet shperndares.

Fshati Qerret (fshati) furnizohet pjeserisht nga depo Agonas 200m³ dhe nuk mbulon nevojat e zones me uje. Fshati ka rrjet te vjeter te amortizuar pa kolektor dhe matesa. Pjeserisht banoret jane lidhur te linja e dergimit tub Gize 500mm qe vjen nga pus shpimet e Çermes.

Fshati Qerret (turistike) furnizohet pjeserisht sipas komplekseve/resorteve dhe pallateve investime private nga tubi PE 400mm qe vjen nga depo Golem 4000m³. Ne periudhen e veres sasia e ujit konsumohet nga zona turistike Golem dhe nuk arin te furnizohet zona turistike Qerret. Komplekset turistike Qerret jane lidhur pjeserisht te linja PE 400mm e shperndarjes Golem, me tuba PE 110-90mm jo cilesor dhe zona nuk ka depo.

3.2 Statusi i zones se studiuar dhe objektivi i projektit

Zona ku shtrihet projekti nuk ka ndonje status te vecante. Ky projekt parashikon te ndërhyjë me investime ne linje dergimi, depo 6000m³ mbi rezervuarin e bujqesise Agonas, afer fshatit Kanaparaj, rrjeti shperndarjes sipas planimetrise se pergjithshme.

Duke qënë se linjat kalojnë ne rrugë te sistemuar, gjatë gërmimit të kanaleve dheu i gërmuar do të largohet dhe mbushja e kanalit do të bëhet me zhavorr për të përmiresuar parametrat e rrugës dhe evituar dëmtimet e mundëshme nga cedimet e rrugës. Në pjesët e afaltuara do të rishtrohen me asfalt. Për të bërë një manovrim dhe shfrytëzim sa më të mirë të rrjetit janë parashikuar ndërtimi i pusetave të manovrimit në pikat kryesore të rrjetit.

4. TREGUESIT E PROJEKTIT

Per percaktimin e prurjeve karakteristike te furnizimit me uje perdorim formulat e meposhtme:

- **Prurja maksimale ditore ne meter kub-** $Q_{\max. \text{ dit.}} = \frac{N \times K_d \times n}{1000} \text{ m}^3/\text{d}$

- **Prurja maksimale ditore ne sekond -** $q_{\max. \text{ dit. sek.}} = \frac{N \times K_d \times n}{3.6 \times 24} \text{ l/s}$

N – Numri i popullsesise ne fund te kohes se projekimit

P – Numri aktual i popullsesise 18132 banore.

i – Shtesa natyrore e popullsesise 1.5 %

t – Periudha e projektimit 50 vjet

n – Norma e furnizimit mesatarisht ditore 150 l/d/banore

K_d – Koefiçenti ditor i jouniformitetit K_d = 1.5

K_o – Koefiçenti orar i jouniformitetit K_o = 2.0

- **Prurja maksimale orare ne meter kub-** $Q_{\max \text{ orare}} = \frac{\left[\frac{N \times K_o \times n}{1000} \right]}{24} \text{ m}^3/\text{d}$

- **Prurja maksimale orare ne sekond** - $q_{\max \text{ orare sek.}} = \left[\frac{N \times K_o \times n}{\frac{1000}{24}} \right] / 3.6 \text{ l/s}$

Logaritjet numerike i paraqesim ne tabelen e meposhtme.

PERCAKTI I PRURJEVE PER FSHATRA T QERRET - RAKELL - KOLJE

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Sasia pas 50 vjetesh	Norma mesatare l/dite	Norma l/sek	K. pikut Ditor (VKM 83 Dt.10/02/2021)	Q _{max.dit} m ³ /dite	q _{max.ditore sek} l/sek	K. pikut Orar (VKM 83 Dt.10/02/2021)	Q _{max.orar} m ³ /dite	q _{max.orare.sek} l/sek
1	Popullsia Urbane	banor	7872	16572	150	-	1.5	3,728.70	43.16	2.00	207.15	57.54
1	Popullsia Rurale	banor	10260	13166	150	-	1.5	2,962.35	34.29	2.00	164.58	45.72
1	Vizitore	banor	3000	4934	60	-	1.5	444.06	5.14	2.00	24.67	6.85
2	Qender shendetsore	-	3	3	-	0.2	1	51.84	0.60	1.00	0.72	0.20
3	Shkolla	nxeues	210	320	40	-	1	12.80	0.15	1.00	0.53	0.15
Shuma								7,199.75	83.33		397.65	110.46

Ky projekt parashikon të ndërhyjë me investime per furnizimin me uje te zones se projektit. Do te ndertohen linja të reja në drejtim të konsumatorit të cilët do të lidhen pasi të kenë lidhur kontratat bazuar në legjislacionin ne fuqi per furnizimin me uje te pijshem.

5. EKONOMIA E ZONES DHE AKTIVITETET KRYESORE TE SAJ

5.1 Statusi i zones ne studim

Në këtë zonë jetojnë banorët rezidentë, vizitore ditore dhe pushues ne periudhen e veres. Kjo zone historikisht dhe tradicionalisht, gje qe vazhdon edhe sot, ka gjetur zhvillim Bujqesia, Blektoria, Tregetia, Sherbimet, dhe Ndërtimi. Nga aktivitetet e mësipërme popullsia mbulon 95% të nevojave ekonomike.

5.2 Mendimi i Komunitetit

Per zhvillimin e ketij projekti investitori qe eshte dhe administratori i rrjetit i ka kushtuar nje vemendje te vecante bashkepunimit me pushtetin vendor. Qe ne fillimin e studimeve perkatese per kete projekt, eshte marre kontakt me drejtuesit lokal ku shtrihet objekti, pasi edhe komuniteti perreth eshte pale e interesuar.

5.3 Planet e zhvillimit urban te zones

Zhvillimi i kesaj hapesire parashtron disa kerkesa dhe kushte rigoroze ndaj vendim marresve. Projekti i ndertimit te rrjetit shperndares te furnizimit me uje eshte pjese e planeve te zhvillimit te zones.

5.4 Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi egzistues

Zona e rikonstruksionit nuk ka ndonjë ekosistem, habitat apo peisazh ekzistues.

5.5 Trashegimia arkitektonike dhe historike

Gjate hapjes se trasese nuk pritet te takohen objekte dhe trashegimi qe bartin vlera kulturore.

6. METODIKA E V.N.M.-SË

Ndikimi ne Mjedis eshte bazuar ne Master Planin e Zhvillimit te Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve per Shqiperine 2012, hartuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Ujsjelles Kanalizime, per zhvillimin e e ketyre sektoreve ne periudha afat shkurter, afat mesem dhe afat gjate.

Qellimi i Strategjise se Furnizimit me uje dhe Kanalizimeve ka te beje me zhvillimin sa me efektiv te sektorit:

- 1) Garanton sigurine e furnizimit me uje te popullates rezidente dhe pushuesve sezonale.
- 2) Sektori i furnizimit me uje eshte nje sektor mbeshtetes per nje zhvillim te qendrueshem te gjithë sektoreve ekonomik.

Qellimi i ketij raporti eshte marrja parasysh e faktoreve qe ndikojne ne mjedis gjate ndertimit te objektit dhe funksionimit te tij. Ky raport eshte pjesa me e rendesishrne e dokumentacionit te kerkuar, ne zbatim te procedures se nevojshme gjate procesit te miratimit te V.N.M Paraprake. Raporti ka gjithashtu si qellim te jape nje veshtrim te pergjithshem mbi efektet ne mjedis, alternativat e mundeshme dhe masat zbutese te efekteve te padeshirueshme.

V.N.M-ja synon parashikimin e te gjithë efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultonin nga nje projekt i propozuar, si gjate zbatimit ashtu dhe gjate funksionimit te tij. Raporti perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet:

- Marrja ne konsiderate e ceshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimit cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt, etj.

Qellimi i ketij raporti i pergatitur per evidentimin e ndikimit ne mjedis nga ndertimi i rrjeteve te furnizimit me uje te njesive administrative, eshte qe te identifikojë pasojat e mundshme negative mjedisore qe mund te krijohen gjate ndertimit dhe shfrytezimit te ketyre rrjeteve.

Gjithashtu nje tjetër synim i ketij raporti eshte te percaktojë e te rekomandojë masat tekniko-organizative per zbutjen e faktoreve negative qe ekzistojne, dhe te atyre qe krijohen gjate ndertimit dhe shfrytezimit te tij. Raporti i ketij projekti eshte hartuar per te integruar mbrotjen ambientale ne jeten e perdritshme, qe te udheheqë ne ndryshimin e sjelljes se komunitetit, duke u bere ne kete menyre forca shtytese e permiresimit te vazhdueshem.

Metoda me e pershtateshme per ndikimin eshte ajo e listkontrollit, e cila vendos nga njera ane te gjitha burimet e mundshme te ndikimeve, nga ana tjetër mbartësit e ndikimeve, dhe parashikimin e madhesise se ndikimit.

6.1 Objektivat e raportit te V.N.M.-së

Objektivat raportit konsistojne ne analizimin e faktoreve lokale e negative mjedisore, ne dhenien e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative, si dhe tenton ne permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit gjate ndertimit dhe shfrytezimit te linjave te furnizimit me uje.

Qellimi i eshte, qe nepermjet vleresimit cilesor e sasior paraprak te parametrave hidrologjike te treguesve gjeologo-inxhinjerike te bazuara ne kriteret e standarte shkencore nderkombetare, te tipizohen dhe te perzgjidhen nje sere parametrash dhe vecorish te sistemeve te siperpermendur natyrore, ne sherbim te infrastruktures mjedisore, te infrastruktures urbane, ndertimit dhe shfrytezimit etj.

Ky raport ka per qellim te sherbeje:

- Si instrument per mbrotjen e mjedisit;
- Ne fuqizimin e komunitetit per veprime ne mbrojtje te mjedisit;

- Ne kontrollin e përdorimit të qendrueshëm të burimeve natyrore;
- Ne rritjen e mirëqenies nga menaxhimi afatgjatë i burimeve ujore;
- Ne mbrojtje të pasojave financiare dhe social-ekonomike;
- Ne rritje të interesimit për bashkëpunim dhe në gjetjen e zgjidhjeve të reja, etj.
- Ne marrjen e masave të nevojshme për zbutjen e ndikimeve të parashikuara

6.2 Metodika e kryerjes së V.N.M.-së

Studimi vlerësimit të ndikimit në mjedis u orientua;

- nga rendesia e ndërtimit dhe shfrytëzimit të rrjetit të ujësjes me standartet bashkekohore,
- nga përmbushja e kërkesave vendase dhe të huaja,
- nga vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore e humane të zonës si dhe vlerave të vecanta të tyre,
- në identifikimin e ndikimeve negative dhe lokale,
- marrjen e masave zbutëse, duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike të investimit,
- në masat orientuese për një zhvillim të qendrueshëm etj.

Në këtë raport identifikohen ndikimet lokale e negative në mjedis dhe është marrë parasysh vlerësimi i rrezikut. Reduktimi i ndikimeve negative, është nderthurur me ndikime të rendesishme lokale dhe strukturore në fazat kryesore:

- Hartimi i objektivave orientuese të V.N.M.-së;
- Verifikimi në terren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave biofizike dhe humane;
- Hartimi i V.N.M.-së dhe dorëzimi tek porositesit si dhe në subjektet vendimarese.

6.3 Identifikimi i ndikimeve në mjedis nga zbatimi i projektit

Nga vlerësimi i veçorive kryesore të projektit dhe me investigimet në zonat e parashikuara për ndërtimin e rrjetit të ujësjes është bërë identifikimi dhe rivlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedis nga ndërtimi i këtyre linjave. Në përputhje me Udhëzimin Nr.6, datë 27.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis të një veprimtarie” me këto identifikime dhe vlerësime është plotësuar tabela I e Aneksit II të këtij udhëzimi për të analizuar në mënyrë të detajuar vlerësimet sasore të ndikimeve në mjedis nga zbatimi i projektit të ndërtimit të linjave të transmetimit për ujësjesat e këtyre fshatrave.

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS NGA ZBATIMI I PROJEKT ZBATIMI “RIKONSTRUKSION RRJETI I UJËSJELLËSIT TË FSHATRAVE AGONAS, KOLJE, RAKELL, QERRET NË NJËSITË ADMINISTRATIVE SYNEJ & GOLEM, BASHKIA KAVAJË”

Nr	Pyetje që konsiderohen në fazën e përzgjedhjes	Po/Jo	Cilet elemente të mjedisit mund të ndikojnë/ si?	Do të jete ndikimi domethenes në mjedis? Pse?
1 A do të përfshijë ndërtimi, operimi ose mbyllja e veprimtarisë dhe montimi i teknologjisë dhe pajisjeve veprime që të shkaktojnë ndryshime fizike në topografi, përdorim toke, ndryshime në trupat ujore etj ?				
1.1	Ndryshime të perkoheshme ose të përherëshme në përdorimin e tokës, mbulesën e saj ,topografin, duke përfshirë ritjen e intensitetit të përdorimit të tokës	Po	Pjesa e tokës ku ndërtohen tubacionet dhe depot	Jo (ndërtimi i linjave dhe depo e re Agonas do shoqërohet me rehabilitim të rrugëve sistemit terreni përreth depot)
1.2	Pastrimin e tokës ekzistuese, vegjetacionit dhe ndërtimeve ekzistuese?	Po	Pjesa e kanalit ku do vendoset tubacioni	Jo (ndërtimi i linjave do shoqërohet me rehabilitim të rrugëve duke i kthyer në gjendjen e mëparshme)

1.3	Krijimin e perdorimeve te reja te tokes?	Jo		
1.4	Investigime para fazes ndertimore, si shpime per marrjen e mostrave, provat e tokes, dheut ?	Jo		
1.5	Punime ndertimi?	Po	Ndertim i trasese se linjave dhe depot	Jo (rruget do te kthehet ne gjendjen fillestare dhe depot do rehabilitojne terrenin perreth)
1.6	Punime prishjeje?	Po	Prishje të asfaltit, betonit të rrugës	Jo (rruget do te kthehet ne gjendjen fillestare)
1.7	Kantiere te perkoheshme pe punime ndertimi ose strehimi per punetoret?	Po	Kantjer ndertimi	Jo (do jete provizore sipas grafikut te punimeve)
1.8	Punime mbitokesore, struktura ose punime te tokes, germime ose mbushje?	Po	Germim mbushje kanalesh, puseta dhe depot e reja	Jo (rruget do te kthehet ne gjendjen fillestare dhe do rehabilitojne terrenin perreth depo)
1.9	Punime nentokesore, miniera ose tunele?	Jo		
1.10	Punime bonifikuese?	Jo		
1.11	Germime per hapje kanalesh?	Po	Pjese te tokes ne kanalin e linjes se trasmetimit të ujit	Jo (rruget do te kthehet ne gjendjen fillestare)
1.12	Struktura bregdetare, si diga, skela?	Jo		
1.13	Struktura ne det?	Jo		
1.14	Procese te ndryshme prodhimi?	Jo		
1.15	Mjedise per magazinim te mallrave e materialeve te ndryshme?	Po	Materiale tuba, rakorderi, inerte, cemento, hekur etj.	Jo (do perdoren ambiente ekzistuese, shtepi private)
1.16	Impiante per trajnimin ose depozitimin e mbetjeve te ngurta e te lengeshme?	Jo		
1.17	Objekte te strehimit punetoreve te shfrytezimit?	Jo		
1.18	Rruge e re, hekurudhe, trafik detar, gjate fazes se ndertimit e shfrytezimit?	Jo		
1.19	Rruge e re, hekurudhe, ajrore, ujore, infrastruktura te tjera transorti, perfshire rruge e stacione te reja te alternuara porte e aeroporte?	Jo		
1.20	Mbyllje apo devijim i rrugëve ekzistuese qe con ne ndryshime ne levizjet e trafikut?	Po	Kalim i mjeteve ne nje korsi ne segmentet ku kryen punime	Jo (devijimi me orare te kufizuara vetem kur punohet)
1.21	Linja ose tubacione te reja transferuese te trasmetimit?	Po	Tubacionet e rrjetit	Jo (pasi te vendosen tubat ne toke do te rehabilitohet tereni)
1.22	Rezervuar, argjinatura, kanale nentokesore, regullime apo ndryshime te tjera ne hidrologjine e rrjedhave ujore apo akuifereve?	Jo		
1.23	Ndeprerje te rymave?	Jo		
1.24	Nxjerje ose transferim te ujit nga nentoka ose siperfaqet ujore?	Jo		
1.25	Ndryshime ne trupat ujore, siperfaqet e tokes qe ndikojne ne drenimin ose largimin e ujrave?	Jo		
1.26	Transportin e personelit e materialeve te ndertimit, shfrytezimit e mbeturinave?	Po	Transport i punetoreve dhe dheut te germuar	Po (para germimit do te laget toka me uje, dheu i nxjerre nga germimi do te trasportohet me kamiona te mbuluar, do pastrohen rruget ne hyrje te kantierit)
1.27	Punime afatgjata cmontimi, nxjerjen e mbeturinave ose punime restauruese?	Jo		
1.28	Veprimtari gjate ndryshimit te destinacionit qe mund te kene ndikim ne mjedis?	Jo		
1.29	Hyrjen e njerezve ne nje zone perkohesisht ose ne menyre te vazhdueshme?	Po	Hyrja e punetoreve gjate ndertimit	Jo (lidhet me aktivitetin ndertues)
1.30	Futjen per kultivim te specieve jovendase?	Jo		
1.31	Humbjen e specieve vendase ose diversitet gjenetik?	Jo		

1.32	Ndonje veprim tjeter?	Jo		
2. A do perdoren gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit te projektit burimet natyrore te tilla si: toka, uji, materiale e energji, nga burime qe jane te parinovueshme ose te kufizuara?				
2.1	Toke vecanerisht e varfer apo toke bujqesore?	Jo		
2.2	Uji?	Po	Uji pas ndertimit per furnizimin e banoreve vendas	Jo (sasia e ujit eshte 150 l/d sipas normave per furnizimin me uje te pijshem per 1 banore)
2.3	Minerale?	Jo		
Pyetje qe duhet te mbahen parasysh gjate perzgjedhjes				
2.4	Grumbullime lendesh ndertimi (zhavor etj)	Po	Zhavor	Jo (rehabilitim i tokes te perdorur pas ndertimit)
2.5	Pyje dhe lende drusore	Jo		
2.6	Energji, elektrike apo lende djegese?	Jo		
2.7	Ndonje burim tjeter?	Jo		
3. A do te perfshije projekti perdorimin, ruajtjen, transportin, perpunimin dhe prodhimin e substancave e materialeve qe mund te jene te demshem per shendetin e njerezve e mjedisin e risin shqetesimin mbi rreziqet aktuale e te mundshme ne shendetin e njerezve?				
3.1	A parashikon projekti perdorimin e substancave ose materialeve te rrezikshme ose toksike per njerzit dhe mjedisin?	Jo		
3.2	Do rezultojte projekti ne ndryshime me shfaqje semundiesh ose efekt ne vektoret e semundjeve	Jo		
3.3	Do ndikojte projekti ne mireqenien e njerezve?	Jo		
3.4	A ka grupe njerezish qe mund te ndikohen nga projekti, si te semure apo te moshuarit?	Jo		
3.5	Shkaqe te tjera?	Jo		
4. A do te prodhohen mbeturina te ngurta, gjate ndertimit, shfrytezimit ose nxjerje jashte funksioni?				
4.1	Mbeturina dherash zhavori ose minierash?	Po	Mbeturina dherash	Jo (rehabilitohet toka e perdorur pas ndertimit dhe dherat transportohen ne vendepozitim)
4.2	Mbetje urbane(shtepiake ose tregetia) ?	Jo		
4.3	Mbetje te rrezikshme e toksike apo radioaktive?	Jo		
4.4	Mbetje te tjera te proceseve industriale?	Jo		
4.5	Produkte shtese?	Jo		
4.6	Ujra te zeza ose llumra te tjera nga trajtimet e shkarkimeve te lengeta?	Jo		
4.7	Mbetjet nga ndertimet ose shembjet?	Po	Mbetje dherash,	Jo (dherat transportohen ne vendepozitim)
4.8	Mbeturina makinash ose paisjesh?	Jo		
Pyetje qe duhet te mbahen parasysh gjate perzgjedhjes				
4.9	Toka te ndotura ose materiale te tjera?	Jo		
4.10	Mbetje bujqesore?	Jo		
4.11	Mbetje te tjera te ngurta?	Jo		
5. A do te shkarkohen ndotes ne ajer ose cdo substance tjeter e rrezikshme toksike apo e demshme per shendetin nga projekti?				
5.1	Shkarkime nga djegiet e karburanteve nga burime stacionare ose te levizshme?	Jo		
5.2	Shkarkime nga proceset prodhuese?	Jo		
5.3	Shkarkime nga perpunimi i materialeve, perfshi depozitimin ose transportin?	Jo		
5.4	Shkarkime nga aktiviteti i ndertimit perfshi impiantet dhe pajisjet?	Jo		
5.5	Mbetje e erera sulmuese nga perpunimi i materialeve te ndertimit, ujrat e zeza e mbetjet?	Jo		
5.6	Shkarkime nga inceneratoret e plehrave?	Jo		
5.7	Shkarkime nga djegija e mbetjeve ne ajer?	Jo		
5.8	Shkarkime nga burime te tjera?	Jo		

6. A do te shkaktoje projekti zhurma dhe vibracione ose emetime te drites, energjise termike ose rrezatim elektromanjetik?				
6.1	Nga puna e paisjeve si: motora, franto, ventilus?	Po	Puna e paisjeve prerese asfaltit	Jo (punimet kryhen me orar te reduktuar 7.00-15.00)
6.2	Nga procese industriale apo te ngjajshme?	Jo		
6.3	Nga ndertime apo prishje?	Po	Germim, Ndertim dhe Montim	Jo (punimet kryhen me orar te reduktuar)
6.4	Nga plasje apo futje pilotash	Jo		
6.5	Nga trafiku gjate ndertimit ose shfrytezimit?	Po	Trafik gjate ndertimit	Jo (punimet kryhen me orar te reduktuar sipas grafikut, do behet menaxhimi i trafikut)
6.6	Nga proceset e ndricimit ose ftohjes?	Jo		
6.7	Nga burimet e rrezatimit elektromanjetik (efektet mbi pajisjet dhe njerezit)?	Jo		
6.8	Nga cdo burim tjeter?	Jo		
7. A do te coje projekti ne rreziqe te ndotjes se tokes, ujit nga shkarkimrt e ndotesave ne toke ne kanalizimet e ujrave te bardha dhe te zeza, ujrat siperfaqesor, nentokesor, bregdetare ose ne det?				
7.1	Nga perpunimi, depozitimi, perdorimi ose shkarkim i lendeve te rrezikshme e toksike?	Jo		
7.2	Nga shkarkimet e ujrave te zeza ose rjedhjeve te tjera (trajtuara e patrajtuara) ne uji ose toke?	Jo		
7.3	Depozitimi ndotesve te shkarkuar ne ajer, uji toke	Jo		
7.4	Nga cdo burim tjeter?	Jo		
7.5	A ka rrezik te ndonje akumulimi afatgjate te ndotesve ne mjedis nga keto burime?	Jo		
8. Ekziston rreziku i aksidenteve gjate ndertimit apo shfrytezimit te projektit qe mund te ndikojne ne shendetin e njerezve apo mjedisin?				
8.1	Shperthime, zjare, nxjerje nga depozitimi, perdorimi e prodhimi i substancave te rrezikshme e toksike?	Jo		
8.2	Nga ngjarje qe kapercenje kufijte e mbrojtjes normale te mjedisit, p sh. demtimi i sistemit te kontrollit te ndotjes?	Jo		
8.3	Nga ndonje shkak tjeter?	Jo		
8.4	Mund te ndikohet projekti nga fatkeqsi natyrore qe shkaktojne deme per mjedisin (permybtje, termete, shkarje etj.)?	Jo		
9. A rezulton projekti me ndryshime sociale, ne demografi, menyre tradicionale jetese, punesim?				
9.1	Ndryshime ne madhesine e popullsisë, moshen, strukturen, grupet sociale etj.?	Po	Ne rritjen e madhesine se popullsisë	Po Furnizimi me uje do te risi cilesine e jetes dhe higjenes
9.2	Nga strehimi i njerezve apo prishja e shtepive, mjediseve te komunitetit, si shkolla, spitale, mjedise sociale?	Jo		
9.3	Nepermjet migrimit te banoreve te rinj ose krijimit te komuniteteve te reja?	Jo		
9.4	Nga realizimi i kerkesave ne ritje per mjedise, sherbime sociale, strehim, arsim, shendet?	Jo		
9.5	Nga krijimi i vendeve te punes gjate ndertimit a shfrytezimit apo humbjes se vendeve te punes me pasoja ne papunesi e ekonomi?	Po	Krijim i vendeve te punes	Po Impakt pozitiv nga hapja e vendeve te punes
9.6	Ndonje shkak tjeter?	Jo		
10. A do te coje projekti ne presion per zhvillime te metejshme qe mund te kene ndikim te rendesishem ne mjedis, me shume banesa, rruge te reja, industri, veprimtari mbeshtetese				
10.1	A do te coje projekti ne presione per zhvillime te metejshme qe do te kete ndikim te caktuar ne mjedis, si: me shume strehim, rruge te reja, industri, sherbime publike mbeshtetese te reja?	Po	Impakt pozitiv	Ritje te cilesise se jeteses
10.2	A do te coje projekti ne zhvillimin e mjediseve mbeshtetese, zhvillime ndihmese ose zhvillime te nxitura nga projekti qe te kete ndikim mjedisi , si: 1. infrastrukture mbeshtetese (rruge, furnizim me energji elektrike, trajtim te mbetjeve ose ujrave te perdorura etj.) 2. Zhvillim i strehimit; 3. industri nxjeresë (ekstraktuese); 4. industri funizuese; 5. te tjera	Jo Jo Jo Jo Jo		
10.3	A do te coje projekti ne riperdorim te kantjerit pas shfrytezimit te tij qe do te kete ndikim ne mjedis?	Jo		

10.4	A do të cojë projekti në krijimin e një precedenti për zhvillime të mëvonshme?	Po	Zhvillim blektoral, turistik	Po Zhvillim ekonomik dhe turistik të zonës
10.5	Do të ketë projekti pasojë kumulative nga afërsia me projekte të tjera ekzistuese ose të planifikuara e me pasojë të ngjashme?	Jo		

7. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE DHE VLERESIMI I SITUATËS

7.1 Ndikimet në mjedis gjatë ndërtimit të rrjetit shpërndarës.

Për ndërtimin e këtyre rrjeteve të furnizimit me ujë do të kryhen këto punime: germimi, hapje kanalesh, instalim tubash dhe saracineska, mbushje kanali, puseta betoni për manovrim, asfaltim, punime betoni për deponi si dhe përdorim të makinerive teknologjike, germuese dhe transportuese, etj. Për gjatë kryerjes së këtyre operacioneve do të ketë krijim të pluhurave në sasi të vogla si rezultat i punimeve të ndryshme. Për të bërë të mundur reduktimin në minimum të pluhurave gjatë transportit është e domosdoshme që toka të lagët përpara germimit, makina transportuese të lagën dhe të mbulohen dhe rruget në dalje të kantiereve të pastrohen.

7.2 Ndikimet në mjedis gjatë largimit të materialeve nga kanalet dhe montimi i tubacioneve, etj

Terreni nëpër të cilin do të hapen kanalet për tubacionet e dërgimit për në depo dhe tubacionet e shpërndarjes të ujit në drejtim të konsumatore, tregon se kemi të bëjmë me germime të vogla në krahasim me sipërfaqen që shtrihet projekti. Pjesa më e madhe e materialeve të germimit do të largohen nga kanalet, pasi do të përdoret material çakull për mbushjen e tyre. Pushteti vendor duhet të caktojë vendin e përshtatshëm ku do të depozitohen pa shkaktuar ndotje të tjera në mjedis. Një sasi e vogël dheu (humus) i germuar do të përdoret për sistemim sheshi përreth deposë së re.

7.4 Ndikimet në mjedis si rezultat i sjelljes së materialeve të ndryshme

Nga proceset e ndërtimit kemi të bëjmë me hapje kanalesh të permasave të vogla (thellessia 1,2-1.6 m), dhe nuk do të kemi vëllime të konsiderueshme materialeve inerte që do sillen me makinave të tonazhit të lartë, të mesëm dhe të vogël sipas rastit. Të gjitha këto makina do të rrisin trafikun dhe nivelin zhurmave. Është menduar që punimet të kryhen në orar të kufizuar nga ora 07.00-15.00 dhe të ndalohet përdorimi i borive në kantiere.

7.5 Vlerësimi i efektivitetit të pritshëm të masave zbutëse

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt, do të varet nga respektimi i treguesve të përcaktuar në këtë raport. Kontrolli i monitorimit dhe përmirësimi i vazhdueshëm, sipas kushteve të shfrytëzimit të krijuar gjatë aktivitetit, do të cojë përfundimisht në përfitimin e pamjeve të parashikuara në projekt.

7.6 Zhurmat

Gjatë ndërtimit të rrjetit, do të ketë angazhim të makinerive për punime prerje asfalti, germimi, montimi, transporti materialeve, etj. Për të zbutur efektin e trafikut të ngarkuar dhe zhurmave që shoqërojnë ato, me qëllim uljen e shqetësimeve për popullatën përreth zonës së ndërtimit, si rrugë kantiereve do të përdoren ku të jete e mundur rruget dytësore. Është menduar që punimet të kryhen në orar të kufizuar nga ora 07.00-15.00 dhe të ndalohet përdorimi i borive në kantiere. Transportimi i materialeve të ndërtimit në rruget ekzistuese do të

programohet me kujdes për të shmangur çdo shqetësim në trafikun lokal. Gjate nates, automjetet e furnizimit të materialeve do të kërkojnë që të operojnë me shpejtësi të ulta dhe do të ndalojnë përdorimi i borive.

7.7 Ndikimet në ujrat sipërfaqesore

Zbatimi i këtij projekti nuk le shkas për ndotjen e ujerave të rrjedhës sipërfaqesore nga ndotës të ndryshëm si, lëndet helmuese etj. Nuk pritet të ndodhë ndonjë ndotje nga shkarkimet në toke, e më pas të shpëlahen nga rreshjet, nga karburantet mund të ketë vetëm ndotje aksidentale nga rrjedhja e mjeteve të punës.

7.8 Ndikimet në ujrat nëntokesore

Zbatimi i projektit nuk ka ndikim në ujrat nëntokesore, pasi linja do të vendoset në trupin e rrugës ekzistuese dhe thellësia e kanalit është e vogël $h=1.2-1.6\text{m}$.

8. PLANI I ZBUTJES SE NDIKIMEVE NEGATIVE DHE REHABILITIMET

8.1 Përdorimi i tokës

Ndërtimi i rrjetit nuk krijon shqetësim për komunitetin përreth gjatë fazës së shfrytëzimit, por shqetësime në fazën e ndërtimit që lidhen me trafikun, zhurmat dhe pluhurin. Punimet e ndërtimit do të vazhdojnë për një periudhë të vogël kohe sipas zonës që investohet dhe proceseve të punës të parashikuara në grafikun e punimeve dhe nuk do të krijohen dëmtime të tokës. Për sa i përket tubacioneve ato nuk japin ndonjë ndryshim në peisazh, për arsye se ato janë punime nëntoke dhe nuk duken. Permasat e këtyre kanaleve janë me një gjatësi 0.55-1.5m dhe thellësi 1.2-1.6 m. Rrjeti i ujësjellësit nuk vendoset në toke buke, por vetëm në rruget ekzistuese dhe toke e përdorur për depot.

8.2 Ndikimi tek njerezit, ndërtesat dhe objektet e ndërtuara nga njeriu

8.2.1 Ndikimi në popullsi

Ndërtimi i ujësjellësive, në këtë zonë nuk ka për të sjellë probleme për komunitetin. Realizimi i këtij projekti, nuk do të shkaktojë ndryshime në popullsinë e saj apo zhvendosje për shkak të këtij aktiviteti. Nderkohe duhet të theksojmë që ndërtimi i rrjetit shpërndares, do të ketë avantazhe të mëdha, jo vetëm për popullsinë, por dhe për biznesin, agroturizmin. Nderkohe duhet theksuar që në këtë aktivitet mendohen të punesohen një numër i konsiderueshëm punonjësish duke zbutur e papunësinë në muajt e dimrit kur shërbimet e turizmit janë minimale.

8.2.2 Ndikimet në peisazh

Kemi theksuar se karakteristika e rrjeteve të shpërndares është ruajtja dhe mos ndryshimi i peisazhit. Në përfundim të punimeve gjurma e projektit do të rehabilitohet dhe kthehet në situatën përpara fillimit të punimeve.

8.3 Ndikimet e rrjetit mbi trashgiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra të tjera

Projekti shtrihet në zonë të banuar që nuk ka gjetje arkeologjike dhe nuk pritet të ndërprerë objekte arkeologjike. Gjithashtu duke qenë se gjurma është vendosur në rruget ekzistuese ku janë kryer punime, nuk ka për

te patur dhe nuk do te kete ndikime negative mbi trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne zone , nuk ka objekte te nje rendesie te vecante te karaktereve te mesiperme.

8.4 Ulja e intensitetit te erozionit dhe zbutja e ndryshimeve te topografise

Qellimi i projektit lidhet me ndertimin e rrjetit te furnizimit me uje. Nder objektivat themelore te ketij aktiviteti eshte furnizimi i popullsisë me uje, nderkohe qe mungesa e saj po krijon shume probleme ne levisjen demografike te popullates.

9. NDIKIMET NE FLORE, FAUNE DHE GJEOLGJINE

9.1 Bimet e ujit

Pika e marrjes se ujit eshte ekz. tub Gizes 500mm nga puseshpimet e Çermes dhe linja dergimit kalon ne rruge ekz. te shtruar me asfal, cakull ose dhe. Nga aktiviteti i ndertimit te depos Agonas dhe rrjetit te ujesjellesit nuk do te kete demtime te bimesise pasi nuk do te priten peme, do te ndertohen mbi gjurmen e rrugeve ekz.

9.2 Flora dhe Fauna

Zona sic eshte pershkuar edhe me lart, nuk eshte e mbushur me bimesi, pasi kanalet qe do kalojne neper rruge automobilistike. Fauna e zones, nuk peson ndonje ndryshim nga ky projekt ku projekti jone.

Aktiviteti i shfrytezimit nuk sjell influence negative ne folenizim, shumezim, etj. Gjate fazes se shfrytezimit nuk ka elemente te shqetesimit per demtimin e faunes.

Po ashtu edhe fauna karakteristike e zones eshte e paprekshme nga ndikimet e ndertimit te ketyre kanaleve, per arsye se aktiviteti i ndertimit dhe shfrytezimit nuk demton as ne lloje e as ne numer elementet e flores dhe faunes, si pjese perberese e ketij rajoni.

Si perfundim theksojme se ndertimi i rrjetit te ujesjellesave nuk e demton floren dhe faunen e kesaj zone.

9.3 Humbja dhe demtimi i tipareve gjologjike, paleontologjike, problemi i mjedisit gjeologjik

Ne pikepamje te struktures gjeologjike dhe pamjes se relievit, kjo zone nuk ka vecori tipike dalluese dhe nuk ka asnje arsye te vleresohet ose te merret parasysh gjate ketij aktiviteti. Kjo zone perben nje peisazh te zakonshem gjeologjiko-gjeomorfologjik, katakteristike e ketij rajoni.

10. NDIKIMET E PRITSHME NE MJEDISIN PERRETH

10.1 Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise se zones, tokes, etj.

Gjate te ndertimit te rrjetit shperndares te furnizimit me uje, dhe te projekteve perkatese, do te kete ndryshime pothuajse te paperfilleshme te topografise lokale. Ne projektet e tij jane parashkuar nje rralle nderhyrjesh qe, ne kombinim me masat e tjera suplementare te sistemimit dhe trajtimit, parandalojne erozionin e mundeshem. Gjate ndertimit te kanaleve dhe tubacioneve nuk pritet te kete ndryshime ne topografine lokale. Ne projekt eshte

parashikuar nje rradhe pune dhe drejtim i tille, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, te parandalojne fenomenin e erozionit:

- Ndikimet ne perdorimin e tokes dhe te burimeve,
- Ne cilesine dhe sasine e tokes are,

Siperfaqja qe do te perdoret per ndertimin e kanaleve dhe te tubacioneve, eshte rruge ekzistuese automobilistike. Pra nuk kemi te bejme me toke bujqesore. Ndertimi i ketyre veprave hidroteknike ne kete zone, nuk ndikon negativisht ne cilesine dhe sasine e tokes are. Ne zonen e ndertimit, hap pas hapi eshte parashikuar sistemimi i terrenit dhe si pasoje zhvillimi i bimesise spontane te mepareshme te kesaj zone.

10.2 Ne cilesine dhe sasine e tokes

Siperfaqja ne te cilen do te ndertohet rrjeti shperndares i furnizimit me uje, nuk eshte toke bujqesore. Ndertimi i ketij linje nuk perben asnje problem per sa i perket cilesise se saj.

10.3 Ndikimet ne uje

Ndertimi i rrjetit, nuk sjell asnje ndikim cilesine se ujit, pasi ai eshte i gjithi i ri dhe pika e furnizimit është tub ekz. Projekti nuk do te ndikojë negativisht ne ujrat siperfaqesore qe perdoren per vaditje nga komuniteti i afert, pasi veprat jane ekzistuse. Zbatimi i projektit nuk do te ndikojë negativisht ne ujrat siperfaqesore, pasi nuk do te krijohen basene, per rregullimin e rregjimit te prurjeve nuk do te thahet burimi dhe te krijojë probleme me basenin e tij.

10.4 Ndikimet e ndotesve dhe mbetjeve ne cilesine e ujit

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti nuk do te kete ndikim ne cilesine e ujit.

10.5 Ndikimet ne ajer

Ushtrimi i ketij aktiviteti gjate shfrytezimit nuk ka ndikim ne cilesine e ajrit te zones, nuk do te kete emetime te gazrave apo pluhurave. Ne fazen e ndertimit do te kete pluhur dhe do te meren masa zbutese per uljen e pluhurit ne ajer duke lagur token para germimit, larguar dheun e germuar perpara transportit me kamione te mbuluar dhe pastrim te rrugeve ne dalje nga kantieri.

10.6 Ndikimi ne klime

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti nuk ka ndikim ne klimen e kesaj zone.

10.7 Aromat sulmuese

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti nuk ka emetime te aromave te ndryshme te cdo lloji qofshin ato.

10.8 Ndikime te tjera klimatike

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj.

10.9 Ndikime te tjera indirekte dhe sekondare, qe shoqerojne projektin

Projektet e tjera si p.sh. rruget e reja, kanalet e ujrave te zeza, banesat, linjat e energjise, telekomunikacionet, etj. do te ndikojne ne realizimin e ketij projekti, pasi ne zonen qe prek ky projekt ka elemente te infrastruktures sic u permenden me lart por jane bere te gjitha parashikimet dhe do te synohet shmangja e intersektimit te tyre.

10.10 Ndikimet shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese ose te propozuara

Ushtrimi i ketij aktiviteti do te ndikojte pozitivisht ne zhvillimin dhe ne rritjen e nivelit socia-ekonomik ne zone.

11. MASAT PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

11.1 Organizimi

Rrjetet e ujesjellesave do te jete nen administrimin e Sh.A. Shoqeria Rajonale e Ujesjelles Kanalizime Durrës dhe do te kete administrator, drejtues teknik, specialiste, punetore, pergjegjesa zone, manovratore, shofere etj.

11.2 Masat e sigurimit teknik ne pune

Mbrojtja ne pune dhe ruajtja e shendetit te punonjesve qe do te punojne ne ndertimin dhe shfrytezimin e ujesjellesit, do te realizohet duke zbatuar rregullat e sigurise dhe mbrojtjes ne pune.

Gjate ndertimit te rrjetit, duhet te jene ne qender te vemendjes problemet e sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune, pasi keto jane me te rendesishmet dhe qe kerkojne nje vleresim shume serioz nga ana e drejtuesit te punimeve.

- Te gjithë proceset e punes do te punesohen specialiste me eksperience pune ne kete fushe.
- Drejtuesi teknik i punimeve duhet te beje instruktimin teknik te punonjesve,.
- Ne mjediset qe do te punohet do te jete gjithmone kutia e ndihmes se shpejte.
- Punetoret qe do te punojne per hapjen e kanaleve, duhet te jene te paisur nga firma me te gjitha mjetet mbrojtese, veshje te dukshme, kapele plastike, rroba pune, dorashka, kepuce etj.
- Kujdes duhet treguar edhe gjate ndertimit te rrjetit, duke zbatuar me korrektesi projektin e zbatimit.
- Per rastet e renies se zjarrit, ne objekt duhet te jene te vendosura shuaresit me gaz shkumues.
- Punonjesit duhet te jene te instruktuar per rastet e renies se zjarrit si dhe per rastet e aksidenteve ne pune.

Mbrojtja ne pune dhe ruajtja e shendetit punonjesve qe do punojne do te realizohet duke zbatuar:

- Rregulloren e sigurimit teknik per punimet me tensione te larta,
- Normativat e ndotesve ne mjediset e punes te miratuara nga Inspektoriati i Higjenes se Punes,
- Garancine e lendeve te para si te pademshme per shendetin e puntoreve ne te gjitha fazat e punes me to.

Operacionet e punes ne mjediset e punes kerkojne perdorimin e veshjeve personale speciale per te realizuar mbrojtjen nga saldimet e tubave te celikut dhe te zhurmave. Sigurimi teknik dhe mbrojtja ne pune do te jene dy detyrat kryesore te stafit drejtues dhe punonjesve.

Nje nder kerkesat e shoqerise sipermarrese per makinerite eshte qe rreziku i aksidenteve ne pune, prekja e shendetit nga agjentet e ndryshem fizike apo kimike te jete sa me e vogel. Kjo do te beje te mundur qe te ulen ne minimum pasojat qe vijne nga proceset e ndryshme te punes.

11.3 Mbrojtja e mjedisit

Projekti do te zhvillohet ne harmoni me vlerat e natyres. Zona nuk permban habitate potenciale per biodiversitetin. Vemendje kryesore gjate ketyre punimeve duhet te tregohet ne dy aspekte;

- 1) sistemimi i materialit inert te krijuar nga keto punime,
- 2) sistemimi e rruges automobilistike duke evituar fillimin e prishjes se saj nga ujrat e shiut.

Studimi i hollesishem e masave te propozuarar jane garanci qe keto probleme mjedisore do te jene minimale. Pra mund te themi se nga ky aktivitet nuk pritet te kete ndikim mjedisor te matshem pasi:

- Nuk ka prodhim te mbetjeve te rrezikshme
- Nuk shkakton ndotje te tokes me shkarkime te ndryshme te lengeta, apo te ngurta
- Nuk ka shkarkime ne ajer te gazrave apo tymrave
- Zhurmat ne kantier do te jene brenda normes se lejuar nuk pritet te kene ndikim ne popullaten perreth
- Nuk ka clirim te aromave te ndryshme, etj
- Ka vlera normale te temperatures dhe te lageshtise ne mjediset e punes
- Jane parashikuar marrja e te gjitha masave per mbrojtjen ne pune dhe masat per evitimin e rrezikut te zjarrit.

Sipermarsi ka mjetet e nevojshme teknike dhe financiare per te zhvilluar kete aktivitet dhe kerkon te jete e pajisur me te gjitha lejet perkatese, sipas legjislacionit shqiptar. Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per ndertimin e ujesjellesave eshte pergatitur si pjese e dokumentacionit qe duhet per te marre miratimet e zhvillimit te aktivitetit. Raporti eshte pergatitur sipas kerkesave te Ligjit me Nr. 10440, datë 07. 07. 2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" i ndryshuar, eshte dhene ne menyre te qarte se cilat projekte i nenshtrohen vleresimit te ndikimit ne mjedis te cilat klasifikohen si me poshte. Ai synon te jape aspektet mjedisore te aktivitetit dhe ndikimet e mundshme ne mjedis shoqeria jep informacionin e duhur:

- per aktivitetin qe eshte menduar te kryhet ne perputhje me kerkesat mjedisore,
- per zhvllhimin e aktivitetit qe do te jete ne perputhje me kriteret per mbrojtjen e mjedisit.

11.4 Masat e mara per zbutjen e rrezikut ne mjedis dhe shendet

Sic u theksua dhe me lart, mund te pohohet se rreziku ne mjedis ne zonen qe do te realizohet projekti i ndertimit te linjes se trasmetimit, eshte i minimizuar. Punime per ndertimin e ujesjellesave do te jene konform me cilesine dhe standartet nderkombetare. Per reagimin e menjehershem ndaj aksidenteve te mundeshme humane do te kete edhe nje mjedis te mbyllur ku mbahet kutia e ndihmes se shpejte dhe do te vendosen mjetet personale te punonjesve. Per uljen e rrezikut te aksidentimit te punonjesve nga mjetet e transportit gjate fazes se ndertimit, nuk do te lejohet te ecin me shume se 30 km/ore.

12. MATRICAT PERMBLEDHESE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

Ne perputhje me Udhezimin Nr.6, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraparak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie" eshte ndertuar matrica e ndikimeve te projektit te ndertimit te rrjetit shperndares, gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit. Matrica eshte ndertuar ne perputhje me Aneksin II te pjeses se dyte te ketij udhezimi.

12.1 Matrica e ndikimeve ne mjedis

Tipare te mjedisit te projektit, te cilat mund te ndikohen nga projekti lokal apo perreth vendodhjes se projektit	Identifikimi i ndikimit ne mjedis			
	Ne ndertim		Ne shfrytezim	
	Po	Jo	Po	Jo
Zone te mbrojtura nga legjislacioni per vlerat e tyre ekologjike, peisazhe, kulturore		X		X
Zona te tjera te rendesishme ose te ndjeshme per arsye te ekologjises se tyre				
a. ligatina		X		X
b. rjedhje ujore ose trupa te tjere ujore		X		X
c. zona bregdetare	X			X
d. male		X		X
e. pyje		X		X
Zona te perdorura nga specie te mbrojtura, te flores e faunes, per kyqezim, folenizim, ushqim, pushim, dimerim, migrim		X		X
Ujrat e brendeshme, tokesore, bregdetare, detare e nentokesore		X		X
Zona me vlera te larta peisazhi e skenike		X		X
Rruge ose mjedise te tjera te perdorura nga publiku per pushime ose aktivite te tjera.	X			X
Rruge transporti qe jane te mbingarkuara		X		X
Zona me rendesi historike e kulturore	X			X
Vendosja e projektit ne nje zone shume te dukshme nga shume njerez		X		X
Humbje te tokes se gjelber		X		X
Perdorime ekzistuese te tokes ne/ose reth vendit te zbatimit te projektit, qe ndikohen nga projekti				
a. shtepi, oborre ose prona te tjera private	X			X
b. industri		X		X
c. tregeti		X		X
d. rekreacione		X		X
e. hapësira publike		X		X
f. mjedise te komunitetit		X		X
g. bujqesi	X			X
h. pyje		X		X
i. turizem		X		X
j. miniera		X		X
Plane perdorime te ardhshme te tokes te cilat mund te ndikohen prej tij		X		X
Zona me densitet te larte popullsie e ndertimesh		X		X
Zona te zena nga perdorime te ndjeshme te tokes				
1. spitale		X		X
2. shkolla		X		X
3. vende kulti		X		X
4. mjedise te komunitetit		X		X
Permbajtja ne zone e burimeve te rendesishme, me nje cilesi te larte ose te pakta qe mund te ndikohen				
1. burime ujrash nentokesor		X		X
2. ujra siperfaqesore		X		X
3. pyje		X		X
4. bujqesi	X			X
5. peshkim		X		X
6. turizem	X			X
7. minerale		X		X
Zone subjekt i ndotjes ose demtimeve mjedisore p.sh, ku standartet ekzistuese mjedisore jane tejkaluar		X		X

Zone e ndjeshme ndaj termeteve, reshqitje toke, erozionit, permbytjeve ose kushteve klimatike	X			X
Ndryshim i kushteve fizike te perberesve mjedisor				
1. mjedisi atmosferik		X		X
2. uji-sasia, rrjedhat ose nivel i lumit, liqenit, uji nentoktor		X		X
3. grykederdhjet, uji bregdetar ose detar		X		X
4. toka-sasia, thellesi, lageshti, qendrueshmeri, erodibilitet	X			X
5. kushtet gjeologjike dhe te siperfaqes se tokes	X			X
Shkarkimet nga zbatimi i projektit te ndikojne ne cilesine e perberesve mjedisore				
1. cilesia e ajrit lokal	X			X
2. cilesi e ajrit global, ndryshim klimatik, ngushtim i shtreses se ozonit		X		X
3. cilesi e ujit: lumenj, liqen, ujra nentokesor		X		X
4. grykederdhjet, ujrata bregdetare ose detare		X		X
5. statusi ushqyes dhe eutrofikimii ujrave		X		X
6. acidifikimi i tokes ose ujrave		X		X
7. toka	X			X
8. zhurmat	X			X
9. temperatura, rezatimi ndricues e elektromanjetik		X		X
10. produktiviteti i sistemeve natyrore ose bujqesore		X		X
Ndikimi ne disponibilitetin apo pamjaftueshmerine e burimeve te mundshme ne nivel lokal ose global				
1. Karburantet		X		X
2. Ujrat		X		X
3. Minerale dhe agregate		X		X
4. Lende drusore		X		X
5. Burime te tjera jo te rinovueshme		X		X
6. Kapacitetin e infrastruktures ne vend		X		X
Ndikimi ne shendetin ose mireqenien e komunitetit				
1. Cilesine e ajrit, ujit, ushqimit	X			X
2. Semundje ose vdekshmeri e komuniteteve ekspozimi ndaj ndotjes		X		X
3. Shfaqje ose shperndarja e bartesve te semundjeve		X		X
4. Ndjeshmeria e individeve te vecante, komuniteteve ndaj semundjeve		X		X
5. Perceptimi individual i sigurise personale		X	X	
6. Kohezioni dhe identiteti i komunitetit		X		X
7. Identiteti kulturor dhe shoqatat		X		X
8. Te drejtat e minoriteve		X		X
9. Kushtet e strehimit		X		X
10. Punesimi	X			X
11. Kushtet ekonomike		X	X	
12. Institucionet sociale		X		X

12.2. Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit

Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit te projektit te ndertimit te rrjetit shperndares te furnizimit me uje, jane ndertuar ne perputhje me Udhезimin Nr.6, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie".

12.2.1 Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se ndertimit

Ngjarjet gjate fazes se ndertimit	Faktoret qe ndikohen	Impakti	Prioriteti
Kerkime gjeologjike	Kafshet e egra	Zhurme	I neglizhueshem
Prerje e vegjetacioneve ekzistuese	Pyjet	Ndryshimi i habitatit	I neglizhueshem
Zgjerimi i rugeve ekzistuese	Komuniteti	Krijimi i oportunitetit, ndryshimi i habitatit	I neglizhueshem
Levizje e tokes	Gjeologjia e zones	Stabiliteti i shpateve	I neglizhueshem
Germime kanalesh	Hidro-gjeologjia e zones	Ndyshimi i rrjedhes se ujit	I larte
Mbushje permanente me materiale te shpateve	Gjeologjia e zones	Stabiliteti i shpateve	I larte
Realizimi i pritave provizore	Jeta e ujit, hidro-gjeologjia e	Ndryshimi i hidrografise se	I neglizhueshem

	zones	akuiferit	
Krijimi i akumulimit te perkohshem te dherave	Gjeologjia e zones	Stabiliteti i shpateve	I larte
Zhvendosje e perkohshme e personave, rrugeve, linjave elektrike	Komuniteti	Krijimi i oportunitetit,	I ulet
Realizimi i rrugeve ndihmese dhe kantieri	Komuniteti, kafshet e egra	Ndikimi vizual, shqetesimi i kafsheve te egra	I ulet
Mbetje te ngurta te basenit	Ekosistemi uhor	Ndryshimi i habitatit	I neglizhueshem
Devijimi i basenit	Ekosistemi uhor	Ndryshimi i habitatit	I neglizhueshem
Perdorimi ekskavatoreve, kamionave, makinave per personelin	Komuniteti, kafshet e egra	Zhurme	I larte
Prezenca njerzore ne vend gjate punimeve	Komuniteti, kafshet e egra	Zhurme	I larte

12.2.2 Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se shfrytezimit

Ngjarjet gjate fazes se shfrytezimit	Faktoret qe ndikohen	Impakti	Prioriteti
Furnizim me uje i popullates	Komuniteti	Reduktim i dotjes se mjedisit	I larte
Vepra e marrjes	Ekosistemi uhor	Modifikimi i habitatit	I ulet
Veprat permanente ne akuifer	Ekosistemi uhor	Modifikimi i habitatit	I neglizhueshem
Kanalet i rrjetit shperndares	Ekosistemi uhor	Modifikimi i habitatit	I ulet
Tubacionet e trasmetimit	Kafshet e egra	Ndikim vizual	I ulet
Linjat e reja elektrike	Komuniteti, kafshet e egra	Ndikim vizual	I neglizhueshem
Shkembijnje e thyer	Ekosistemi uhor, komuniteti	Modifikimi i habitatit, ndikim vizual	I neglizhueshem
Argjinaturat	Ekosistemi uhor, komuniteti	Modifikimi i habitatit, ndikim vizual	I neglizhueshem
Modifikimi i nivelit te prurjeve	peshqit	Modifikimi i habitatit	I neglizhueshem
	bimesia	Modifikimi i habitatit	I neglizhueshem
	komuniteti	Modifikimi i aktiviteteve rekreativ	I neglizhueshem
Zhurmat nga paisjet elektromekanike	komuniteti	Ndryshimi i kualitetit jeteses	I ulet
Largimi i materialit nga kanali	Ekosistemi uhor, komuniteti	Permiresimi i cilesise ajrit	I neglizhueshem

13. ASPEKTET NEGATIVE DHE POZITIVE TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Nga matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis te prezantuara me sipër ne menyre te permblodhur jane paraqitur efektet negative dhe pozitive te zbatimit te projektit te ndertimit e rrjetit te ujesjellesave te njesive adm.

13.1 Efektet negative

- Gjate fazes ne ndertim do te kete hapje kanalesh pergjate rruges automobilistike te cilat do te rehabilitohen ne gjendjen e meparshme.
- Depozitimi i mbetjeve te ngurta do te behet ne vendepozitimin e miratuar nga institucionet vendore dhe qendrore.

13.2 Efektet pozitive

- Ne fazen e ndertimit te vepres do te kete hapje te vendeve te reja te punes.
- Ndertimi i rrjetit dhe rritja e sasise se ujit do te permiresoje kushtet e jeteses se banoreve dhe turistev.
- Ngritja e kantjerit te ndertimit te rrjetit do te shoqerohet me hapjen e aktiviteteve te sherbimit dhe punesimit.
- Pritet te kete nje permiresim te sherbimeve dhe potencialeve rekreative te zones vecanerisht te turizmit.
- Largimi i mbetjeve te ngurta nga rruga do te permiresoje cilesine e ajrit dhe prezencen e llumit ne rruge.
- Aktiviteti i ndertimit nuk do t'i shkaktoje ndotje tokes.

- Nuk do të kemi ndotje të ajrit gjatë punimeve ndertuese pasi do të merren masat zbutëse me lagje me uje dhe mbulim kamionash, ndërsa pas përfundimit të linjave zonat do të kthehen në gjendjen normale.
- Zona do të mbetet me po ato funksione për të cilat është destinuar dhe nuk do të ketë ndryshim destinacioni.

14. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS TË PROJEKTIT

Monitorimi është një proces i zbulimit të ndryshimeve nëse ato ndodhin, si dhe i përcaktimit të drejtimit dhe matjes së shtrirjes së tyre. Objektivi themelor i këtij kapitulli është që të ofroje rekomandime të përshtatshme për mbrojtjen e zonës, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, mbrojtjes së cilësive të ujërave që futet në tubacion që shkon tek konsumatori.

Procesi i monitorimit do të përqendrohet dhe fokusohet në aktivitetin e këtij linje, në faktoret që gjenerojnë ndikime negative në mjedis, në efektet e këtyre ndikimeve, dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimet do të kryhen nga vete investitori, dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkojë bashkëpunimi i subjekteve të specializuara për fushat perkatese. Verifikimet, monitorimet apo auditimet do të organizohen nga institucionet administrative si DRM-ja e Durrës dhe Ministria e Mjedisit.

14.1 Plani i monitorimit

Potencialët negativë të përmendura më sipër mund të minimizohen duke marrë një sërë masash të cilat çojnë në përmirësimin dhe reduktimin e ndikimit në mjedis.

14.1.1 Efektet potenciale ndotëse të mjedisit. masat mbrojtëse gjatë fazës së ndërtimit dhe fazës së shfrytëzimit

Pastrimi dhe përgatitja e sheshit.

Traseja neper të cilën do të ndërtohen kanalet e rrjetit nuk kanë vegjetacion të ulët. Të gjitha paizet që do të kërkojnë të përdoren dhe sjellin zhurmë me të mëdha duhet të kufizohen në orët e funksionimit, sipas situatës përreth. Në ditët që do të përdoren do të synohet të ketë një numër minimal të punonjësve në objekt.

Konflikti me përdorimin aktual të tokës si tokë bujqësore

Nuk do të merret tokë me qira për trasenë e kanaleve dhe depoz, meqenëse punimet do të jenë kryesisht përgjatë rrugës automobilistike dhe teritori i depoz Agonas është verifikuar paraprakisht pronesia shtet dhe kufitare të janë privat.

Shqetësime të ndryshme mund të shkaktohen komuniteteve lokale

Të gjitha lejet duhet të merren nga autoritetet dhe nëse përkohësisht preken sipërfaqe tokë ato pas përfundimit të punimeve duhet të kthehen në gjendjen fillestare.

Vendosja e veprave hidroteknike

Nderhyrjet në tokë, gjatë hapjes së kanaleve dhe për shtrimin e tubacioneve të furnizimit me ujë, pritet të sjellin shqetësime të ndryshme. Gjeresia e trasës së kanalit të vepres që do të hapet të jetë minimale për të zvogëluar demtimin e sipërfaqes së rrugës dhe të sasise së dherave që do të transportohen.

Magazini dhe trajtimi i materialeve të rrezikshme

Duhet treguar kujdes per te evituar ndotjen e tokes dhe ujit nga pikimet dhe rrjedhjet e mundeshme te lubrifikanteve te mjeteve qe do te perdoren gjate ndertimit te vepres. Nje plan emergjence duhet te pregatitet ne rast te rrjedhjeve te lubrifikanteve.

Hedhja e mbeturinave te ngurta dhe te lengeta

Problemet shqetesuese qe lidhen me ndotjen e mjedisit jane dhe mbetjet e ngurta qe do te gjenerohen gjate ndertimit te vepres. Keto mbetje do te duhet te hidhen ne vende te caktuara nga pushteti lokal.

Problemet shqetesuese ne lidhje me kontaminimin e ujit

Nuk do te lejohet hedhja e mbetjeve te ngurta apo lengeta ne mjedis te hapur dhe vijat ujore.

14.2 Programi i monitorimit

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar, qe te gjitha ndikimet e mundeshme qe do ti vijne mjedisit nga ndertimi dhe operimi i linjave te tubacioneve te ujesjellesave jane marre parasysh. Programi i monitorimit per secilen ndotje potenciale qe mund t'i shkaktohet mjedisit eshte dhene me poshte dhe duhet te mbikqyret nga Agjensia Rajonale e Mjedisit.

Aspektet kryesore qe do te jene ne vemendje te monitorimit:

- Pastrimi dhe pregatitja e trasese se kanaleve.
- Minimizimi i erozonit eshte detyre primare gjate pregatitjes se kanaleve te tubacioneve te furnizimit me uje.
- Hedhja e materialeve te nxjerre nga pregatitja e trasese kerkon mbajtien e shenimeve perkatese ne regjistrin e punimeve te kryera. Te behet dokumentimi i materialeve te ngurta te parrezikshme qe hidhen ne vendet e caktuara.
- Dergimi i materialeve dhe i paisjeve ne shesh per kete aspekt eshte i nevojshem inspektimi i perhershem, i cili duhet te realizohet ne lidhje me kontrollin e emetimeve te pluhurit ne atmosfere gjate transportit te dheut.

INVESTIMET E PARASHIKUARA

Sh.A. Shoqeria Rajonale e Ujesjelles Kanalizime Durres aktualisht pretendon te kryeje investime per vete aktivitetin qe ka. Investimet e saj do te jene ne kuadrin e permiresimit te rrjetit, hartimin e projektit per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe pergatitjen e dokumentacionit ligjor per marrjen e Lejes se Infrastruktures.

MASAT PËR RIGJENERIMIN E SIPËRFAQES GJATË NDERTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT

1. Sistemimi i sterileve

Sistemimi i dherave te dala nga germimi i kanalit do te depozitohen ne vendepozitimn e miratuar nga drejtuesit te pushtetit vendor per qytetin e Kavajes.

2. Sistemimin e sipërfaqeve të asfaltit të rruges

Duke qene se si pasoje e ndertimit do te krijohen kanale projekti parashikon qe te sistemohet perseri siperfaqja e rruges me asfalt.

15. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga analiza e tere aspekteve te marra ne shqyrtim ne Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis dhe te projekt zbatimit per objektin **“Rikonstrukcion Rrjeti Ujësjellësit fshatrat Agonas, Kolje, Rakell, Qerret ne Njësitë Adm. Synej & Golem, Bashkia Kavajë”**, nuk do te kete pasoja negative te matshme ne mjedis. Projekti parashikon rehabilitimin e zones krahas ndertimit. Kjo eshte arsyeja qe subjekti ben propozimet perkatese ne dokumentacionin e pergatitur per tu pajisur me VNM Paraprake. Nderkohe eshte me rendesi qe subjekti ndertues te kete parasysh keto detyrime gjate fazave te ndryshme te realizimit te ketij projektit:

Te kryhet rehabilitimi i tokes ku jane hapur kanale per ndertimin e rrjetit shperndares se furnizimit me uje duke bere vleresimin permbledhes te raportit te pergatitur, i cili parashtron projektin e rrjetit shperndares, del e nevojshme te bejme konkluzione e japim rekomandimet e me poshteme:

1. Territori ne fjale nuk ka statusin e parkut kombetar.
2. Zbatimi i ketij projekti nuk do te kete ndonje pasoje negative te matshme ne mjedisin e zones.
3. Furnizimi me uje i popullates me kerkesat gjithnje ne rritje eshte nje domosdoshmeri.
4. Ndikime pritet te kete vetem ne rrugen automobilistike dhe trotuare.
5. Masat qe jane parashikuar ne terren do ta zbusin kete fenomen dhe do ta kthejne ne gjendjen fillestare.

LITERATURA

- 1 AKM Buletine mjedisore
- 2 MMPAU Akte ligjore mjedisor
- 3 MMPAU Akte ligjore Nderkombetare
- 4 HoxhaJ Hartografimi gjeologo-ambjental.
- 5 Grup autoresh Raport mbi gjendjen e mjedisit ne Shqiperi, Plani kombetar per mjedisin
- 6 Gjoka. F Pedologjia
- 7 Nikolla K Gjeodinamika
- 8 UNEP Vleresimi mjedisor ne Shqiperi
- 9 Aliaj Sh Harta neotektonike e Shqiperise shkalla 1:2000, toke-det.
- 10 Grup autoresh Harta Hidrogjeologjike e Shqiperise Shk. 1 :200000
- 11 Konomi N Klasftkimi gjeologo-inxhinierik i shkembinjve qe ndertojne Albanidet
- 12 Peja N Ekologjia
- 13 Q.S.Gj Gjeografia fizike e Shqiperise 1
- 14 Q.S.Gj Gjeografia fizike e Shqiperise 2
- 15 IHM Hidrologjia e Shqiperise
- 16 Kom. Energjise Strategjia Kombetare e Energjise.
- 17 LS.P.K Pyjet e Virgjer te Shqiperise
- 18 Mitrushit Druret dhe shkuret e Shqiperise
- 19 European Small Hydropower Association
- 20 Prof. FORNARO Principi di geomeccanica
Prof.DELGRECO
- 21 Associazione Geotecnica Italiana.
- 22 British Standard BS 1377 - 1990.
- 23 Code of Practice For Site Investigations (Bs 5930,1999)

PERGATITI

Dr. Ing. Andrin KËRPAÇI

Ekspert Mjedisi

TIRANE 2025

Laerta
Liko

Digitally signed by
Laerta Liko
Date: 2026.02.20
15:37:55 +02'00'